Turizmi në komunën e Pejës zë fill qysh në kohërat Iliro- Dardane, që në atë kohë burimet e ujërave termale në Ilixhe (banjën e Pejës) janë shfrytëzuar nga shumë njerëz për shërimin e sëmundjeve të ndryshme që kanë ardhur nga vendet e ndryshme, e këtë mund ta përkufizojmë edhe me një ngritje apo lulëzim të turizmit shëndetësor, e që edhe në ditët e sotme këto ujëra shfrytëzohen për të njëjtën çështje, ndërsa tani ekziston një infrastrukturë mjaft e mirë turistike në këtë vend e cila është e njohur. Më vonë, me paraqitjen e kërkesave të mëdha turistike dhe rëndësinë e turizmit, në këtë vend filluan të ndërtohen “ Konaqet dhe Hanet” të cilat kanë shërbyer si vende akomoduese për vizitorët të cilët kanë qëndruar në Pejë. Më vonë në komunën e Pejës u ndërtuan objekte të ndryshme hoteliere, në vitin 1992 hotel Korza, pastaj kampi Karagaq që shfrytëzohej nga turistët transit nga viset e ndryshme të Europës, hotel Metohija (tani hotel Dukagjini), motel Karagaq dhe Nora të cilat kapacitete shërbenin në ngritjen

=====

e ofertës turistike të komunës. Pasuria kulturore- territori i Pejës është i pasur me histori: gërmimet arkeologjike tregojnë se në këtë zonë ka qenë i pranishëm një qytetërim i organizuar që nga kohët e lashta. Vendet me interes më të madh janë: 10 zonat arkeologjike, 12 monumente kristiane, 23 monumentet myslimane, 102 kulla, një tyrbe bektashiane, 9 mullinj. Me interes të madh në qytet është Çarshia e Vjetër, si motiv ambiential me veçori të veçantë për turizëm e cila është e ndarë në tri pjesë si : Okoli, Çarshia e Vjetër dhe pjesa tjetër nga Iliriana e cila ka daljen në qendrën zejtare. Si vend me rëndësi këtu ka Okoli ku afër kësaj është Çarshi xhamia e ndërtuar në vitin 1471 dhe është xhamia më e vjetër në këtë vend, ku brenda oborrit të saj gjenden varri i Haxhi Zekës, Ali Pashë Gusisë etj. Sipas regjistrimit të kadastrës në vitin 1582 në qytetin e Pejës punonin 56 prodhime artizanale, periudha më e begatë është arritur në shekujt XVII e XIX.

Qyteti i vjetër i mbushur me histori, kulturë dhe traditë shqiptare është i rrethuar nga një pasuri e madhe natyrore si : Alpet Shqiptare dhe parku kombëtar më i bukur dhe më i madh i Kosovës.⁹ Gryka e Rugovës gjendet 3 km nga qendra e Pejës , dhe paraqet një pikë të rëndësishme për zhvillimin potencial të sektorit turistik, në Grykë kalon lumi Lumëbardhi i gjatë 56 km. Pas 12 km Gryka e Rugovës hapet dhe shfaqen fshatrat e parë të regjionit të Rugovës, janë 14 fshatra. Në zonen veriore të regjionit të Rugovës gjendet fshati Boge ku bëhet turizëm malor (si në dimër ashtu edhe në verë).

Më pas vjen Liqenati, në pjesën e majtë të lumit Lumëbardhë, fshati më i pasur nga pikëpamja natyrore dhe më tërheqës në të gjithë regjionin e Bjeshkëve të Nemuna, ka një pozicion shumë të favorshëm për ski, ka një restaurant prej 500 vendesh, një sallë për seminare dhe 6 shtëpiza të vogla për fjetje. Si dukuri impulsive gjeomorfologjike me attribute shumë të dukshme estetike dhe që ngjallin kuriozitet dallohen:

Gryka e Rugovës , Burimi i Drinit të Bardhë, Shpella e Radavcit, kreshtat shkëmbore, Maja e Kopranikut. Këtu ekzistojnë kushte të përshtatshme jo vetëm klimatike, por edhe fizikogjeografike (komplekset e gjëra të pyjeve dhe të livadheve, pasuria hidrografike, bukuritë natyrore etj), ku mund të ndërtohen sanatoriume, qendra kurimi, rekreacioni dhe qendra për përgatitjen e sportistëve në lartësitë mbidetare.

Organizimi i parkut kombëtar në rajonin e Bjeshkëve të Nemuna është një hap i rëndësishëm në shfrytëzimin e organizuar optimal të mundësive potenciale të këtij rajoni. Para luftës ekonomia turistike e Pejës shënon një rënie të zhvillimit të vet. Kapacitetet e vendosjes nuk shënojnë

⁹ Projektet e produktit turistik në Rajonin turistik të Bjeshkëve të Nemuna,- Prishtinë 2008 fq 6

ngritje të kërkesave turistike. Pasojat e luftës kanë lënë gjurmë edhe më të thella në shkatërrimin e objekteve kulturore me karakter historik, kulturor, fetar, ekonomik dhe turistik.

Pas luftës hetohet një tendencë e fillimit të konsolidimit të angazhimit konkret të subjekteve përgjegjëse në marrjen e masave paraprake programore në zhvillimin e turizmit. Qëllimi kryesor është, që të ruhet kjo pasuri natyrore dhe të shfrytëzohet në mënyrë të organizuar dhe racionale, duke formuar fizionominë turistike të vendit me formimin e bazës materiale të qarkullimit turistik, si rrugët deri te vendet turistike dhe objekte për qëndrim më të gjatë të turistëve.

Duke u bazuar në atë se Peja me rrethinë është njëra ndër qendrat me mundësi më të mëdha të zhvillimit të ekonomisë turistike në bazë të potencialit të resurseve për zhvillimin e turizmit që disponon si : Bjeshkët e Nemuna- Alpet shqiptare me bukuritë e veta natyrore me vlera të veta të larta ekologjike, gjeomorfologjike, me florë dhe faunën e saj shumë të pasur, me peisazhin e jashtzakonshëm të lokaliteteve, me lumenjtë dhe liqenet që paraqesin bukuritë natyrore atraktive të cilat janë të rralla në Europë, si dhe numri i madh i monumenteve kulturore dhe historike që ka Komuna e Pejës prej kohës parahistorike deri më sot. Komuna ka përpiluar Strategjinë e zhvillimit ekonomik të saj në kuadër të së cilës prioritet i është dhënë zhvillimit të turizmit si promotor i zhvillimit të degëve tjera të ekonomisë, andaj edhe janë ndarë zonat turistike për zhvillim.¹⁰

Komuna e Pejës ka identifikuar zhvillimin e këtyre llojeve të turizmit:

Turizmi malor, Turizmi transit, Turizmi shëndetësor, Turizmi kulturor, Turizmi fshatar, Eko-turizmi dhe në këtë aspekt janë përpiluar projektet për zhvillimin e turizmit si:

Qendra turistike rekreative- sportive, Projekti për turizmin fshatar, Turizmi ndërkufitar (hapja e pikës kufitare me Malin e Zi përmes Grykës së Rugovës), Projekti për turizmin kulturor, shtegu Ujëvara, shtegu i biciklizmit- Pejë-Radavc, Hulumtimi i shpellës- Gryka e madhe (Rugovë), Hulumtimi i shpellës- Radavci, Hapja e shtigjeve për ngjitje në shkëmbinj, Hapja e shtigjeve të hekurta, Krijimi i Eko-shtigjeve, Eko muzeu, Markimi i shtigjeve malore , si dhe shumë projekte tjera që do të ndikojnë direkt në ngritjen dhe zhvillimin e turizmit dhe krijimin e ofertës turistike të Pejës.

Në bashkëpunim me donatorët e jashtëm është hap zyra informative e turizmit e cila është e para në Kosovë për këtë lëmi, ku vizitorët apo turistët mund të marrin informata rreth aktiviteteve dhe programet turistike që ofrohen nga vendasit, si dhe krijimi i Guidave malore të cilët mund t'i udhëheqin turistët në mënyrë të organizuar.

¹⁰ Jafari J.- “ Encyclopedia of Tourism” London UK 2000 fq. 186.

Sot komuna e Pejës disponon me 8 hotele, 3 motele, numër të mjaftueshëm të restoranteve cilësore, 2 qendra sportive rekreative, 2 fshatra turistike me infrastrukturë të përshtatshme turistike, 3 kampe si dhe shërbime tjera që janë të gatshme në çdo kohë për çdo turistë.

1.2 ROLI I TURIZMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË PEJËS

Në zhvillimin ekonomik të Pejës rolin kryesor e luajnë aktualisht degët si: turizmi, tregtia, transporti, ekonomia bujqësore, zejtaria, industria ushqimore dhe ajo e pijeve si dhe ajo e materialit ndërtimor. Veçanërisht në regjionin e Pejës qendrat turistike në Rugovë dhe Banja e Pejës luan rol të veçantë në zhvillimin e ekonomisë turistike. Kështu që, e gjithë infrastruktura i është kushtuar zhvillimit të turizmit. Një sërë ndërtimesh mjaft ambicioze, kryesisht hotele dhe restorante, janë zhvilluar vitet e fundit, sidomos përgjatë rrugës Pejë- Rugovë dhe Pejë – Radavc. Andaj, Peja sot renditet në qendrat më të rëndësishme ekonomike, tregtare dhe turistike të vendit.

2. TURIZMI NË BJESHKËT E NEMUNA (ALPET SHQIPTARE)

Rajoni turistik i Bjeshkëve të Nemuna përfshinë 2340km², me rreth 515000 banorë, i përbërë nga komuna: Pejë, Gjakovë, Deçan, Burim, Klinë, Rahovec dhe Junik.

Rajoni ka mundësi të mira për lidhje me qendrat e Kosovës, po ashtu ka kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit ndërkufitar me Shqipërinë dhe me Malin e Zi. Klima është tipike malore, me reshje të mëdha bore, me shpatie të përshtatshme për zhvillimin e sporteve dimërore. Përplot me maja të larta (Gjeravica 2.656 m), burime e rrjedha lumenjsh me gryka e kanjone, pyje të larta dhe me botë të shumëllojshme bimore e shtazore, që krijojnë një peisazh mjaft të bukur dhe atraktiv për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm.¹¹

Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare, është hapësirë kapitale e trashëgimisë natyrore, për zhvillimin e turizmit. Sipas specifikave dhe karakteristikave natyrore, sidomos sipas veçorive të relievit, të shumëllojshmërisë biogeografike të resurseve jashtëzakonisht të pasura ujore, të pasurisë së peisazheve dhe të motiveve të mjedisit, Alpet Shqiptare janë masivi më unik malor në rajon.¹²

¹¹ Projektet e produktit Turistik në rajonin turistik të Bjeshkëve të Nemuna, - Prsihtinë 2008. fq.8

¹² Konferenca- “ Prespektiva e Turizmit Fshatar në regjionin e Rugovës” 07.Prill 2007 fq.20

Si dukuri, sidomos impresive gjeomorfologjike me attribute shumë të dukshme estetike dhe që ngjallin kuriozitet dallohen: Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë, Ujëvara e Mirushës, Shpella e Radavcit, Shpella në Gryken e Rugovës, Shpellat e Zatriqit, Banja e Burimit (Istogut), kreshtat shkëmbore etj.

Rajoni turistik në fjalë, është mjaft i pasur me monumente të trashëgimisë kulturore dhe paraqet një thesar të pasur të trashëgimisë etnokulturore, materiale, shpirtërore të periudhave të ndryshme historike, të cilat pos tjerash me karakteristikat dhe veçoritë e tyre, dallohen për nga shumëllojshmëria e cilësive, vlerave dhe rëndësisë së vet historike.

Rajoni turistik i Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Shqiptare), është i pasur edhe me numër të konsiderueshëm të liqeneve, që mund të jenë pjesë përbërëse e ofertës turistike.

Më të njohurit janë: Liqeni i Radoniqit, Liqeni i Moknës, në Rugovë Liqeni i Leqinatit, në Malet e Gjeravicës(Liqeni i Madh, Liqeni i Vogël). Shpellat janë ndër kuriozitetet më të mëdha natyrore turistike në këtë rajon turistik. Janë të njohura: shpellat e Radavcit, shpellat e Grykës së Rugovës, shpellat e Zatriqit, (ende të pa hulumtuara).

Studimet ndërkombëtare të bëra në vitet e 70-ta tregojnë se, në këtë rajon turistik, mund të ndërtohen 10 qendra, për zhvillimin e turizmit dimërorë- sportiv, në Bjeshkët e Nemuna. Në tabelën në vijim janë prezantuar vendet me mundësi për ngritjen e qendrave turistike:

Denivelacioni i mesatar shtigjeve 880	Qendrat kryesore të maleve	Numri i skiatorëve	Kapaciteti i terësishëm i qendrave
	Maja e Rusolisë	19.250	40.000
	Maja e Kurvalës	11.250	22.000
	Bjeshka e Belegut	7.550	15.000
	Koprivnik	6.620	11.000
	Rasa e Zogut	5.150	10.000
	Starac	4.150	8.000
	Maja e Strellcit	3.850	7.000
	Hala	3.780	7.000
	Maja e Leqinatit	2.760	5.000
	Maja e Moknës	2.030	4.000
	Gjithsej:	65.393	129.000

Tabela:Qendrat kryesore turistike

Biodiversiteti – Bjeshkët e Nemuna janë pjesë e rëndësishme e biodiversitetit të Ballkanit, me gjithsej 750 lloje bimore, prej të cilave 18 janë vendore dhe 100 të tjera janë lloje që rriten vetëm në Ballkan. Fizionomia e elementeve tërheqëse të rajonit turistik të Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare), ofrojnë mundësi për zhvillimin e këtyre llojeve të turizmit: Turizmi veror, Turizmi veror-sportiv, Turizmi kulturor, Gjuetia dhe peshkimi, Turizmi rural, Turizmi shëndetësor, shëndetësor kurativ, Ekskursionist-rekreativ, Turizmi alpinist, Speleoturizmi, Turizmi transit, Turizmi ndërkufitar etj.¹³

3. RËNDËSIA E TURIZMIT TERMAL NË KOSOVË

Turizmi termal (shëndetësor) paraqet rrafsh tërheqës dhe interesant, por ende i pa hulumtuar në sferën e shkencës së turizmit në vendin tonë. Deri më tani, në Kosovë është hulumtuar vetëm në formë fragmentare dhe parciale.

Në Kosovë më shumë i është kushtuar rëndësi zhvillimit të këtij lloj turizmi në aspektin shëndetësor, por jo edhe sipas parimeve të Federatës Ndërkombëtare për qendrat termale, siç mund të jetë pjesa rekreative në shërbim të turizmit, ky lloj turizmi, po vlerësohet se është një sektor i cili në rastin e investimit do të ndikonte në të hyrat e vendit. Po që se, ne e shfrytëzojmë në mënyrë racionale, kjo do të ishte shumë profitabile dhe përfitimet në ekonominë vendore do të rriten.

Lënda e parë për zhvillimin e turizmit termal në Kosovë është mjaft cilësore. Në këtë rast duhet marrë parasysh burimet termominerale të cilat janë të pranishme në mbi 55 vende të ndryshme, janë ujëra me përbërje komplekse mineralogjike mjaft të shëndetshme për organizmin. Përdoren për pirje dhe larje.

Këtu nuk duhet përjashtuar edhe Pelloiden (baltë shëruese) mjaft e shëndetshme në Banjën e Kllokotit.

Sipas hulumtimeve arkeologjike, ujërat termalë janë duke u përdorur për qëllime shëndetësore për më shumë se 10 mijë vite.

Në Japoni, janë 100 milionë njerëz të cilët brenda vitit i vizitojnë vendet me burime të ujit termal. Gjermania, Hungaria dhe Turqia kanë nga 10 milionë turistë brenda vitit në banjat e tyre të rregulluara mrekullueshëm. Në Rusi kjo shifër arrin deri 8 milionë. Në 210 banjat në SHBA shkojnë 4.5 milionë turistë, në Zvicër 800 mijë, në Francë 700 mijë, në Spanjë 400 mijë etj.

¹³ Adrian Bull: “ The economics Of Travel and Tourism”1996 New York fq.16

3.1. QENDRA TERMALE NË BANJË

Banja (Ilixha) gjendet 15km në perëndim të qytetit Istog. Temperatura e ujit të burimeve të nxehta është 46-48°C, kurse sasia e përgjithshme e ujërave të tyre është 17,5 l/sec. Mjekojnë reumatizmin, ishiasin, sëmundjet e lëkurës, sëmundjet e eshtrave dhe nervave, si dhe sëmundjet kronike të femrave.

Në bazë të mbeturinave të banjës së vjetër dhe të gypave të dheut, është konstatuar se ujërat e Banjës janë shfrytëzuar që nga romakët, pastaj nga sunduesit dhe aristokracia mesjetare e më vonë edhe nga turqit. Përtërirja e burimeve termale fillon në vitin 1916, ndërsa zbulimi, mbrojtja dhe popullarizimi i burimeve shtohet prej vitit 1923. Hoteli i parë u ndërtua më 1935. Në vitin 1936 Banja u shpall vendmjekim. Në vitin 1948 filloi adaptimi i hotelit të atëhershëm, ku u ndërtuan pavijone të reja, dy banja dhe u ndërtua ujësjellësi Vrellë-Banjë. Në vitin 1965, u ndërtua stacionari me dy basene dhe me 12 vaska, që janë të lidhura funksionalisht me stacionarin me anë të korridorit të mbyllur. Stacionari kishte 44 dhoma me 86 shtretër. Në vitin 1971, u bë adaptimi i hotelit, u ndërtua një sallë moderne për kafe dhe për ushqim. Kapacitetet e Banjës janë shfrytëzuar atëherë 80%. Në planet e mëhershme, projekson për Banjën kanë qenë 2500 shtretër në vitin 2000. Ky projekson jo vetëm që nuk është realizuar, por si pasojë e krizës 20 vjeçare ka mbet plan i parealizuar.

4. Përfundimi

Resurs strategjik i turizmit, mbetet hapësira me shumë vlerë, deri tani e ruajtur, që në të ardhmen gjithnjë e më shumë do të ketë rëndësi në zhvillimin ekonomik të rajonit.

Fizionomia e elementeve tërheqëse të Pejës, udhëzon qartë në rajonet malore, drejtimet e tranzitit turistik, komplekset dhe pasuritë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, lokalitetet e gjuetisë dhe fshatrat. Duke u nisur nga trendet aktuale dhe trendet e parashikuara të kërkesës ndërkombëtare turistike, ekzistojnë mundësi reale në plasimin e ofertës turistike në tregjet ndërkombëtare. Oferta kulminante turistike e Pejës, që përfshinë rrethin më të gjërë të kërkesës lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare bazohet në: peizazhet masive malore, që kanë potencial të madh pranimi, natyra e ruajtur, sidomos flora dhe fauna, lartësitë malore që arrijnë mbi 2500m, me kushte të përshtatshme klimatike për zhvillimin e turizmit veror e sidomos të atij dimëror, rrjeti i vendbanimeve me ofertën e organizuar të serviseve shërbyese që lidhen me korridoret kryesore të komunikacionit, si sistem hapësinor i zhvillimit të qarkullimit dinamik, atraksionet natyrore me bukuri të veçanta.

Literatura:

1. Milladinovski Sreten, Ekonomikja në turizëm F.T.S. Shkup 2006 fq.135
2. Konferenca “ Prespektiva e Turizmit Fshatar në Regjionin e Rugovës”, 07.Prill 2007. Fq.20 Pejë. www.rugovaexperience.org
3. M. Gashi “ Bazat e Turizmit” 1986 Prishtinë fq. 70
4. Adrian Bull “The economics Of Travel and Tourism”, 1996 New York. Fq.16
5. N. Muhaxheri : “ Bazat e Menaxhmentit në Turizëm”- Prishtinë 2005. fq 50
6. Lidija Simonceska- “ Bazat e Menaxhmentit” , Instituti për studime “ Pjetër Budi”, Prishtinë 2005.
7. Daniela Angelina Jeliq- “ Tourism Versus Identity Globalization and Tradition”, Zagreb 2006.fq 125
8. Ratko Dobre- “ Osnove Turizma, Teoria i Praksa”, Skript Shibenik 2005.
9. Jafari J.- “ Encyclopedia of Tourism”, London, UK 2000. fq. 186
10. K. Gorica: “ Politikat Turistike”, Tiranë , Janar 2001.
11. Prof. Dr. Stevan Sušić- “ Turističko Pravo”, Naučno istraživačkih Radova, Šibenik 1885 fq. 19
12. Projektet e produktit Turistik në Rajonin turistik të Bjeshkëve të Nemuna, - Prishtinë 2008. fq 8

=====

KUD 338.486(496.51-21)
SWOT ANALIZA E PEJËS NË ASPEKTIN E TURIZMIT

MSc. Albana Gazija
albanagazija@gmail.com

Abstrakt

Turizmi është një nga sektorët i cili po zhvillohet në masë të madhe dhe ritëm të shpejtë në botë. Turizmi ka një varg të gjerë të ndikimeve, duke përfshirë ndër të tjera ato ekonomike, mjedisore, social-kulturore dhe shpenzimet. Turizmi është një fenomen global, i cili ka tërhequr vëmendjen e interesave të sektorit publik dhe privat për shkak të prirjes për të gjeneruar përfitime ekonomike të konsiderueshme të tilla si punësimi, të këmbimit valutor, të ardhurat, të ardhurat nga taksat, etj. Vendet e zhvilluara dhe në veçanti vendet në zhvillim kanë filluar në krijimin e politikave të zhvillimit që lidhen me turizmin. Nevoja njerëzore për të ikur nga rutina e përditshme, dëshira për të kontaktuar me natyrën dhe kureshtja e njerëzve për të eksploruar vende të tjera dhe civilizime dhe nevojat e tyre thelbësore për argëtim dhe dëfrim janë gjithnjë e në rritje. Peja është një qytet i cili ka trashëgimi historike dhe kulturore dhe të burimeve natyrore. Ky studim synon të përcaktojë potencialin turistik të Pejës me analizën SWOT. Me këtë analizë vihen në pah anët e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e mundshme turistike dhe kërkesat e nevojshme për të përmirësuar turizmin në Pejë.

Fjalët kyqe: turizmi, destinacioni turistik, analiza SWOT, Peja.

JEL Kualifikimi:

1. Hyrje

Me zhvillimin e shpejtë teknologjik dhe inovacionet, globalizimi, konkurrenca, rritja e kërkesës turistike, rëndësia e marketingut të destinacionit është rritur në dekadën e fundit. Për të fituar përparësi konkurruese në destinacion, karakteristikat themelore të destinacioneve duhet të përcaktohen dhe vlerësohen. Për të arritur këtë qëllim, mund të përdoren teknika efektive siq është analiza SWOT.

Ky punim përpiket për të përcaktuar përparësitë dhe dobësitë e Pejës si një destinacion turistik, duke përdorur SWOT analizën, dhe të vë në dukje faktorët që krijojnë mundësitë dhe kërcënimet.

2. Definimi i SWOT analizës

Termi SWOT vjen nga shkronjat e para të katër fjalëve në gjuhën angleze: Fuqitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet. Vlerësimi i përgjithshëm i fuqive të një biznesi, dobësive, mundësive dhe kërcënimeve quhet analiza SWOT. Pra, kjo analizë është një mjet për planifikimin strategjik që përdoret për të vlerësuar pikat e forta, të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet e përfshira në një projekt ose në një ndërmarrje biznesi.

Analiza SWOT është distilimi i rezultateve të tregut të brendshëm dhe të auditimeve të jashtme të cilat tërheqin vëmendjen për të fortat dhe të dobëtat e organizatës dhe mundësitë e kërcënimet me të cilat përballet organizata.¹⁴

Analiza SWOT përbëhet nga analiza e mjedisit të jashtëm dhe e brendshëm.¹⁵ Pra, dy komponentet kryesore të saj janë:

1. Faktorët e brendshëm që përshkruajnë anët e forta ekzistuese dhe dobësitë.
2. Faktorët e jashtëm që përshkruajnë kërcënimet dhe mundësitë.

Një nga dallimet më të rëndësishme në mes të pikave të forta dhe të dobëta dhe mundësive dhe kërcënimeve është shkalla e kontrollit që menaxherët brenda një organizatë mund të kanë mbi to. Forcat dhe dobësitë rrjedhin nga kushtet e brendshme dhe për këtë arsye janë në kuadër të kontrollit të menaxherët të organizatës.¹⁶ Për shembull, në qoftë se analiza tregon se ka një ulje të produktivitetit në organizatë, atëherë problemi mund të trajtohet menjëherë nga menaxhmenti. Sidoqoftë, nëse kërcënimi për organizatën vjen nga perspektiva e sulmeve terroriste ndërkombëtare, atëherë përgjigjja e menaxherëve për zgjidhjen e problemit ka probabilitet të ulët, kështu menaxherëve vetëm iu mbetet t'i adaptohen faktorëve të jashtëm. Shih figurën më poshtë¹⁷

¹⁴ Ph.Kotler, V.Wong, J.Saunders & G.Armstrong "Principles of Marketing" fq.58

¹⁵ Philip Kotler "Marketing Management" fq.46

¹⁶ Clarke and Chen "International Hospitality Management, fq.97

¹⁷ Clarke and Chen "International Hospitality Management, fq.97

	Faktorë që ndihmojnë organizatën për arritjen objektivave të saj	Faktorët që pengojnë organizatën për arritjen e objektivave të saj
Faktorët e brendshëm nën kontrollin e menaxherëve të organizatës	Fuqitë	Dobësitë
Faktorët e jashtëm jashtë kontrollit e menaxherëve të organizatës	Mundësitë	Kërcënimet

Fig. 1. Ndërtimi i SWOT analizës

Analiza SWOT është një mjet analitik dhe planifikimit strategjik, i cili u krijua fillimisht për planifikim strategjik për qëllime marketingu. SWOT duhet të shihet vetëm si një mjet në një proces planifikimi të bazuar në njohuri të gjendjes së tanishme dhe tendencat. Për më tepër, në rezultatet e një analize SWOT janë të strukturuar informatat themelore, në një kuptim të përbashkët të realitetit dhe një sërë mundësish të përbashkëta strategjike. Pasi që informacioni nuk është i përsosur dhe e ardhmja është gjithmonë e panjohur, nuk është asnjëherë një përfundim i drejtë për t'u tërhequr nga dëshmitë e mbledhura në procesin e SWOT - supozimet janë të nevojshme.¹⁸

Pra, rezultatet e analizës SWOT janë zakonisht për formulimin e qëllimeve dhe një strategjie të zhvillimit, si edhe një prioritet i lartë i veprimeve që duhet të merren në terma të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë për të arritur qëllimin e zhvillimit.

2.1. Përdorimi i SWOT analizës në destinacionet turistike

Analiza SWOT mund të përdoret në shumë sektorë, në të njëjtën kohë është një mjet për të përfutur përcaktimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për potencialin turistik të një vendi ose një rajoni në mënyrë që të bëjë politika të qarta të formave tjera alternative të turizmit në atë vend. Për të vlerësuar kushtet mjedisore të bizneseve të turizmit, Analiza SWOT është një nga metodat më të përdorshme.

¹⁸ Victor T. C. Middleton and Jackie Clarke "Marketing in Travel and Tourism", fq.209

Për të qenë në gjendje për të analizuar problemet e marketingut të bizneseve dhe të jenë në gjendje të marrin vendime të drejta, ne kemi nevojë për informacion në lidhje me këto katër grupe. Bizneset e turizmit janë të prekura nga kushtet e brendshme dhe ndryshimet pozitive apo negative që ndodhin në kushtet e jashtme e mjedisit. Për shkak të strukturës së brishtë të sektorit të turizmit është e nevojshme për të aplikuar këtë analizë. Për shembull, destinacionet e turizmit janë të prekura nga përkeqësimi mjedisor, ndryshimet në shijet dhe preferencat turistike, paraqitja e destinacioneve të reja turistike dhe të llojeve të reja të turizmit, mbikapacitetin, luftërat dhe sulme të terrorizmit. Kështu, në një periudhë të shkurtër do të vjen deri te përballja me mungesën e kërkesës. Mungesa e kërkesës do të shkaktojë mbylljen e objekteve turistike në atë vend.

Nëse ky lloj i mungesës së kërkesës ndodh, nuk mund të gjendet një zgjidhje për ndërmarrjet e turizmit, veçanërisht ato të akomodimit. Sepse nuk është e mundur për të lëvizur ndërmarrjet e akomodimit në një rajon tjetër. Për këtë arsye është e nevojshme për të bërë analizën SWOT për të përcaktuar potencialin ekzistues të biznesit, si dhe të të ardhmen e mundshme të biznesit.

Analizimi i anëve të forta dhe të dobëta të një rajoni ose vendi do të ndihmojë për të zgjedhur strategji të përshtatshme për vendin apo rajonin. Përveç kësaj, vazhdimisht duhet të vlerësohen mundësitë alternative të vendit ose të rajonit të cilat ndihmojnë në vetëdijësimin për gabimet e mundshme dhe do të krijojnë një shans për të bërë rishikimin e nevojshëm. Informacioni që nxjerret me anë të analizës SWOT është shumë i rëndësishëm në realizimin e planeve strategjike të marketingut të destinacioneve turistike si edhe ndërmarrjeve të turizmit. Duke vënë në praktikë planin e marketingut strategjik, destinacionet e turizmit do të jenë në një pozicion të fort kundër destinacioneverivale.

Në studimin e analizës SWOT për një destinacion turistik, përgjigjet mund të kërkohen për pyetje e mëposhtme:¹⁹

1. Cilat janë produktet aktuale dhe shërbimet në destinacionin turistik?
2. Çfarë mund të jenë produktet dhe shërbimet në të ardhmen në destinacionin turistik?
3. Si është imazhi i destinacionit turistik në platformë kombëtare dhe ndërkombëtare?

¹⁹ Matthew Schwartz "Fundamentals of sales management", fq.58.

4. Çfarë është niveli i çmimeve të prodhimeve dhe shërbimeve në destinacion turistik?
5. Cilat janë avantazhet konkurruese dhe disavantazhet e destinacion turistik në krahasim me destinacionet e tjera turistike?
6. Çfarë është niveli i arsimit dhe përvojave profesionale të personelit që punon në qendrat turistike në destinacion?
7. A ka mundësi të arsimimit për njerëzit lokal dhe stafin që punon në atë destinacion?

Përveç pyetjeve të mësipërme, për një analizë SWOT duhet të marrë në konsideratë përcaktimi i përparësive dhe dobësive të vendit dhe kërcënimet dhe mundësitë që do të ndodhin në të ardhmen. Për shembull, politika monetare dhe fiskale, stabiliteti politik, qëndrimet e njerëzve lokal kundër turistëve, mundësitë e investimeve në turizëm në nivel vendi, niveli i zhvillimit të industrive të tjera përveç turizmit, cilësia e shërbimit të nivelit të akomodimit dhe të biznesit -objektet turistike, gjendja ekologjike, siguria, rreziku për shëndetin dhe problemet, infrastruktura adekuate, ndotja e mjedisit, klima, trashëgimia kulturore, festivalet dhe mundësitë e argëtimit, llojet e turizmit ekzistuese dhe mundësitë e zhvillimit të llojeve të tjera të turizmit të cilat krijojnë mundësi për të bërë analizën SWOT shumë dimensionale.

Analiza SWOT mund të bëhet për Pejën duke marrë në konsideratë këta dhe faktorë tjerë të ngjajshëm.

FUQITË

Klimë ideale: Klima është një faktor pozitiv bazë për zhvillimin e turizmit dhe Peja duket të ketë një avantazh konkurrues të fortë si qytet. Peja ka klimë kontinentale, me ndikim të klimës mediterane. Viset e ulëta të Pejës, karakterizohen me temperatura relativisht të larta me vlerë mesatare vjetore më tepër se 11°C, me muajt më të nxehtë Gushtin dhe Korrikun 21,7°C dhe 21,6°C dhe me muajin më të ftohtë Janarin - 0,5°C. Ekzistojnë kushte të përshtatshme klimatike për zhvillimin e turizmit veror e sidomos të atij dimëror.²⁰

Lokacioni strategjik: Komuna e Pejës shtrihet në pjesën veriore të Dukagjinit, në pjesën veri-perëndimore të Republikës së Kosovës. Kufizohet me Istogun (Burimin) në veri-lindje, Klinën në lindje, Gjakovën në jug-lindje, Deçanin në jug; me Republikën e Shqipërisë në jug-perëndim, me Malin e Zi në veri-perëndim dhe Serbinë në veri. Ka potencial të madh t'u

²⁰ Ministria e Industrisë dhe Tregtisë “Projektet e Produktit Turistik në Rajonin Turistik të Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare)”, fq.8

ndaluar për një pushim të shkurtër për në destinacion. Peja lidhet me çarkullimin rrugor me Prishtinën, Mitrovicën, Gjakovën, Rozhajën e Plavën.

Mbështetja nga qeveria lokale : Qeveria lokale e Pejës ofron mbështetje për industrinë e turizmit.

Ngjarjet: i njohur për ngjarjet sportive:

- Lojërat rinore në borë,
- Garat rinore sportive– olimpiada “Lugu i Baranit”,
- Turniri memorial në volejboll “Smajl Hajdaraj”,
- Turniri memorial në karate “Haki Ibërdemaj”
- Turniri memorial në Judo “ Fuat Gashi”,
- Shpallja e sportistit të vitit në prag të festive të vitit të ri,
- Mbajtja e garave të skijimit në qendrën e skijimit në fshatin Boge, sipas kalendarit të FSK (Federata e Skijimit të Kosovës)
- Organizimi i garave ndërkombëtare në automobilizëm dhe çiklizëm,
- Organizimi i lojërave tradicionale sportive “Rugova “.

Atraksionet kulturore: Peja disponon një llojshmëri të monumenteve të trashëgimisë kulturore që tregojnë historinë dhe kulturën, si p.sh. dhjetëra lokalitete arkeologjike, monumente sakrale kishtarë dhe islame, tyrbe, mejtepe, teqe, Sahat Kullë, kulla, kala, mullinj, ura, Çarshia, muzeun etnografik, etj. Ndër to vlejnë të përmendim:²¹

- Bajrakli (Çarshi) Xhamia. Është një nga objektet e rëndësishme sakrale arkitektonike të periodës osmane nga gjysma e dytë e shekullit XV-të. Xhamia e Fatih Sultan Mehmet Hanit e njohur me emrin Bajrakli - Çarshi xhamia e cila karakterizohet me arkitekturë të vjetër osmane, e cila ka kubën (kupolën) më të lartë në Pejë. Xhamia ka një kompleks varresh ku midis këtyre gjenden ato të shekujve XVI, XVII, XVIII dhe XIX. të patriotit të madh kombëtar Haxhi Zekës, Haxhi Mustafa Beut , Ali Pashë Gucisë.
- Hamami i Haxhi Beut është vepër monumentale me karakter shoqëroro-publik i ndërtuar (1462-1485).
- Konaku i Tahir Beut - paraqet llojin më të bukur të shtëpive të vjetra të qytetit të tipit asimetric në Pejë. Karakterizohet me kurrorën e kulmit të punuar nga druri, dritaret harmonike dhe divahanja e sipërme. Është i vendosur Muzeu Etnografik kombëtar ku mund të shihen të ekspozuara në galeri të ndryshme, artizanate tradicionale kombëtare, veshje karakteristike të Rugovës e të Rrafshit të Dukagjinit .

²¹ <http://kk.rks-gov.net/peje/Assembly-5.aspx>

- Kulla e Pashës (Haxhi Zekës), në muret e së cilës mund të shihen punimet karakteristike të mjeshtëreve shqiptar të asaj kohe si : luani, ylli i Davidit etj. Ka arkitekturë karakteristike të shekullit XVIII dhe XX , është dykatëshe e ndërtuar prej guri dhe me dritare e frëngji.
- Shatërvani i ndërtuar në shek. XVI i cili ndodhet në qendër të sheshit, aty gjendet kajnaku, krojet e xhamisë së kuqe (shek.XVI), kroi i Bajram Begut (shek XVI).
- Kulla e Gockajve e shek. XIX në të cilën është i vendosur Instituti regjional për mbrojtjen e monumenteve kulturore-historike. Kullat janë objekte që karakterizojnë arkitekturën e veçantë të ndërtimeve dhe zanatin e mjeshtëreve shqiptar në gdhendjen e gurit. Kullat në brendi karakterizohen me oden e miqve, me oxhak karakteristik, me rafte e kapakë të dollapëve dhe me tavan të gjitha të veshura me dru të gdhendur punim dore të qëndisura me mjeshtri.
- Konaku i Jashar Pashës - paraqet tipin më karakteristik të ndërtimit të shtëpive të vjetra për banim nga shekulli i kaluar. Në brendësi të ndërtesës posaçërisht theksohen: hamamet, dollapi, raftet, dritaret si dhe tavanet e dekoruara në pikëpamje artistike në oda.
- Kisha ortodokse e kohës së krishterimit të hershëm, e cila u ngrit në nivelin e Patrikanës në gjysmën e parë të shek. XIV. Në brendësi të ndërtesës ekzistojnë freska nga shekulli XIII dhe XI – të, si edhe nga periodat e më vonshme.
- Kisha katolike “Shën Katarina” si ndërtesë është e kohës së re (1928). Si famulli kisha e Shën Katarinës ekziston që nga Konkili i I-rë i Arbërit (1703) i udhëhequr nga Papa Klement Albanezi.
- "Çarshia e gjatë" me dyqanet karakteristike orientale. Pjesa më e ruajtur e kësaj Çarshie është pjesa e saj e quajtur "rrethishtja" (okoli) në mes të cilës gjendet fontana e vjetër .
- Mulliri i Haxhi Zekës. Është mulliri i parë në Kosovë dhe regjion i cili ka pasur një teknologji më të përparuar të sjellur nga Austria. Me këtë mulli ka filluar ekonomia industriale në këtë vend.

Atraksionet natyrore: Komuna e Pejës është e pasur me bukuri piktoreske me vlera të veçanta natyrore dhe mjedisit ekologjik (peisazhe me bukuri natyrore, flora dhe fauna, ekosistemet e rralla, zona të paprekura natyrore), që tërheqin turistët për t’u larguar nga stresi i punës dhe qytetet e ndotura .Terreni në këto zona turistike është i përshtatshëm në mënyrë

ideale për aktivitetet e ndryshme aventuriere. Ndër to vlejné të përmenden disa nga atraksionet magjepse natyrore:²²

- Kanioni i Rugovës ose siç quhet “ Gryka e Rugovës”, është gryka më e bukur dhe më interesante. Gjatësia e luginës është 12 km. Shpatijet e pjerrëta deri në 1500 m, burime të fuqishme karstike, ujëvara të larta deri në 30m, rrjedha e shpejtë e ujit Lumbardhi, që krijojnë ujëvara të vogla, një numër i shpellave ende të pahulumtuara, shkëmbinjë fantastike për ngjitje, llojllojshmëria e florës dhe faunës ia japin Grykës një bukuri të cilat mund t’i tërheqin shumë vizitorë.
- Drini i Bardhë është po ashtu një vend shumë i vizituar, sepse paraqet një bukuri të rrallë që veçohet me rrjedhën e tij dhe ujëvarën që e krijon. Ujëvara është e gjatë 25 m dhe paraqet një potencial turistik për vizitorët si nga ata vendorët, po ashtu edhe të jashtëm.
- Në regjionin e Rugovës më saktësisht në Leqinat gjenden në lartësi prej 1860 m, liqeni i madh dhe ai i vogli. Janë shumë interesant për vizitorë gjatë stinës së verës dhe paraqesin potencial shumë të madh për turizëm për pamjen e bukur dhe rrethinën e tyre të mbuluar me pyje të dendura pishe, ndërsa karakteristikë e liqenit të madh gjatë dimrit është se ai është i ngrirë plotësisht. Është me rëndësi të përmendet se në liqenin e madh zhvillohet lloji i gjallesës i quajtur Triton, i cili ka një formë të hardhucës dhe është mjaft interesant për vendin se ku rritet.
- Bukuritë që të magjepsin përbëjnë Bjeshkët e Rugovës si motive atraktive turistike në përbërjen e tyre morfologjike me kategori të ndryshme të lartësive, formave, përkatësisht majave malore, liqenet, luginat kanionike, etj. Maja më të lartë në regjionin e Rugovës është Guri i Kuq (2522 m). Majat tjera si: Hajla (2461m), Rusolia (2359m), Qfërle (1800m), Kopraniku (2100m), etj. për shkak të bukurive të pakrahasueshme të pejsazhit janë bërë destinacion i bjeshkatarëve, por edhe i qytetarëve të cilët dëshirojnë të pushojnë nga përditshmëria monotone.
- Shpella “Gryka e Madhe”e cila është studiuar në gjatësinë prej më shumë se 10km, rradhitet në një ndër më të gjatat në Ballkan. Ka pasuri të mëdha të stalagmiteve, stalaktiteve, perdeve të gjata deri në 10 metra, gurrave rrjedhëse, margaritar-shpellash, divane, liqe kristalor, si dhe shumë liqene të madhësive të ndryshme, disa ujëvara të cilat krijojnë mundësinë që vizitorët të dëfrehen

²² Komuna e Pejës “Plani Lokal i Veprimt në Mjedis 2009-2015” fq.31

dhe mahniten. Shpellat tjera mjaft interesante dhe atraktive për turistët janë shpella e Karamakazit me 85m gjatësi ku jeton një koloni shumë e madhe e lakuriqëve, shpella e Kallabes, e gjatë 72m, shpella e Burimit të Drinit të Bardhë (Shpella e Radacit), shpellat e vogla të Princeshës, e Jerinës, shpella e Demajve, etj.

- Lumi Lumbardhë i cili kalon nëpër qytet me rrjedhën e vet gjarpërore e ndanë qytetin në dy pjesë duke i dhënë një bukuri të veçantë, ndërsa brigjet e tij të gjelbërta janë shëtitore më të preferuara të pejanëve.

Shopping: "Çarshia e gjatë" me dyqanet karakteristike orientale. Aty ende mund të hasen në shitore origjinale të artizanateve të ndryshme duke filluar nga qeleshgjinjtë, zhgunagjinjtë, rrobaqepësit e ndryshëm, leshënrësit, punuesit e sexhadeve, saraçët, këpucëtarët, orëndreqësit, argjendarët e mirëfilltë etj. Poashtu ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i dyqaneve në qendër të qytetit të Pejës dhe qendrash tregtare.

Akomodimi: Një numër i konsiderueshëm i hoteleve, mjediseve të strehimit dhe e shërbimeve të pritjes. Hotele dhe motele kategoria e të cilëve shkon deri me katër yje dhe kapacitet relativisht të lartë të krevateve. Sipas statistikave të hotelerisë, në Pejë ekzistojnë 9 hotele, me numër të shtretërve gjithsej 101.²³

Ngrënia dhe argëtimi: Ekzistojnë numër relativisht i madh i restoranteve. Gastronomia Pejane karakterizohet me ushqimin autokton e origjinal, të freskët prej qumështi, kosi, djathi, kosi, maza, mjalti, fli, lakror, kaçamak, djathë të zier, leqenik, dhe bukë të shëndetshme të grurit dhe të misrit të pjekur në furrë, e gjithashtu prezent është edhe gastronomia orientale dhe evropiane ku zgjedhja e ushqimit është e gjerë dhe e llojllojshme.

Në tryezat e restoranteve dhe hoteleve pos verës së Rahovecit të njohur për kualitet të lartë, shërbehet "Birra Peja" e cila prodhohet në fabrikën e birrës në Pejë me kualitet të lartë. Jeta e natës në Pejë është mjaft e begatshme, ekzistojnë një numër i madh kafeterish, baresh, pubesh, klubesh ku mund të argëtohen të rinjtë.

Qendra e Skijimit në Bogë përbën një avantazh të madh konkurrues me destinacionet tjera turistike. Ky është një atraksion i famshëm turistik ofron për skijatorët një pistë skijimi relativisht të gjatë. Kjo qendër disponon një numër të konsiderueshëm pushimoresh, hotelesh e motelesh, si dhe restoranteve dhe përbën potencialin më të madh për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv.

Burimet njerëzore: Numër i konsiderueshëm i të kualifikuarve në sektorin e turizmit. Numri i lartë i studentëve që studiojnë në Fakultetin e

²³ Enti i Statistikave të Kosovës "Statistikat e Hotelerisë TM3 2010", fq. 6

Shkencave të Aplikuar të Biznesit , në drejtimin: Menaxhment, Turizëm dhe Hotelieri plotëson kërkesën e tregut të punës dhe investimet në arsim kanë filluar të jenë më intensive.

Qendra për Informimin e Turistëve ofron për turistët informata të mjaftueshme në lidhje atraksionet e njohura turistike dhe vendeve që janë interesante për t'u vizituar në Komunën e Pejës. Gjithashtu stafi i kësaj qendre i ndihmojnë turistët me informacione dhe këshilla për strehim, këshilla udhëtimi duke u ofruar harta turistike edhe informacione të tjera të dobishme.

DOBËSITË

Ndotja e mjedisit, zhurma dhe estetika rrjedh si pasojë e vazhdimit të ndërtimeve që po ndodhin në qytete, por edhe në zonat malore, prerja e drunjëve në mënyrë ilegale, ndotja e burimeve ujore për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza, ndërtimit të pakontrolluar, planifikimit joadekuat urbanistik, infrastrukturës jo adekuate, numrit të rritur të automjeteve, shkatërrimi i natyrës dhe mjedisit në disa zona, zhurma e krijuar nga ndotja e sektorit të dëfrimit. Problemet janë më të theksuara në sektorin e mbrojtjes së mjedisit. Depozitimi i pakontrolluar i mbeturinave në vendet e publike dhe mosmenaxhimi i i mirë i mbeturinave krijojnë përshtypje të keqe në lidhje me pastërtinë dhe janë faktorët që shkaktojnë përshtypje negative për vizitorët dhe mund të ndikojnë negativisht në pushimet e njerëzve.

Ekzistenca e rrjetit themelor të infrastrukturës, por në nivel jo të lartë duke përfshirë rrugët, stacionet hekurudhore, tubat e ujit, kanalizimi, rrjetet e telekomunikacionit, etj. Ekzistojnë probleme të furnizimit me ujë dhe kullimit, ujërat e zeza, rrugët e pamjaftueshme brenda qytetit, hapësira parkimi të pamjaftueshme, mungesa e sinjalizimit dhe ndriçimit.

Komunikimi jo i mirë i trafikut: Lidhje jo të mira të brendshme dhe të jashtme të trafikut, mosmirëmbajtja e rrugëve lokale, shtigjeve, etj., mungesa e rrugëve në disa vende rurale, mungesa e transportit publik, bllokimi i trafikut, disa vende nuk janë të arritshme sidomos gjatë periudhës së dimrit.

Administratë joefikase: Funksionimi i Administratës Publike karakterizohet nga një tempo e ngadalshme, të cilat mund të shkaktojnë efekte negative për zhvillimin e zonës. Pamjaftueshmëria e planeve për zhvillimin e turizmit, zbatimi i ngadalshëm i planeve dhe programeve të zhvillimit, shkëmbimi i informacionit nuk është e cilësisë së mjaftueshme. Ky është një fakt se burokracia është rezultat i organizimit të pamjaftueshëm dhe mungesës së metodave moderne administrative të cilat veprojnë si një

faktor kyq për ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë për individët dhe ndërmarrjet.

Cilësia e ulët e punës: Faktori njeri luan një rol shumë të rëndësishëm në furnizimin e produktit turistik në aspektin e produktivitetit dhe cilësisë. Pra, për arritjen e qëllimeve, është e nevojshme që punonjësit turistik të kenë nivel të lartë të etikës dhe të specializimit. Për fat të keq, një pjesë e rëndësishme e disiplinës turistike më të gjerë, në përgjithësi nuk i ka këto kualifikime dhe kështu ata vijnë në një pozitë të pafavorshme në krahasim me vendet e tjera. Ekziston një numër relativisht i lartë i punëdhënësve të pakualifikuar në fushën e turizmit dhe investimet nuk janë të mjaftueshme në zhvillimin e kuadrove, gjithashtu ka mungesë të stafit të trajnuar, etj.

Mungesa e marketingut turistik: Përpjekjet për të promovuar produktin turistik të Pejës gjykohen të jenë të pamjaftueshme dhe jo efektive. Kjo është kryesisht për shkak të mungesës së një plani të marketingut të plotë dhe afatgjatë që do të zbatohet në mënyrë efektive. Kjo ka si rezultat faktin që nuk ka bashkëpunim të madh dhe marrëveshje midis qeverisë lokale dhe bizneseve në lidhje me prioritetet dhe objektivat në mënyrë që t'i arritur ato.

Pasojat e luftës: Lufta e viteve 1998/99 ka lënë shumë pasoja, disa prej tyre janë cekur më poshtë:

- Disa objekte të cilat janë shkatërruar gjatë luftës nuk janë rinovuar.
- Zonat me mina.
- Koncept të gabuar e rinovimit.
- Procesi i papërfunduar i privatizimit.
- Një normë e lartë e papunësisë.

Mungesa e një strategjie zhvillimore për turizëm në nivel kombëtar shkakton probleme të mëdha për arritjen e qëllimit për zhvillimin e turizmit.

Mungesa e koordinimit në mes të sektorëve të ndryshëm: Nuk ekziston një koordinim midis turizmit dhe sektorëve tjerë të tillë si bujqësi, blegtoria, pemëtaria, industria ushqimore, zejtaria etj.

Numër i pamjaftueshëm i kapaciteteve të larta hoteliere: Mungesa e hoteleve me 5 yje në qytet.

Mbështetje e pamjaftueshme e medias. Turizmi nuk mbështet në masë të madhe nga media lokale. Problem tjetër që ekziston është zhvillimi jo në nivel të lartë të mediave lokale.

Numri i ulët i forcave të sigurisë: Ndjeshmëria e publikut për çështjet e sigurisë është tejet e madhe. Peja perceptohet nga publiku si një vend jo i sigurt si rezultat i krimeve që ndodhin, poashtu me një nivel të ulët të fuksionimit të gjyqësorit, etj.

MUNDËSITË

Krijimi e vendeve të punës: Zhvillimi i turizmit në Pejë ofron bazë të mirë në rritjen e punësimit që do të siguroj një burim jetese për shumë familje të punëtorëve. Njerëzit do të kanë një standard më të mirë të jetesës.

Ndalesë për pushim të shkurtër. Për shkak të vendndodhjes së saj dhe afërsinë e tregjeve të Malit i Zi dhe Shqipërisë përbën relativisht lidhje të mira rrugore me Evropën dhe pjesën tjetër të botës. Poashtu kombinimi i qytetit dhe skijimit bën Pejën një destinacion për një pushim të shkurtër. Kjo është një mundësi e madhe për të thyer monotoninë e udhëtimit të gjatë nga destinacionet nga Evropa. Peja nuk duhet vetëm të investojë në kapjen e këtij tregu, por edhe të krijoj destinacionin për qëndrimin e turistëve në periudha më të gjata.

Reformat institucionale:

- Nxitja e reformave të ndryshme në Pejë rrit shanset për ndryshime pozitive lokale .
- Hartimi i Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit.
- Hartimi i strategjive për zhvillimin e turizmit kongresial, rural, malor, shëndetësor, kulturor, etj.
- Nisma për krijimin e Parkut Ndërkufitar: Mali i Zi, Shqipëri dhe Kosovë.
- Shpallja e Bjeshkëve të Nemuna - Park Nacional.
- Hartimi i një strategjie për ruajtjen e biodiversitetit.
- Hartimi i programeve për riciklimin e mbeturinave.
- Hartimi i Planeve Rregullative në zonat e propozuara për Park Nacional.

Transferimi i njohurive dhe teknologjisë:

- Hapja e Universitetit “ Haxhi Zeka”.
- Kolegji Evropian Dukagjini.
- Numër i konsiderueshëm i të rinjëve të arsimuar, kualifikuar në sektorin e turizmit.
- Modernizimi i sistemit arsimor dhe miratimin e saj për sistemin eBE-së (deklarata e Bolonjës).
- Zhvillimi i infrastrukturës telekomunikuese dhe Internetit.

Inkurajim sipërmarrës vendas dhe të huaj:

- Ekzistimi i Strategjisë nacionale për zhvillimin e NVM-ve.
- Krijimi i fondit më të lartë kombëtar për mbështetje.
- Ofrimi i infrastrukturës së domosdoshme për krijimin e kushteve për investime në zhvillimin ekonomik e në veçanti në turizëm.
- Media.
- Bujqësia.
- Rinovimin e zanateve tradicionale.

- Autostrada Prishtinë-Pejë-Mali i Zi.

Ndryshime pozitive përreth:

- Stabilizimi politik dhe ekonomik në Ballkan.
- Bashkëpunimi bilateral dhe multilateral me vendet fqinje.
- Menaxhimi i mbeturinave - zhvillimi i qendrave të qarkut për hedhjen e mbeturinave.
- Lidhjet hekurudhore.
- Rritja e pushtetit të sektorit joqeveritar.

Burimet natyrore:

- Pasurimi dhe larmia e burimeve natyrore.
- Diversiteti hapësinor dhe biodiversiteti.
- Kushte të mira klimatike për zhvillimin e prodhimit bujqësor.
- Burimet e ujit.
- Potencialet ujore energjetike dhe të erës.

Burimet e Ekonomisë: Mundësinë e zhvillimit të tregtisë, bujqësisë, blegtorisë, pemëtarisë, zejtarisë, industrisë ushqimore dhe të pijeve, materialit ndërtimor dhe ndërmarrje shërbyese turistike, rritjen e numrit të agjencive turistike, etj.

Zhvillimi i llojeve të turizmit: Komuna e Pejës ka potencial për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit, të tilla si:

- Turizmi shëndetësor - ekzistimi i ujërave termale kanë rëndësi të madhe në zhvillimin e këtij lloji turizmi që gjenden në fshatin Iligje. Këtu gjendet edhe hoteli me një kapacitet të madh, i cili ofron kushte mjaft të mira për shërim.
- Turizmi dimëror - do të duhej të jetë forma më e zhvilluar e turizmit në regjion. Arsyeja rezulton në atë se Regjioni i Rugovës në përgjithësi e sidomos fshatrat Kuqisht, Boge, Shkrelë si dhe në pjesën veriore të Bjeshkëve të Nemuna në bjeshkën e Kopraniku, majen e Qfërles, Milishevcit dhe bjeshkës së Lumëbardhit, paraqesin kushte shumë të mira dhe të përshtatshme për ndërtimin e shtigjeve të shumta të skijimit me një pjerrtësi mjaft të madhe, të cilat mund të konkurrojnë edhe me terrenet me kushte më të mira evropiane në skijim.
- Turizmi kulturor - burim i madh i objekteve të rëndësishme kulturore të tilla si muzetë, objektet fetare, monumentet, kullat, etj., pastaj manifestimet kulturore, sportive dhe manifestime fetare përbëjnë një potencial të madh për zhvillimin e këtij lloji turizmi.
- Zhvillimi i turizmit konferencial, rural, ekoturizmit, gjuetia dhe peshkimi, speleoturizmi, alpinizmi si dhe forma alternative të turizmit avanturesk të tilla si kanu, kajak, ngjitja në bjeshkë, ecja

në bjeshkë, ngjitja në shkëmbinjë, çiklizmi dhe motorizmi në male, hedhja nga lartësitë me litar dhe parashutë, etj.

Rritja e numrit të objekteve akomoduese: Numri i madh i hoteleve, mjedisëve të strehimit dhe shërbimeve të mikëpritjes mund të plotësojnë kërkesën turistike.

Bashkëpunimi midis sektorit publik dhe privat: Përpjekjet për marketingun e turizmit mund të jenë të organizuar nga aktorët e sektorit publik në bashkëpunimin e partnerëve të sektorit privat, por edhe të gjithë qytetarëve në mënyrë që të përqendrohen në burimet për promovimin e turizmit dhe ndërtimin e imazhit pozitiv. Bashkëpunimi mund të ndodhë në aktivitete marketingu me qytetet dhe krahinat fqinje që mund të rrit ardhjen e vizitorëve të huaj, pastaj përmirësimi i produkteve të turizmit rural, promovimin e bujqësisë, përmirësimet mjedisore në fshatra, vende arkeologjike, parqe natyrore, etj.

Përmirësimi i rrjetit të transportit: Rrugët mund të përmirësohen duke i zgjeruar por edhe duke ndërtuar autostrada, në veçanti mund të përmirësohet rrjeti rrugor në zonat rurale. Në këtë mënyrë prodhimet vendore mund të promovohen. Gjithashtu duhet të mirëmbahen rrugët ekzistuese, ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, themelimi dhe operacionalizimi i transportit publik urban dhe ndër urban, etj.

Promovimi i të ushqyerit dhe të gastronomisë, si një "produkt turistik" të ri: Gastronomia si një produkt turistik me vlerë të lartë, çdo ditë po merr një pozitë të lartë në tregun turistik ndërkombëtar. Produktet dhe kuzhina e Pejës pretendojnë një pjesë të rëndësishme në të, për shkak të cilësisë së lartë dhe efektet e tyre të dobishme në shëndetin e njeriut. Produkte të tilla si mjalti, produktet e qumështit etj, por edhe shija unike e kuzhinës së Pejës i përgjigjet interesit vazhdimisht në rritje të Bashkësisë Ndërkombëtare, që kërkon cilësinë e ushqimeve. Pra, ky kombinim do të kompozoj një produkt të ri për Pejën me efekte të shumëzuar për turizmin dhe për prodhimin vendas.

KËRCËNIMET

Degradimi i mjedisit natyror: Zhvillimi i turizmit përbën rrezik të madh dhe dëme të pariparueshme ndaj mjedisit natyror nëse masat në nivel lokal dhe rajonal nuk janë marrë në mënyrë të kontrolluar dhe të kufizuar për aktivitetet turistike. Krijimi i njësisë të menaxhimit të orientuar për mbrojtjen e mjedisit dhe të kontrollit të zhvillimit turistik, si dhe sigurimin e masave nga organizatat e administratës lokale për ruajtjen e mjedisit natyror, janë veprime që nuk mund të shtyhet ose të lënë pas dore. Sipas këtyre masave, rëndësi duhet t'i jepet pastërtisë në vendet publike dhe mbledhjen dhe menaxhimin e mbeturinave. Qeveria duhet të marrë në konsideratë

mundësinë e krijimit të një entiteti, i cili do të ketë si objekt pastërtinë e zonave malore. Ligjet strikte të arkitekturës për infrastrukturën turistike duhet gjithashtu të votohen. Për këtë qëllim, krijimi i një entiteti që do të mbrojë peisazhit natyror duhet të shqyrtohet. Objektivi i këtij entiteti do të jetë imazhi arkitektonik dhe përshtatja stiliste e ndërtesave.

Niveli i ulët i bashkëpunimit mes sektorit publik dhe privat: Dobësia e bashkëpunimit efektiv mes sektorit publik dhe sektorit privat ka një efekt negativ në zhvillimin e turizmit të mëtejshëm të Pejës. Pasojë e kësaj mungese të bashkëpunimit, është fakti se deri më sot nuk janë ndërmarrë veprime të koordinuara për promovimin e produktit turistik në Pejë.

Pamjaftueshmëria në promovimin: Konkurrenca që Peja ka të bëjë si një destinacion turistik nga vendet e tjera të tilla si Mali i Zi, Shqipëria nuk është vetëm pasojë e destinacionit turistik më të mirë apo ofertës turistike më të mirë që ato ofrojnë, por është rezultat i përmirësimit të shpenzimeve dhe metodat e promovimit që ato miratojnë.

Biznes jo i favorësh përreth:

- Privatizim jo i mirë.
- Barriera administrative
- 5 www.webskola.com
- 6 www.business-navigator.biz

KUD 330.101.541(496.51)

INDIKATORËT MAKROEKONOMIK NË KOSOVË

Msc. Ariana Xhemajli
arianaxhemajli@gmail.com

Abstrakti

Jemi dëshmitarë të ndryshimeve të mëdha në aspektin ekonomik, e sidomos tek ne në Kosovë, pasi që ende jemi në faza të ndryshme të zhvillimit dhe përballemi me shumë peripeci gjatë këtijë procesi. Vet natyra e ekonomisë është shumë dinamike, dhe dinamizimi i sajë ka bërë që në shumë aspekte të ketë ndryshime të mëdha, që në shumicën e rasteve nganjëherë janë hapa pozitiv por edhe nganjëherë mund të jenë negativ, varësisht se si merren parasyshë përshtatshmëria dhe mundësia e stabilizimit të tregut. Rrethanat në të cilat gjendet vendi ynë, shpesh bëjnë që ekonominë në përgjithësi ta bëjnë të paefektshme, sepse ende nuk ka stabilizim të duhur, sepse duhet kohë, dhe pa marrë parasyshë gjërat jemi në një vend që papunësia ka zënë vend të gjerë, dhe që është shkaktari i parë destabilizues, dhe që bën të mundshme të ketë efekte negative, sepse një popull shumicë i papunësuar është sikur një shkollë ku s'ka mësues.

Indikatorët Makroekonomik në Kosovë

Teoria makroekonomike trajton çështjet dhe problemet ekonomike kryesore aktuale. Kuptimi i këtyre problemve kërkon që ato të thjeshtësohen nga hollësitë që i ndërlikojnë me të dhënat makroekonomike.

Ndër të dhënat e makroekonomisë dhe si indikatorë makroekonomik paraqiten:

- GDP ose të ardhurat
- Inflacioni
- Papunësia
- Shpenzimet
- Faktorët e prodhimit
- Mallrat dhe shërbimet

Prodhimi Vendor Bruto – GDP

Prodhimi vendorë bruto nga anglishtja (Gross Domestic Product) ose **GDP**³⁵, paraqet të ardhurat totale kombëtare dhe shpenzimin total për prodhimin e mallërave dhe shërbimeve.

GDP është vlera e tregut e të gjitha mallërave dhe shërbimeve të prodhuara brenda një ekonomie në një periudhë të caktuar kohore.

GDP shpesh konsiderohet si masa më e mirë për vlerësimin e performancës në ekonomi.

Qëllimi i GDP-së është të përmbledhë në një numër të vetëm vlerën në para të veprimtarisë ekonomike në një periudhë të caktuar kohore.

Kjo statistikë³⁶ mund të shihet në dy mënyra: njëra mënyrë është që ajo të shikohet si të ardhurat e gjithëmbarshme të çdo personi në ekonomi. Mënyra tjetër është që GDP të shikohet si tërësi e shpenzimeve të ekonomisë për prodhimin e mallërave dhe shërbimeve. Nga këto dy parashikime shihet qartë pse GDP është masë e performancës në ekonomi. GDP matë diçka për të cilët njerëzit kanë interes, e ato janë të ardhurat e tyre. Një ekonomi me prodhim të madh të mallërave dhe shërbimeve, më së miri mund të përmbushë kërkesat e familjeve, firmave dhe të Qeverisë.

Vlera e **Bruto Prodhimit Vendor** kalkulohet sipas formulës:

$$BPV = C + I + G + NX$$

ku elementet e caktuara paraqesin:

- $C = \text{Konsumi}$
- $I = \text{Investimet}$
- $G = \text{Shpenzimet qeveritare}$
- $NX = \text{Eksporti Neto (E- I)}$
- $E = \text{Eksporti}$
- $I = \text{Importi}$

C (Consumption) është konsumi privat në ekonomi. Kjo përfshinë shumicën e shpenzimeve personale të familjeve të tilla si ushqimi, qiraja, shpenzimet mjekësore dhe kështu me radhë, por nuk përfshinë strehimet e reja.

I (Investment) është definuar si investimet e biznesit ose nga familjet në kryeqytet.

G (Government spending) është shuma e shpenzimeve përfundimtare qeveritare për mallëra dhe shërbime.

X (Exports) është bruto i eksporteve. BPV është shuma që prodhon një vend, duke përfshirë prodhimet në mallra dhe shërbime të tjera për vendet e konsumin, pra janë shtuar eksportet.

³⁵ Prof.dr. Nexhat Muhaxheri “ Makreekonomi ” , Prishtinë,2005

³⁶ Prof.dr. Nexhat Muhaxheri “ Makreekonomi ” , Prishtinë,2005

M (Imports) paraqet bruto importet. Importet janë heqje nga mallrat e importuara do të përfshihet në kushtet G, I, ose C, dhe duhet të zbritet për të shmangur numërorin e huaj të furnizimit si vendas.

BPV i pjesëtuar me numrin e banorëve të ekonomisë së cilës i referohet paraqet një indikatorë tjetër - Bruto prodhimin vendor për kokë banori.

Në asnjë ekonomi në botë nuk ekziston shpërndarje e barabartë e pasurisë mes të gjithë banorëve të saj, ky tregues ekonomik jep indikacione relative mbi gjendjen ekonomike të banorëve të një ekonomie.

1.1 Llojet e GDP-së

GDP ndahet në tri lloje:

- GDP nominale
- GDP reale
- GDP deflatori

GDP nominale – paraqet vlerën e mallit dhe shërbimeve të matura me çmimet aktuale.

GDP nominale matë vlerën e sotme të prodhimit të ekonomisë shprehur në para.

GDP reale – paraqet vlerën e mallrave dhe shërbimeve të matura, duke përdorur një sërë çmimesh konstante.

GDP deflatori - matë çmimin e prodhimit krahasuar me çmimin e tij në vitin bazë.

1.1.2 Matja e GDP-së në Kosovë

Ekonomia e Kosovës është e vogël, tepër e hapur, ku importet arrijnë rreth 60% të BPV-së dhe me standardet e rajonit është e varfër, me BPV për kokë banori prej rreth 1,448 € në vit. Deri më tani, karakteristika kryesore që ka përshkruar më së miri ekonominë e Kosovës ka qenë niveli tepër i lartë i derdhjeve nga burime të tjera përveç eksporteve. Këto përfshijnë paratë e dërguara nga Diaspora, pagat e paguara stafit vendor nga sektori i donatorëve, dhe mallërat e blera nga donatorët dhe të punësuarit tjerë ndërkombëtarë.

Burimet kosovare nuk janë të mjaftueshme të financojnë investimet e kërkuara, sipas buxhetit shumë të ultë që kanë. Sfidat më urgjente për autoritetet kosovare ishte të ruajnë stabilitetin makroekonomik dhe të arrijnë një rritje ekonomike, në kërkim të zvogëlimit të nivelit shumë të lartë të papunësisë. Aktivitetet ekonomike të Kosovës janë mbështetur nga ndihmat e jashtme si dhe nga të ardhurat private të cilat së bashku arrijnë nivelin e

50 % nga Bruto Prodhimi Shoqërorë. Në fund të vitit 2004, ndihma nga jasht ka paraqitur vetëm gjysmën e saj nga viti 2000.

Vlerësohet me optimizëm për derdhje në sektorin privat në dekadën e ardhshme. Objektivi është që borxhi i marrur mos të kaloj 30 % të Bruto Prodhimit Shoqërorë në dhjet vitet e ardhshme.

Struktura e Bruto Produktit Vendor (BPV) përbëhet :

- Nga shërbimet 60%
- Nga bujqësia 20%
- Nga industria 20%

1.1.3 Bruto produkti në Kosovë me çmime aktuale

Treguesi kryesor dhe më i rëndësishëm makroekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare është Bruto Produkti Vendor (BPV), i cili paraqet rezultatet e aktiviteteve prodhuese të të gjitha njësive rezidente institucionale.

BPV në Kosovë për vitet 2004-2007 është rritë në vlerën prej 3.006,5 në 3.433,6 milion euro. BPV për kokë banori është rritë me të njëjtin trend, prej 1.473 euro në vitin 2004 , në 1.612 euro në vitin 2007.

Tabela 1 - BPV me çmime aktuale (Të dhënat provisionale)

	(në milion Euro)			
	2004	2005	2006	2007
BPV me çmime aktuale	3.006,1	3.068,3	3.191,6	3.433,6
Shpenzimet e konsumit final	3.298,1	3.434,6	3.560,3	3.913,1
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	2.539,1	2.705,7	2.864,7	3.248,4
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	735,5	705,2	670,8	641,6
Qeveria e Kosovës	355,5	329,2	340,8	327,3
Donatorët (pagat)*	380,0	376,0	330,0	314,4
Të punësuar të huaj	248,0	258,0	213,0	196,9
Të punësuar vendor	132,0	118,0	117,0	117,4
Shpenzimet e konsumit final të LPSHESH	23,5	23,7	24,8	23,1
Formimi i bruto kapitalit	701,3	722,2	798,3	892,6
Formimi i bruto kapitalit fiks	583,6	592,8	657,1	744,3
Ndryshimet në inventar	117,7	129,4	141,2	148,3
Eksporti neto	-993,3	-1.088,6	-1.166,9	-1.372,0
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	212,4	214,7	285,6	356,8
Eksporti i mallrave	56,9	56,3	110,8	165,1
Eksporti i shërbimeve	155,5	158,4	174,8	191,7
Importi i mallrave dhe shërbimeve	1.205,7	1.303,3	1.452,5	1.728,8
Importi i mallrave	1.028,7	1.100,2	1.251,9	1.506,2
Importi i shërbimeve	177,0	203,1	200,6	222,6
Popullsia (000)¹	2.041	2.070	2.100	2.130
BPV për kokë banori (Euro)	1.473	1.482	1.520	1.612

Popullesi (000)³⁷

Komponenti kryesor i Bruto Produktit Vendor është konsumi final i ekonomive shtëpiake, i cili është rritë nga 2.539,5 milion euro në vitin 2004 në 3.248,4 milion euro në vitin 2007. Konsumi është bazuar në pjesën më të madhe në importin e mallrave dhe shërbimeve. Kjo i kontribuon konsumit gjithsej të popullsisë, afërsisht 50%.

Formimi i bruto kapitalit (FBK) në përgjithësi merr pjesë me 26% në Bruto Prodhimin Vendor për vitin 2007. Shpenzimet e Qeverisë Qendrore në vitin 2004 marrin pjesë me 24,5% në Bruto Prodhimin Vendor, ndërsa me 18,7% në vitin 2007.

³⁷ * Përfshinë pagat e të punësuarve rezident të UNMIK-ut (pagat e të huajve, të cilët qëndrojnë më gjatë se një vit në Kosovë, stafit lokal të cilët punojnë në UNMIK, KFOR dhe organizata tjera)

⁴ * www.ks-gov.net/esk Statistikat Vitale të Kosovës

Tabela 2: Struktura e BPV sipas shpenzimeve (%)



	2004	2005	2006	2007
BPV me çmime aktuale	100.0	100.0	100.0	100.0
Shpenzimet e konsumit final	109.7	111.9	111.5	114.0
Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake	84.5	88.2	89.8	94.6
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	24.5	23.0	21.0	18.7
Qeveria e Kosovës	11.8	10.7	10.7	9.5
Donatorët (pagat)	12.6	12.3	10.3	9.2
Të punësuar te huaj	8.2	8.4	6.7	5.7
Të punësuar vendor	4.4	3.8	3.7	3.4
Shpenzimet e konsumit final të LPSHESH	0.8	0.8	0.8	0.7
Formimi i bruto kapitalit	23.3	23.5	25.0	26.0
Formimi i bruto kapitalit fiks	19.4	19.3	20.6	21.7
Ndryshimet në inventar	3.9	4.2	4.4	4.3
Eksporti neto	-33.0	-35.5	-36.6	-40.0
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	7.1	7.0	8.9	10.4
Eksporti i mallrave	1.9	1.8	3.5	4.8
Eksporti i shërbimeve	5.2	5.2	5.5	5.6
Importi i mallrave dhe shërbimeve	40.1	42.5	45.5	50.3
Importi i mallrave	34.2	35.9	39.2	43.9
Importi i shërbimeve	5.9	6.6	6.3	6.5

Vlera nominale e Bruto produktit vendor është rritë 7,6% në mes viteve 2007 dhe 2006. Një rritje të rëndësishme e kishte formimi i bruto kapitalit , i cili shprehur në vlerën nominale në vitin 2007 në krahasim me vitet e më parme është rritë për 11,8%.

Edhe pse pjesëmarrja e eksportit në Bruto produktin vendorë është shumë e vogël, duhet te theksohet se kishte një rritje domethënëse në vitin 2007.

Tabela 3: Shkalla e rritjes nominale (%)

	2005/2004	2006/2005	2007/2006
BPV me çmime aktuale	2.1	4.0	7.6
Shpenzimet e konsumit final	4.1	3.7	9.9
Shpenzimet e konsumit final te ekonomive shtëpiake	6.6	5.9	13.4
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	-4.1	-4.9	-4.4
Qeveria e Kosovës	-7.4	3.5	-4.0
Donatorët (pagat)	-1.1	-12.2	-4.7
Të punësuar te huaj	4.0	-17.4	-7.6
Të punësuar vendor	-10.6	-0.8	0.3
Shpenzimet e konsumit final të LPSHESH	0.9	4.6	-6.9
Formimi i bruto kapitalit	3.0	10.5	11.8
Formimi i bruto kapitalit fiks	1.6	10.8	13.3
Ndryshimet në inventar	9.9	9.1	5.0
Eksporti neto	9.6	7.2	17.6
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	1.1	33.0	24.9
Eksporti i mallrave	-1.1	96.8	49.0
Eksporti i shërbimeve	1.9	10.4	9.7
Importi i mallrave dhe shërbimeve	8.1	11.4	19.0
Importi i mallrave	7.0	13.8	20.3
Importi i shërbimeve	14.7	-1.2	11.0



Përfundimi

Me anë të këtij punimi kuptuam që teoria makroekonomike studion sjelljen e ekonomisë në tërësi, pra, rritjet dhe rëniet ciklike të prodhimit, produktin total të të mirave e shërbimeve dhe rritjen e tij, normat e inflacionit dhe papunësisë, bilancin e pagesave dhe kurset e këmbimit. Në këtë punim jam munduar që të trajtojë qështjet me aktuale dhe problemet ekonomike kryesore që përballen vendi ynë. Këto probleme më të mëdha janë : GDP për kokë banori që është shumë e ulët ,inflacion i lartë, papunësi mjaftë e madhe etj. Sa i përket ekonomisë nacionale, Kosova si një ekonomi e vogël, pa dalje në detë, e ardhmja e Kosovës varet në mënyrë kritike nga aftësia e saj për t'i hapur kufinj të dhe për të përfituar nga tregtia ndërkombëtare. Dëshmitë empirike vërtetojnë se shtetet e vogla mund të arrijnë norma të larta rritjeje kur ekonomia është e hapur, nuk ka kontrollë të lëvizjeve të kapitalit, ambienti i biznesit nuk pengohet nga rregulloret dhe ekziston një treg liberal i punës që rezulton në një fuqi punëtore të lëvizshme. Kosova ka një regjim liberal të tregtisë, i cili karakterizohet me thjeshtësi dhe neutralitet, tipare kryesore që konsiderohen të jenë të rëndësishme për stimulimin e rritjes së sektorit privat, si dhe për krijimin e kushteve për eksport të mirë. Mirëpo, pasi që liberalizimi i tregtisë nuk ka qenë i shoqëruar me përmirësimin e aftësisë konkurruese të sektorëve prodhues vendorë të sapokrijuar, Kosova po ballafaqohet me deficit të lartë tregtarë.

Literatura

1. Banka e Shqipërisë, Sheshi “Skënderbej”, Nr.1, Tiranë
2. Statistikat financiare ndërkombetare
3. Ekonomia dhe Organizimi i Ndermarjeve
4. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
5. Organizata e Kombeve të Bashkuara për zhvillim UNDP
6. Instituti i Statistikave
7. Instat
8. Shërbimi Doganor i Kosovës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë
9. Prof.dr Muhamet Sadiku , “Trade liberalization, foreign trade and integrated export policy in Kosova”, Tirana, 2004
10. MTI “Shkëmbimet Tregtare të Kosovës për vitin 2007”, Mars 2008
11. BANKA BOTËRORE ”Memorandumi Ekonomik i Kosovës” 27 Prill 2004

12. Instituti për Efikasitetin e Shtetit , “Kosova, Zhvillimi i Strategjisë për të Ardhmen”, 2007
13. Dokumenti Punues i Stafit të Komisionit Evropian, “Raporti mbi progresin”, Komisioni Evropian, 2007.

LIGJI MODEL UNCITRAL PËR ARBITRAZHI I TREGTISË NDËRKOMBËTARE

*Dr. Armand Krasniqi
mandikrasniqi@gmail.com*

Abstrakt

Arbitrazhi është njëra ndër metodat e zakonshme bashkëkohore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të cilat eventualisht lindin gjatë zhvillimit të operacioneve në tregtinë ndërkombëtare. Është një mjet privat i zgjidhjes së konflikteve bazuar në marrëveshjen paraprake të palëve për t'ia referuar kontestin eventual për një gjykatë private. Kjo formë dhe metodë për të zhvilluar një çështje gjyqësore zakonisht preferohet për një seri arsyesh. Zhvillimi i procedurës para gjykatës së arbitrazhit ka tendencë të jetë shumë më i shpejtë se sa çështje e njëjtë kontestimore t'i adresohet një gjykatë kombëtare për t'u realizuar respektivisht gjykuar. Një gjykatë e arbitrazhit e kontraktuar – caktuar për të dëgjuar dhe zgjidhur një mosmarrëveshje sipas praktikave, me siguri të madhe do të kushtojë vëmendje të plotë e të vazhdueshme çështjes kontestimore. Gjykata e rregullta zakonisht kanë kohë të limituar, listat të gjata e të ndryshme të rasteve të cilat kërkojnë një përqendrim dhe vëmendje me të thelluar për gjykuar një rast, gjë e cila paraqet situatë të vështirë. Edhe pse gjykatat e arbitrazhit duhet të plotësojnë kërkesat e drejtësisë natyrore dhe të vendosin në pajtim me ligjin ato duhet dhe mund të miratojnë procedura fleksibile dhe të shpejtë. Arbitrazhi mund të jetë më i shtrenjtë se sa një proces gjyqësor i zhvilluar në një gjykatë të rregullt, megjithatë tregtarëve u konvenon dhe parimisht pajtohen që të qëndrojnë në këtë procedurë për të fituar në kohë dhe thjeshtësi procedurale. Përveç kësaj, shpenzimet e arbitrazhit zakonisht duhet të jenë të përballueshme nga palët dhe sipas rregullit nuk tatimohen nga të tatimpaguesit. Tregtarët shpesh preferojnë intimitetin e procesit të arbitrazhit për publicitet që merr pjesë gjatë procedurës gjyqësore.

Fjalët kyçe: Arbitrazh, gjykatë, konventa ndërkombëtare, ligji, vendimi i arbitrazhit;

Hyrja

Një pjesë e vendeve të Evropës Jug - lindore ende gjendet në fazën fillestare të procesit të anëtarësimit në Unionin Evropian. Pa asnjë dyshim,

procesi i harmonizimit dhe përafrimit të së drejtës vendore me të drejtën e Unionit Evropian, parasëgjithash parimeve të parapara në Librin e Bardhë që i dedikohet përgatitjeve të anëtarësimit, janë detyra të rëndësishme të institucioneve shtetërore. Në kuadër të këtij procesi fillimisht duhet të kontribuojnë institucionet akademike – shkencore të cilat konsiderojmë që tani më kanë arritur njohuri për të drejtën evropiane duke e shqyrtuar edhe procesin e harmonizimit sipas standardeve të kërkuara. Natyrisht, kjo bazë fillestare e fillimit të procesit të harmonizimit të legjislacionit të vendit të caktuar me atë të Unionit Evropian duhet iniciohet bazuar në traditën nacionale legjislative por edhe në bazë të metodave komperative të vendeve të cilat e kanë kaluar ose janë në këtë proces. Ky proces para së gjithash është edhe projekt institucional i cili përveç që u dedikohet qytetarëve të vendit përfitues i bënë edhe të gjitha ministrinë dhe organet ligjdhënëse. Në kuadër të kësaj veprimtarie harmonizuese rol të rëndësishëm luan edhe kompletimi i legjislacionit të brendshëm për arbitrazhin. Ky legjislacion jo vetëm që ndikon në shkarkimin e punës të cilën e kanë gjykatat e rregullta të vendit për zgjidhjen e tërësisë së çështjeve kontestimore në lëmin e biznesit por në mas të madhe ndikon në rritjen dhe garantimin e investimeve të huaja. Kjo për faktin se nëpërmjet të kontratave arrihet që të kontraktohet kontesti eventual në gjykatën e arbitrazhit si metodë dhe formë e specializuara për zbatimin e legjislacionit komunitar. Tregtarët shpesh preferojnë intimitetin e procesit të arbitrazhit dhe përjashtimin e parimit të publicitet që merr pjesë gjatë procedurës gjyqësore.

Arbitrazhi në kontekstin historik

Tani më nuk është kontestuese se arbitrazhi³⁸ në shoqërinë njerëzore ekziston që nga kohërat e vjetra. Sipas disa mendimeve dhe botimeve të ndryshme arbitrazhi ka ekzistuar gjithmonë dhe rrjedhimisht është i vjetër po aq se edhe vet shoqëria njerëzore. Për shkak të natyrës që ka në qarqet akademike konsiderohet se fenomeni arbitrazh i ka tejkaluar perceptimet internacionale dhe tani parqet një fenomen përfundimisht intelektual.³⁹

Duke i përmbledhur burimet historike për kuptimin, rolin ekzistencën, etj, të arbitrazhit mund të identifikojmë burime të hershme dhe atë që nga Greqia antike, Roma e vjetër, vendet e lindjes së afërt dhe të

³⁸ Fjalori i shqipes së sotme – botimi Toena Tiranë 2002 fjalën Arbitrazh e sqaron në dy kuptime. E para; nënkuptohet zgjidhje e mosmarrëveshjeve ndërmjet të palëve të ndryshme nga ana e një komisioni arbitrash, ndërkaq e dyta; Organ i posaçëm, që merret me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me karakter ekonomik, financiar, etj, ndërmjet palëve të ndryshme. Sipas fjalorit me fjalë e shprehje të huaja të autorit Mikel Ndreca i botuar nga Rilindja Prishtinë në vitin 1986 fjala arbitrazh rrjedh nga fjala frënge arbitrage – gjykim nga arbitri ndërkaq kuptimi i fjalës është identik si në fjalorin e cituar në sipër.

³⁹ Jarrosson CH., La notion d'arbitrage, Paris 1987 fq, 1

mesme. Andaj, mund të përfundohet se arbitrazhi është një institucion i vjetër që ka lindur dhe është zhvilluar gjatë periudhave të caktuara kohore pothuajse në shumicën e territoreve të vendeve. Deri në mesin e Shekullit XIX, ka dominuar lloji i arbitrazhit tradicional, roli i të cili ka qenë para së gjithash ruajtja marrëdhënieve të mira në mes të njerëzve të cilat në ndonjë formë kanë qenë të detyruar të jeton në bashkësi siç është rasti me familjen, të afërmit, etj.. Deri të arbitrazhi ka ardhur vetëm në rastet më ekstreme kur papajtueshmëritë respektivisht kontestet që kanë lindur kanë qenë aq të mëdha sa për zgjidhjen e tyre është dashur intervenimi i palës së tretë. Palët në kontest për arbitër kanë zgjedhur personin e caktuar ku gjykimi, dija, objektiviteti, besimi dhe autoritet i të cilit nuk qenë aspak të dyshimtë. Duhet theksuar se sipas këtij modeli janë menaxhuar dhe rregulluar kontestet politike dhe pronësore edhe në polisat e vjetra greke. Ky lloj tradicional i arbitrazhit edhe sot nuk është braktisur për të rregulluar konteste të caktuara në jetën shoqërore dhe përkrah tij janë zhvilluar edhe lloje të reja të cilat mund të klasifikohen sipas kriterëve të ndryshme. Sipas autorit Pak, arbitrazhet mund të klasifikohen sipas disa kriterëve: sipas mënyrës së zgjidhjes së kontestit: arbitrazhet që kontestet i zgjidhin me mjete juridike dhe arbitrazhet të cilat kontestet i zgjidhin me mjete jo juridike; sipas palëve pjesëmarrëse: arbitrazhet të cilat zgjidhin konteste në mes të shteteve sovraane, arbitrazhi për tregti të jashtme që zgjidhë kontestet nga lëmi i tregtisë ndërkombëtare dhe arbitrazhi për zgjidhjen e kontesteve nga tregtia me mallra dhe shërbime që qarkullojnë në sferën nacionale ose raporteve biznesore pa elementin e jashtëm; sipas qëndrueshmërisë: arbitrazhe të tregtare të përhershme dhe të përkohshme (ad hoc); sipas tërësisë së normave që vlejnë: arbitrazhe për tregti të jashtme të cilat i takojnë sistemit ndërkombëtar, arbitrazhin tregtar nacional respektivisht arbitrazhin e odave tregtare dhe arbitrazhin *ad hoc*.⁴⁰

Ky punim trajton kontratën në bazë të së cilës kontrahetohet kompetenca e arbitrazhit ndërkombëtar (të përhershme – institucionale ose të përkohshme – ad hoc) për tregti për zgjidhjen e kontesteve të karakterit pasuror me element ndërkombëtar me ç'rast palët në bazë të kompetencave ligjore ua besojnë zgjidhjen e kontestit dhe vendimin e konsiderojnë të formës së prerë sikurse çdo vendim tjetër gjyqësor.

Zhvillimi i një arbitrimi të këtillë në kuadër të rregullimit të marrëdhënieve tregtare ndërkombëtare konsiderohet fenomen relativisht i ri. Që në fillim të Shekullit XIX disa shoqëri tregtare kanë filluar që të respektojnë arbitrazhat si institucione të përhershme dhe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve nga sfera e tregtisë ndërkombëtare. Rregullat e këtyre

⁴⁰ Pak M., Priznanje I izvršenje sudskih arbitražnih odluka, Zbornik postdiplomskih specijalističkih studija na Pravnom Fakultetu

u Beogradu, me thirrje Ugovonri u međunarodnoj trgovini I, Beograd, 1987

arbitrazheve gradualisht e kanë tejkaluar legjislacionin e vendit dhe janë shndërruar në një sistem autonom i cili është pëlqyer dhe zbatuar nga subjekte të fuqishme ekonomike. Rast tipik subjekteve të këtilla biznesore paraqesin shoqëritë e sigurimit *Lloyd* në Londër si dhe Shoqëria e tregtarëve të miellit *London Corn Trade Association*.⁴¹ Motivi i cili i ka shtyrë subjektet biznesore që lidhur me kontratat ndërkombëtare të kontraktojnë kompetencën e arbitrazhit në rast të ndonjë kontesti ka qenë dëshira që kontesti të zgjidhet me ligj dhe drejtë më mënyrë specifike duke i marrë parasysh doket profesionale dhe rregullat e caktuara të sjelljes. Vet natyra komplekse e strukturës të marrëdhënieve të tregtisë së jashtme kërkojnë një shkallë të lartë të kujdese me rastin e zgjidhjes së këtyre kontesteve. Palët në këto konteste ju takojnë botës së biznesit e që qëllimi parësor i tyre është në përgjithësi zhvillimi i veprimtarisë biznesore sipas parimit të njohur në tregtinë ndërkombëtare “*goodwill*”. Ky parim shpesh shumë më të rëndësishëm e konsideron ruajtjen e marrëdhënieve të mira dhe fer biznesore se sa edhe fitimin e ndonjë kontesti të caktuar. Roli i arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare para së gjithash nuk është vetëm zgjedhja e kontesteve. Nisur nga kjo, arbitrazha para vetës ka edhe misionin e ndërtimit të një praktike tregtare fer dhe parimit juridik – biznesor *bona fides*. Për arbitrazhin potencohet se vepron edhe si faktor psikologjik që jo rrallë ka rol vendimtar në sjelljen e palëve në veçanti të atyre subjekteve të cilat nuk ju përmbahen standardeve ndërkombëtare të tregtisë.⁴²

Përparësitë e zgjidhjes së kontesteve biznesore ndërkombëtare nëpërmjet të arbitrazhit

Arbitrazhi tregtar ndërkombëtar jo vetëm që paraqet një institucion specifik e kompleks për nga forma e krijimit por vlerësohet të jetë një institucion i përbërë nga një tërësi metodash të procedimit për zgjidhjen e kontesteve që lindin, zhvillohen dhe përfundojnë në sferën e operacioneve të tregtisë ndërkombëtare. E veçanta e këtij institucioni është kompetenca që buron nga vullneti dhe konsensualiteti i palëve kontraktuese.⁴³ Është e njohur se karakteri dhe struktura e komplikuar e marrëdhënieve biznesore ndërkombëtare jo vetëm që kërkon kujdes maksimal por dhe trajtim të veçantë me rastin e paraqitjes dhe të zgjidhjes së tyre nga kjo sferë. Njëri ndër motivet themelore që i shtynë subjektet të përcaktohen që brenda një kontrate biznesore ndërkombëtare, e cila i referohet rregullimit operacioneve dhe marrëdhënieve specifike, në rast të paraqitjes së ndonjë kontesti eventual, është caktimi i saktë kompetencës së gjykatës së arbitrazhit për

⁴¹ Po aty

⁴² Goldsatjn A & Triva S., Međunarodna trgovacka arbitraža, Zagreb 1987 fq. 10

⁴³ Këtë konstatim e potencojn shumica e autorëve që e trajtojnë çështjen e arbitrazhit

=====

zgjidhje e tyre. Kjo për shkak të mbizotërimit të bindjes se çështja kontestuese do të zgjidhet drejtë, shpejtë, profesionalisht dhe nga personalitete që kanë kualifikime dhe cilësi të duhura morale dhe profesionale. Palët para arbitrit të kësaj gjykate zakonisht i takojnë botës së biznesit qëllimi i të cilëve është ushtrimi i aktivitetit biznesor. Nga këto arsye palët ndonjëherë kanë interes më të madh që në këto marrëdhënie t'i ruajnë lidhjet e tyre biznesore dhe pozitën autoritative se sa edhe të fitojnë kontestin e iniciuar.

Roli i arbitrazhit në tregtinë ndërkombëtare nuk është i bazuar vetëm në zgjidhje të kontesteve të caktuara. Para së gjithash ky institucion para vetës ka misionin e ndërtimit të një praktike të bazuara në parime të *fer play* dhe *bona fide* në kuadër të aktiviteteve tregtare ndërkombëtare në përgjithësi. Për arbitrazhin potencohet se vepron edhe si faktor psikologjik që në vazhdimësi ka rolin e injorimit të subjekteve të caktuara të cilat nuk i pranojnë dhe bojkotojnë standardet e pranuar tregtare ndërkombëtare. Andaj, në sferën e qarkullimit dhe operacioneve tregtare ndërkombëtare parimisht në konsideratë merren edhe qëndrimet e arbitrazhit. Sipas rregullit, përveç qëndrimeve të arbitrazheve, konsiderohen, vlerësohen dhe analizohen edhe efektet që vinë nga rreziqet në rast të zgjidhjes së kontestit para këtyre gjykatave. Edhe në këtë kuptim, arbitrazhi kontribuon në tejkalimin e kontesteve dhe krijimin e kushteve për vijimin e rregullt të transaksioneve tregtare ndërkombëtare. Për këtë arsye arbitrazhi ka rol të rëndësishëm jo vetëm në sferën e të drejtës por edhe në sferat e marrëdhënieve politike dhe ekonomike.

Rëndësia e pranimit të palëve kontraktuese që kontesti eventual i tyre të zgjidhet nga ndonjëra nga arbitrazhet kompetente nga lëmi i tregtisë ndërkombëtare është e themeluar edhe për shkak të mosbesimit që këto palë kanë në gjykatat nacionale të vendeve të huaja. Pavarësisht nga parimet dhe bindjet e vendeve të palëve të caktuara për pa anshmërinë gjykatave të rregullta nacionale, prapë se prapë praktika jo rrallë ka treguar se ka raste kur këto gjykata kanë qenë të një anshme në favor të palës vendore. Situata e këtillë e ka favorizuar dhe aktualizuar arbitrazhin si forume serioze e të paanshme në zgjidhjen e kontesteve. Në përcaktimin e palëve të interesuara për arbitrazh ka ndikuar edhe mundësia e zgjedhjes së arbitrit të cilët janë zakonisht ekspertë të qarkullimit tregtarë ndërkombëtar me njohuri të mjaftueshme për teknikat dhe operacionet e biznesit. Ashtu siç mund të zgjedhin arbitrin ose panelin e arbitrave, palët lirshëm kanë mundësi të deklarohen se sipas të cilës së drejtë materiale dhe procedurale do të procedojnë. Përveç kësaj, palët sipas parimit të konsensualitetit kanë të drejtë të zgjedhin vendin e arbitrazhit që nënkupton zgjedhjen e vendit nga i cili arbitri do të nxjerrë vendimin që ka rëndësi shumë ta madhe në fazën e ekzekutimit të tij.

Rëndësia e veçantë e arbitrazhit qëndron pikërisht në shpejtësinë dhe efikasitetin procedural. Në kuadër të procedimit – gjykimit të arbitrazhit sipas rregullit gjykimi është një shkallësh dhe më pak formal se sa ai që nxjerrët gjatë procedurës në gjykatë të rregullt. Vendimit i arbitrazhit është meritore dhe ndaj tij palët nuk mund të ushtrohet ankesë. I vetmi mjet juridik i cili mund të ushtrohet ndaj këtij vendimi është kërkesa për prishjen e vendimit të arbitrazhit për të cilin vendos gjykata e shtetit kompetente sipas vendit ku është zhvilluar procedura. Megjithatë, prishja e vendimit të arbitrazhit mund të ushtrohet vetëm më pretendimet se nuk janë respektuar kushtet procedurale dhe në asnjë mënyrë për shkak të kushteve materiale dhe faktike. Procedura para arbitrazhit është jo publike për shkak të interesit dhe fshehtësive biznesore që kanë palët. Të gjitha këto rrethana kanë ndikuar që arbitrazhi të fitojë rol primar në sferën e zgjidhjes së kontesteve të qarkullimit të tregtisë ndërkombëtare dhe jetës biznesore.

Burimet juridike ndërkombëtare

Konventat ndërkombëtare

Rol vendimtar në evoluimin dhe avancimin e arbitrazhit, në veçanti në sferën e marrëdhënieve të tregtisë ndërkombëtare, kanë pasur dhe kanë konventat e karakterit multilateral, regional dhe bilateral. Dy konventat e para multilaterale sipas të cilave është rregulluar çështja e arbitrazhit ndërkombëtar datojnë para Luftës së Dytë Botërore në kuadër të Lidhjes së Kombeve të lidhur në Gjenevë. Këto janë Protokolli mbi arbitrazhin i nxjerrë më 24 shtator 1923 (*i njohur si Protokolli i Gjenevës*) dhe Konventa për ekzekutimin e vendimeve të arbitrazheve të huaja e datës 26 shtator 1923 (*e njohur si Konventa e Gjenevës*). Në kohën e nxjerrjes së tyre, këto dokumente janë cilësuar të një rëndësie të veçantë duke i pasur parasysh faktet se ato kanë arritur që me shpejtësi t'i tejkalojnë vështirësitë që janë paraqitur me herët nga ky lëmë. Progresin të cilin e fitoj arbitrazhi posaçërisht sipas dispozitave të Konventës për pranimin e ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit ndërkombëtar të vitit 1958 (e njohur si Konventa e New Yorku – t) patën ndikim në zbehjen dhe uljen e rëndësisë së Protokollit të Gjenevës dhe Konventës së Gjenevës. Këto ky dokumente nuk vlejnë më në mes të shteteve të cilat e kanë pranuar dhe Konventën e New York – ut.⁴⁴ Konventat e sipërpërmendura zbatohen vetëm për ato vendet të cilat nuk janë nënshkruese të Konventës së New York – ut, si dhe atyre të cilat e kanë ratifikuar këtë Konventë. Konventa e New York – ut deri me tani paraqet instrument universal juridik – konventë të veçantë ndërkombëtar nga sfera

⁴⁴ Neni VII/2 i Konventës së Nju Jorkut

arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare. Kjo konventë të cilën deri me sot e kanë pranuar rreth 160 shtete zbatohet dhe interpretohet nga ana e gjykatave të një numri të madh të shteteve dhe njëkohësisht paraqet lëndë të veçantë për trajtim shkencor nga doktrina në tërë botën.⁴⁵

Në kuadër të konventave të karakterit regjional të cilat e rregullojnë arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare e rëndësishme është Konventa Evropiane për arbitrazhin ndërkombëtar e nxjerrë me 21 prill 1961 në Gjenevë nga ana e Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën. Këtë konventë deri me sot e kanë pranuar 26 shtete evropiane. Sipas qëndrimit të përgjithshme doktrinar, Konventa Evropiane paraqet një etapë të rëndësishme të evolucionit të së drejtës së arbitrazhit të tregtisë së jashtme. Në fund, kur është fjala për konteste nga sfera e investimeve, me rëndësisë të posaçme për zgjidhje të tyre në mes të shtetit dhe subjekteve të caktuara si dhe në mes të vet shteteve është Konventa e Uashingtonit datës 18 mars 1965 e pranuar nga 130 shtete.⁴⁶

Ligjet – model si rregulla të rëndësishme për harmonizimin e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare.

Njëri nga dokumentet më të rëndësishme për unifikimin dhe harmonizimin e bazës ligjore të arbitrazhit për tregti ndërkombëtare është Ligji – model i arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare i cili është miratuar nga Komisioni i KB me 21 qershor 1985 për të drejtën tregtar ndërkombëtare (UNCITRAL)⁴⁷ Qëllimi themelor i sjelljes së Ligjit – model është konstatuar në përcaktimin e rregullave të përgjithshme të cilat do t'i përcaktonin standardet moderne të një arbitrazhi për tregti ndërkombëtare që do të pranoheshin nga sistemet juridike të shteteve pavarësisht se çfarë sistemi ekonomik që kanë. Në këtë kuptim me Rezolutën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara të datës 11 dhjetor 1985 shteteve u është "rekomanduar që të marrin në konsiderim Ligjin – model kur të nxjerrin ose kryejë ndonjë revizion të legjislacionit të vet në mënyrë që ai t'u përshtatet nevojave bashkëkohore për arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare".⁴⁸

Edhe pse ndryshimet në mes të sistemeve juridike nacionale kanë sjellë komplikim në unifikimin e bazës legjislative për arbitrazhin ndërkombëtar, roli i Ligjit – model sot vlerësohet i kënaqshëm. Shkakun e këtij suksesi pa asnjë dyshim duhet kërkuar në karakterin fleksibil të harmonizimit që ky dokument reflekton. Për ndryshim nga legjislacionet

⁴⁵ Peter Gillies & Gabriël Moens; INTERNATIONAL TRADE AND BUSINESS: LAW, POLICY AND ETHICS Cavendish Publishing (Australia) Pty Limited Sydney • London 1998, fq. 729

⁴⁶ Po aty

⁴⁷ Për më shumë shiko në <http://www.uncitral.org/>

⁴⁸ Po aty në pjesën e publikimeve dhe historisë së uncitral – it.

specifike dhe konventave ndërkombëtare të cilat nuk pranojnë modifikimin e rregullave të veta, Ligji – model u propozon shteteve që zgjedhjet e veta nga kjo lëmi t'i rishikojnë dhe t'i harmonizojnë në bazë të Ligjeve – model. Në këtë mënyrë secili shtet është i lirë që për nevoja të procesit të integritetit të harmonizojë legjislacionin nacional në bazë të Ligjeve – model që konsiderohet mjaft fleksibile. Duke i pasura parasysh zgjedhjet që ofrojnë Ligjet – modele, disa nga shtetet kanë vendosur që të ecin më tutje në drejtim të liberalizimit të rregullativës ligjore për sferën e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare. Ligjet – model janë pranuar nga numri më i madh i sistemeve juridike dhe sot mbi 20 shtete kanë nxjerrë ligjin mbi arbitrazhin të cilat, kush më pak e kush me shumë, janë bazuar pikërisht në këto modele.⁴⁹ Duhet potencuar se këtyre ju kanë bashkuar tetë shtete të SHBA – ve dhe të gjitha provincat në territorin e Kanadës.

Ligji nacional si burim juridik

Burim i rëndësishëm dhe i veçantë juridik për funksionin dhe kompetencën e arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare natyrisht që është ligji nacional. Rëndësia e tij është rritur në njëzet vitet e fundit për shkak sigurisë, efikasitetit dhe profesionalizmit që ka treguar në zgjidhjen e kontesteve eventuale që kanë dal nga zhvillimi i operacioneve të tregtisë ndërkombëtare.

Shkaqet për nxjerrjen e ligjeve të veçanta nacionale për arbitrazhin janë të shumëfishta. Në radhë të parë janë ato të cilat rrjedhin nga operacionet intensive të cilat janë karakteristike për biznesin ndërkombëtar. Arbitrazhi është bërë mënyra me e zakonshme për zgjidhjen e kontestimit eventuale dhe edhe ato shtete të cilat kanë “papajtueshmëri”⁵⁰ me konceptet dhe zgjedhjet e saja çdo ditë janë duke ju nënshtruar një regjimi shumë më të rreptë dhe kërkesave të tregtisë ndërkombëtare që të ndryshojnë qëndrimin në këtë fushë.⁵¹ Në këtë kuadër, Ligji Modeli i Arbitrazhit mbi Tregtinë Ndërkombëtare është provuar të jetë baza më e rëndësishme për modernizimin e rregullave të arbitrazhit të tregtisë ndërkombëtare. Natyrisht kjo nënkupton nevojën që ligjet nacionale në këtë fushë të harmonizohen me te.

Konstituimi i kompetencës së arbitrazhit – kontrata mbi arbitrazhin

⁴⁹Sipas Peter Gillies & Gabriël Moens; INTERNATIONAL TRADE AND BUSINESS: LAW, POLICY AND ETHICS Cavendish Publishing (Australia) Pty Limited Sydney • London 1998 Australia, Ishujt e Bermudeve, Kanadaja, Qiproja, Egjipti, Holanda, Hong Kongu, Meksika, Gjermania, Nigeria, Peru, Singapori, Zvicrra, Tunisi, Ukrainia etj kanë rregulluar çështjen e arbitrazhit në bazë të Ligjit – model –UNCITRAL. .

⁵⁰ P.sh. Rasti i Spanjës

⁵¹ P.sh. Mbretëria e Bashkuar

Juridiksionin ose kompetenca e arbitrazhit është e bazuar në marrëveshje të palëve kontraktues të cilat paraprakisht janë pajtuar që kontestin evidentuar për zgjidhja t'ia besojnë arbitrazhit. Andaj një kontratë e vlefshme për të siguruar kompetencë arbitrazhit është baza e krijimit të juridiksionit dhe në të njëjtën kohë përjashtim (*off*) të një gjykata kompetente shtetërore. Marrëveshja për arbitrazhin shfaqet në dy forma:

- a) E para ka të bëjë me kontraktimin paraprak të kompetencës së saj dhe
- b) E dyta kur palët në një kontest eventual pajtohen ose arrijnë kompromis që ta çështjen ta dërgojnë në një gjykatë arbitrazhi.

Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit

Problematika e njohjes dhe e ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit pasqyrohet mbi faktin se a munden ato drejtpërdrejtë të detyrojnë organet shtetërore që t'i ekzekutojnë ato pa përjashtim. Kjo nënkupton se nëse pala e humb kontestin dhe nuk pranon që vullnetarisht t'i përmbush detyrimet nga vendim i arbitrazhit, atëherë të jetë e mundur që ai të ekzekutohet – realizohet vetëm përmes gjykatave kombëtare.

Baza juridike e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit buron pikërisht nga autonomia e vullnetit të palëve dhe parimi i konsensualitetit për të ju shmangur juridiksionin të gjykatave të rregullta nacionale dhe kontraktimi i kompetencës së gjykatës së arbitrazhit. Në mënyrë që të shmangen situata të tilla dhe për të lehtësuar njohjen dhe ekzekutimin vendimeve të arbitrazhit, konventat ndërkombëtare (më e rëndësishme në këtë aspekt është Konventa New York) dhe Ligji modeli në mënyrë uniforme ju ofrojnë mundësi dhe detyrë secilit shtet që në kushtet caktuara të për afrojnë, aprovojnë dhe ekzekutojnë Ligjin për arbitrazhin në tregtinë ndërkombëtare me të cilën do të sigurojë njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve arbitrazhit. Kjo do të siguronte që vendimi i arbitrazhit, pa marrë parasysh në të cilën territor është marra do të njihet si i detyrueshëm për ekzekutim nga gjykata kompetente në vendin e huaj.

Përfundimet

Procesi i integritimeve shoqërore – ekonomike për vendet të cilat pretendojnë të jenë faktorë të rëndësishëm mbi bazën e funksionit të shtetit ligjor nuk po tregohet i lehtë dhe i thjeshtë. Kjo pikërisht për shkak të kostos jo të lehtë dhe të lartë integrative. Para qeverive dhe institucioneve të caktuara kërkohen angazhime në shumë dimensione për të kanalizuar dhe adresuar veprimtaritë komplekse integruese. Ndër me të rëndësishmet

vlerësohen të jenë edhe ato që kanë të bëjnë harmonizimin e legjislacionit vendor me legjislacionin komunitar që detyrimisht e lehtësojnë ose e rregullojnë tregtinë ndërkombëtare. Zhvillimi i operacioneve të tregtisë ndërkombëtare ka filluar të jetë më i sigurt dhe me dinamik në ato vende ku legjislacioni nacional është harmonizuar me legjislacionin komunitar nëse ai ka arritur që të aprovojë dhe të zbatojë parimet e Ligjit Model për arbitrazhin në tregtinë ndërkombëtare i njohur si Karta e New Yorkut. Qeveritë e përgjegjshme të cilat thellësisht i kuptojnë dhe i zbatojnë parimet e tregtisë së lirë, ecin në drejtim të kufizimit të sovranitetit politik dhe ekonomik në dobi të zbatimit të drejtpërdrejtë të vendimeve të arbitrazhit duke i ekzekutuar pa përjashtim ato. Arsye e një qasje të këtillë qëndron në efektet që ka krijuar e drejta kontraktore, parimet e autonomisë së vullnetit të palëve dhe parimi konsensualitetit për rregullimin e punëve nga sfera e tregtisë ndërkombëtare. Është vërtetuar se është e paevitueshme që vendet të cilat ende nuk e kanë përgatitur bazën legjislative në lëmin e arbitrazhit në tregtinë ndërkombëtare, me urgjencë të angazhohen që ta nxjerrin këtë ligj konform me Ligjin Model për Arbitrazhin e tregtisë ndërkombëtare. Aprovimi dhe zbatimi i këtij ligji do të ndikojnë në dinamizimin e proceseve integrative, në fuqizimin dhe në rritjen e investimeve të huaja të, funksionimin e shtetit ligjor faktorë këto që rrjedhimisht do të ndikojnë në rritjen e vendeve të punës në shumë sektorë ekonomikë.

Literatura e shfrytëzuar ose e konsultuar

1. Gautron Claude J., E drejta evropiane, Shkup 2006
2. Jarroson CH., La notion d'arbitrage, Paris 1987
3. Ndreca M., Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Prishtinë 1986
4. Mire Le Pierre., E drejta e Unionit Evropian dhe politikat e përbashkëta, Shkup 2006
5. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe;
6. Peter Gillies & Gabriël Moens; INTERNATIONAL TRADE AND BUSINESS: LAW, POLICY AND ETHICS Cavendish Publishing (Australia) Pty Limited Sydney • London 1998,
7. Pravni Leksikon., Savremena Administracija, Beograd 1964
8. Pak M., Priznanje I izvršenje sudskih arbitražnih odluka, Zbornik postdiplomskih specijalističkih studija na Pravnom Fakultetu u Beogradu, me thirrje Ugovorni u međunarodnoj trgovini I, Beograd, 1987

TURIZMI BALNEAR DHE TIPOLOGJIA E PRODHIMIT TURISTIK

*Mr. sc. Bedri Millaku
bedri_millaku@hotmail.com*

Abstrakt

Turizmi Balnear paraqet segment dhe rrafsh tërheqës interesant, i pa hulumtuar në sferën e shkencës së turizmit në vendin tonë. Deri më tani është hulumtuar në formë fragmentare dhe parciale nga ana e shkencës balnearoterapeutike, më shumë në punimet e autorëve të degëve shëndetësore, por jo edhe komplekse sipas parimeve të Federatës Ndërkombëtare për staxhionim termal. Vlera e kapitalit investues në banja pikësëpari, ka rëndësi të madhe në përfshirjen e të gjitha segmenteve të ofertës turistike konform tregut dhe shfrytëzimit ekonomik të kapaciteteve, në mënyrë që oferta të përgjigjë nivelin të planifikimit ekonomik në shkallë rajonale edhe më gjerë.

Fjalët çelës; Turizmi Balnear, Ujërat termale, Mjekësia fizikale, Rekreacioni, Prodhimi turistik, Funksionet rekreative dhe shëruese.

Hyrje

Principet modern të Federatës ndërkombëtare të trajtimit të termalizmit në turizëm, kanë aktualizuar konceptin e dinamikës së ruajtjes së shëndetit edhe rolin e termalizmit në angazhimin e shoqërisë moderne në mbrojtjen e shëndetit të popullsisë. Shoqëria njihë përdorimin e trajtimit termal në kuadër të mjekësisë dhe ajo me mjete të veta merr pjesë në intervenime të ndryshme. Kështu, prodhimi termal paraqet edhe një formë të investimeve të mjeteve publike në shëndetësi, kështu që ajo krijon edhe politikën ekonomike dhe aksionet ekonomike dhe aksionet për këto transaksione. Trajtimi i efekteve terapeutike nënkupton metodat mediko-fiziologjike dhe ato socio-ekonomike. Federacioni i aktiviteteve termale i përgjigjet nocionit të prodhimit termal, përbërjen praktike, klasifikimin dhe vlerësimin ekonomik, duke paraqitur të gjitha këto në statistikë me fillim të mjekimit vendosjes, ushqimit argëtimit dhe rekreacionit fizik të klientelës turistike.

Turizmi termal paraqet faktor me rëndësi të veçantë në shërimin e sëmundjeve të ndryshme. Lokalitetet balneare kryejnë funksionin rekreativ

dhe shërues. Funkcioni shërues është lëmi e cila i përket hulumtimeve mjekësore, kurse qarkullimet turistike vlerat atraktive të ambienteve të banjave, paraqesin fushën e hulumtimeve turistike. Në Kosovë turizmi balnear paraqet vërtetë të gjerë të pasurisë turistike dhe në sferën e ofertës turistike, si dhe vetive të prodhimit turistik. Rajoni i viseve të banjave dhe ujërave termominerale të Kosovës ofron kushte mjaftë të mira për funksionet turistike. Qarkullimet turistike në drejtim të këtyre rajoneve do të kenë karakteristikat e qarkullimeve turistike balneare. Në këtë lloj turizmi duhet të llogaritet pjesëmarrja në pushime vjetore në suaza të popullsisë së vendit, duke e llogaritur pjesëmarrjen e kategorive të caktuara sociale ekonomike të popullsisë së vendit. Në politikën e zhvillimit të turizmit për një rajon për një periudhë të mesme ose afatgjatë, aktualisht nuk mund të parashikohet ndonjë ndryshim radikal në turizmin stacionar balnear edhe për arsye se mundësitë e aftësimit turistik të zonës turistike, me ndryshimin e peizazhit kulturor të një mjedisi (rritja e madhe e sipërfaqeve, me ujërat e tyre rrjedhëse, zonat malore për aftësimin e zhvillimit të turizmit rekreativ, sportiv dhe të gjuetisë, sikurse zhvillimi i sporteve ujore, rritja e sipërfaqeve të tokës bujqësore, e pemishteve dhe blegtorisë, etj.) hapen shtigjet për themelimin dhe zgjerimin e mundësive të ofertës komplekse turistike të zonave balneare.

Stacionet termale që nga kohërat e lashta ofrojnë ilaçe nga brendia e tokës, por edhe të klimës për shërimin e shumë sëmundjeve. Sidomos aktualisht shërojnë sëmundjet e ndryshme të civilizimit që lindin edhe nga prishja e baraspeshës ekologjike. Parimet moderne të mjekimit në stacionet termale dhe realizimi i një prevence, shërimi dhe rehabilitimi i takon mjekësisë klinike dhe farmakologjike, por krahas kësaj arrihen në këto stacione rezultatet fantastike. Qëllimet kryesore të aktivitetit termal cilësohen me veprime të shumta si, rivendosja e gjendjes fizike, falë instalimeve për çlodhje (p.sh. zonave pushimore), për pjesën aktive të mjekimit, (instalime të ndryshme për ushtrime gjimnastikore, sporte dhe lojëra, pishinë të hapur apo të mbyllur, shtigjet për shëtitje etj), qendra të ndryshme për rekreacion dhe çlodhje e përsosje të (bibliotekave, salla të leximit, salla të pushimit-ndejave) dhe organizimet tjera si programe kulturore e shoqërore, paraqet qëllimet kryesore të aktiviteteve termale. Vlerat e shpenzimeve për investime të instalimeve dhe rëndësia e kapitalit për renovime dhe zhvillimeve të instalimeve, konform tregut duhet të jetë pjesë e nivelit të planifikimit ekonomik në shkallë rajonale.

Masë tjetër është planifikimi i stacioneve termale si dhe themelimi terapeutik në kuptimin e “shfrytëzimit ekonomik”, bashkë me mundësitë e caktuara me parë të zhvillimit të bazës së ofertës së përgjithshme turistike të rajonit.

Sipas karakterit të mjedisit natyror, ku tregohet një zhvillim turistik, lokalitetet i ndajmë në:

1. Lokalitetet balneare.
2. Lokalitete turistike te brigjeve të liqeneve.
3. Lokalitete bregdetare turistike.
4. Lokalitet malore turistike.

Ndërsa lokalitete dhe rajonet turistike të cilat disponojnë me cilësi rekreative ne përgjithësi ndahen në dy grupe kryesore:

1. Lokalitete për rekreacion dhe prevencë.
2. Lokalitete për kurim (shërim)

Tiparet themelore të funksionit turistik në lokalitete balneare

Banjat janë lokalitete më të vjetra turistike. Që nga kohërat me të lashta banjat paraqesin motive për qarkullime turistike për vizitorët, duke u bazuar në pasurinë e këtyre lokaliteteve me burime të ujërave termominerale. Banjat zakonisht janë të zhvilluara si qendra ne të cilat dominon funksioni turistik. Një pikëpamje tjetër e rëndësishme ne historinë e turizmit ishte edhe zhvillimi i vonshëm vendeve burimore, mbas përdorimit të tyre nga Romaket. Ky zhvillim ndodhi ne Britani dhe ne tërë kontinentin. Ne shekullin e XVIII vendet burimore u bënë vende të rëndësishme për shoqërinë e lartë. Ato përmbanin jo vetëm aspektin mjekues por gjithashtu edhe ngjarje shoqërore siç janë lojërat, vallëzimi, dhe bixhozi. Beau Nash i mirëpret mysafirët në Banjë të Anglisë e cila kishte ndikimin pozitiv në shëndet dhe burime të shoqërisë.

Banja detare gjithashtu u be e famshme, dhe disa besonin se uji i kriposur është me i dobishëm se sa ujërat e brendshme burimore. Ndër të njohurit në Britani ishin format SPA, si Brighton, Valter Rasmagatë, Vorthing, Hastings, Veymouth, Blackpool, dhe Scarborough. Aty rreth vitit 1861 këto vendbanime bregdetare të suksesshme dëshmuuan se ekzistonte një kërkesë e mbyllur për leje të udhëtimit. Shumica e vizitorëve nuk i kanë kaluar netët në atë vende por vetëm kanë bërë ekskursionë një ditore në bregdet. Klientët e hoteleve ishin të limituar për ata me konsideratë të lartë .

Për këtë arsye, turizmi i ka borxh praktikantëve mjekësor të cilët e bënë mbledhjen e mostrave mjekësore të ujit mineral. Ata i dërgonin pacientët e tyre në ato vende ku ekzistonin ujërat minerale të cilat ishin të mira për shëndet.

Profesioni mjekësorë gjithashtu rekomandoi banjën detare për shkak të vlerave të saj terapeutike. Duke pasur në konsideratë qëndrimet aktuale te shoqërisë, kjo siguroi justifikim për t'u angazhuar në këto aktivitete. Përderisa vendet burimore dhe strehimet bregdetare së pari u vizituan për arsye të shëndetit, ato së shpejti u bënë edhe qendra argëtimi, rekreacioni,

bixhozi i cili i nxiste të pasurit me ose pa ndonjë sëmundje. Kjo erë apo epokë e turizmit ilustron se ky ishte një kombinim i më shumë se një elementi që e thekson suksesin ose dështimin e një ndërmarrje. Sot gjejmë burimet termale, ndoshta këto burime termale nuk mund të listohen në listat prioritare të turistëve por prapë se prapë janë atraktive për tërheqjen e turistëve. Shembuj në SHBA janë Hot Springs (burimet e nxehta), Arkansas, French Lick, Indiana, dhe Gleneood, Springs, Kolorado. Deti, në veçanti në viset tropikale vazhdon të ketë një tërheqje të fuqishme dhe është njëra ndër forcat prijëse në zhvillimin e turizmit siç është dëshmuar nga Havai, Florida dhe Meksika. Shikuar nga e kaluara historike, lokalitetet balneare në Evropën perëndimore dhe në vendet tjera, ishin vende të takimeve të ndryshme (rekreative, kulturore, tregtare) të përfaqësuesve të klasave aristokrate dhe moderne, kështu që banjat kanë qenë pionier të zhvillimit turistik të hapësirave gjeografike, ku kanë ekzistua kushtet natyrore. Zhvillimi dhe ndërtimi i tyre ka krijuar kushte për ndërtimin e lokaliteteve të urbanizuara me fizionomi mjaft atraktive, në të cilat turizmi dhe shërimi i sëmundjeve të ndryshme janë në funksion kryesor të tyre. Orientimi i tyre në qëndrimin turistik preventiv dhe kurativ, ka pasur për bazë kërkesat e ndërtimit të kapaciteteve të caktuara balneare, qoftë në objekte të vendosjes qoftë në qytete, në radhë të parë për shërbime mjekësore dhe shërimin e vizitorëve. Fazat e hershme zhvillimore veçoheshin me mundësitë për pagesat e larta për shërbimet turistike dhe termalizëm, ka bërë ndikim që lokalitet balneare të formohen si lokalitete me ofertën specifike turistike preventive, kurative dhe rekreative. Fizionominë e lokaliteteve balneare nga aspekti arkitektonik edhe sot e ruajnë disa nga banjat e dikurshme. Element dallues të arkitekturës ambientale të banjave dhe të fasadave të tyre, me lule dhe bimë të rralla dhe me parqe të rregulluara, me komplekset pyjore dhe shtigjet për shëtitje, ashtu me objekte e ndryshme hoteliere: Kafene, bufe, pastiqeri, etj.

Pjesa dërmuese e banjave, varësisht nga numri i banoreve kanë në disponim hapësira të mëdha të objekteve për tregti (shit-blerje), me butiqe ku shitet malli luksoz, ekskluziv dhe suveniret. Në vendet evropiane lokalitetet balneare bashkë me banjat lokale, paraqesin mjedise tipike urbane dhe ambientale kryesisht me disa kapacitete hoteliere të kategorive të larta dhe me pansione, me vila për vendosje private, etj. Zhvillimi i turizmit në përgjithësi për vendet balneare ka dhënë efektet negative sepse vendet balneare kanë humbur rëndësinë e funksionit turistik të cilin e kishin për klientët me pagesa të larta duke mbajtur ekskluzivisht fuqinë e tyre kurative. Banjat si në vendet e ndryshme të botës ashtu edhe tek ne kanë parë të arsyeshme të krijojnë ndërlidhje bashkëpunimi me institucionet e ndryshme mjekësore, dhe në bazë të marrëveshjeve që bëhen mes tyre, plotësohen nevojat e klientelës në shërim. Tek banjat është me rëndësi se shumë prej

tyre bashkëpunojnë me institucionet mjekësore dhe sociale, të cilat kompletojnë shërbimet për shërim. Banjat me shumë vizitohen nga pjesëtarët e gjeneratave të vjetra, pra të cilët janë me të moshuar, të cilët veçohen më kërkesat e tyre turistike si turist. Veçori e banjave është se ato janë të ndërlidhura me funksionin kurativ dhe preventiv. Në mbikëqyrje të përkujdesjes mjekësore, banjat bartin vetitë e lokaliteteve turistike në të cilat vizitorët qëndrojnë me gjatë. Në anën tjetër edhe pse për banja vërehet një zvogëlim i kërkesave për to, në njërin anë, e në anën tjetër ekziston shkalla shumë e lartë e shfrytëzimit të kapaciteteve. Prej funksioneve me të rëndësishme në lokalitetet balneare është funksioni mjekësor i cili manifestohet me kohë me të gjatë të shfrytëzimit gjatë tërë vitit, i cili është mjaftë rentabil për ekonominë dhe afarizmin e organizatave të drejtpërdrejta ekonomike turistike. Po ashtu, për banja është karakteristike konsumi ditor i vizitorit të banjës, i cili është i ulët, kështu konsumi turistik më tepër shfrytëzohet për shërbimet jashtë pansionale të cilat janë shumë të ndryshme sipas strukturës së përhershme dhe të orientuara në prodhimet dhe shërbimet e cilësive me të larta. Kohëve të fundit me rritjen e rëndësisë së turizmit në hapësirat kontinentale, banjat marrin vlera të reja atraktive turistike. Kjo hapë rrugën që në lokalitete të shumta balneare të ndërtohen objektet të ndryshme rekreative për plotësimin e ofertës turistike. Në këtë mënyrë struktura e ambientit të mjedisit pasurohet me pishina të hapura ose të mbyllura në të cilat gjendet uji i ngrohët i banjave me cilësi bakteriologjike-terapeutike, mandej kapacitete të ndryshme përcjellëse të sporteve të vogla (minigolf, tenis, volejboll, basketboll), sikurse edhe me objekte hoteliere të dedikuara vizitorëve të gjeneratave të reja diskoklube, salla të ndryshme të zbavitjes, shtigje për shëtitje, etj. Në disa banja, falë pozitës së përshtatshme gjeografike ndaj zonave urbane emetive dhe me lidhje të mira të transportit, janë krijuar kushtet për piknikë të klientelës urbane. Banjat çdo ditë plotësohen me infrastrukturën e duhur e cila shkon në favor të klientelës turistike. Kështu rritet edhe numri i vizitorëve dhe motivet për tu vizituar banjat, në këtë mënyrë edhe oferta turistike pasurohet e cila u përgjigjet kërkesave adekuate dhe specifike. Në të vërtetë vendet termale dhe klimatike përbëjnë bashkësinë e aksioneve e cila ndahet në katër kategori:

1. Mjekësore (konsultime ose trajtime), të cilat ushtrohen në laboratorë, mjete teknike, me sistem të kontrollimeve, me gjimnastikë, fizioterapi, me farmakologji etj.
2. Hoteliere (vendosje, hospitalizim në objekte të sanatoriumeve ose të stacioneve) gjatë qëndrimit në banja;
3. Gastronomike, me përgatitjen e ushqimit dhe pijeve;
4. Kulturore, me përgatitjen e jetës zbavitëse dhe kulturore gjatë qëndrimit në banja (kinema, teatro, balet, manifestime të

ndryshme folklorike dhe të tjera kulturore, si dhe informatat). Duke e parë rëndësinë e madhe të termalizmit në shumë vende të botës ekzistojnë aktet e ndryshme ligjore me të cilat përcaktohen kompetencat e një stacioni termal.

Prodhimi turistik i termalizmit

Turizmi termal parqet vlera te larta duke u cilësuar me një numër aktivitete të ndërlidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Turizmi termal paraqet kompleks aktivitete të cilat kanë rëndësi në efektin ekonomik të rrethës së banjës. Aktivitetet termale janë në dispozicion për mysafiret të cilët shërohen në stacionin termal. Nga aktiviteti termal janë të lidhura të ardhurat e të punësuarve në mënyrë të drejtpërdrejtë. Stacionet termale sot janë të lidhura me bukurinë e të ardhurave nga vetëfinancimi. Tani për momentin janë ndërmarrje të privatizuara dhe në procesin e privatizimit. Kohët e fundit kanë filluar të ndërtohen edhe ndërmarrjet private Qendra për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim siç është rasti me Banjën e Re të Klokotit në Klokot të Vitisë i cili është rast i vetëm. Rëndësia e prodhimit turistik është mjaft e madhe sepse një pjesë e familjeve jetojnë drejtpërdrejt nga termalizmi. Ato në mënyrë të ndryshme direkte apo indirekte e vënë në funksion aktivitetin e tyre për prodhimin e të mirave materiale dhe shërbimeve për mysafiret të cilët shërohen. Çdo herë duhet pasqyruar edhe shpenzimet e konsumit me aktivitetet plotësuese duke përfshirë furnizimin me të mira dhe shërbime për familjet që jetojnë drejtpërdrejt nga termalizmi. Këtu përfshihen edhe familjet të cilat jetojnë në mënyrë plotësuese nga turizmi duke përfshirë punën për prodhimin e të mirave materiale dhe shërbimeve plotësuese sepse një pjesë e madhe e të mirave të cilat prodhohen nga bujqësia gjen vend të konsumohen në turizëm. Shumë produkte vendore konsumohen nga mysafiret të cilët vizitojnë banjat. Këtu qëndron arsye se turizmi në përgjithësi ka efekt të rëndësishëm ekonomik për zhvillimin e gjithëmbarshtëm. Në aktivitetet plotësuese përfshihen edhe të ardhurat e të punësuarve në mënyrë indirekte (tërthortë) në turizëm. Termalizmi parqet vlerat e larta në konsumin turistik e cili është i lidhur në mënyrë zingjyrore me efektin ekonomik për veprimtaritë të cilat kanë të bëjnë me aktivitetin e termal në përgjithësi. Banjat janë ndërmarrje ekonomike profitabile, për ekonominë e vendit.

Përfundimi

Turizmi Balnear dhe tipologjia e prodhimit turistik janë të një rëndësie të madhe për zhvillimin e vendit. Meqenëse vendi ynë disponon me mbi 55 burime të termominerale. Kjo paraqet një bërë të rëndësishme që këto

potenciale ne disponim te shfrytëzohen sipas kriterëve dhe standardeve ndërkombëtare. Mu këtu qëndron arsye e trajtimit të tipologjisë së prodhimit turistik në shfrytëzimin e ujërave termominerale. Turizmi termal paraqet vlera të larta duke u cilësuar me një numër aktivitete të ndërlidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Turizmi termal paraqet kompleks aktivitete të cilat kanë rendësi në efektin ekonomik të rrethinës së banjës. Aktivitetet termale janë në disponim për mysafiret të cilët shërohen në stacionin termale. Nga aktiviteti termal janë të lidhura të ardhurat e të punësuarve në mënyrë të drejtpërdrejt. Stacionet tona termale sot janë të lidhura me burimin e të ardhurave nga vetëfinancimi. Tani për momentin janë ndërmarrje të privatizuara dhe në procesin e privatizimit. Qëllimi është që këto vlera të larta natyrore të futen në funksion të ofertës turistike. Në mënyrë që qendrat termale mos të shfrytëzohen vetëm për terapeutik, por të jenë në funksion edhe të zhvillimit të turizmit. Këtu qëndron efekti sepse turizmi balnear sipas tipologjisë veçohet nga llojet tjera të turizmit të cilat janë të karakterit sezonale. Tek turizmi balnear është jo sezonal, që nënkuptohet se funksionon 365 ditë të vitit. Mu këtu qëndron arsye se shfrytëzimi i mirfillt i ofertës turistike në këtë fushë të turizmit për vendin janë të leverdishme. Në mënyrë që efekti ekonomik do të jetë mjaft profitabil.

Literatura

1. J. Dumazdier:, “Vers une civilistaion de loisir”, Paris,1972.
2. M .Gashi : “Bazat e Turizmit”Universiteti i Kosovës, Prishtinë, 1986
3. M. Gashi,Bazat e turizmit – Turizëm dhe Hotelieri për shkolla të mesme, Prishtinë, 1987.
- 4 . M. Gashi “Vlerat turistike në Kosovë” Plani regional hapësinor i KSAK Prishtinë 1969.
- 5 .M. Gashi : “Uslovi i mogénosti za razvoj turizma SAP Kosovu, Prishtinë 1977.
6. M. Gashi : “Turizmi si fenomen shoqëror bashkohes”, Časopis “Përparimi”,br.5.Prishtinë 1963. god.
7. M. Gashi : “Osnovni potencial turističkih vrednosti Kosova”,ekspertiza izrađena za potrebe i rade regionalnog prostornog plana Kosova, Priština 1969.
8. A. Todorovic:”Metodologija istraživanja slobodnog vremena “Savremena administracija, Beograd 1978.
9. D. Popov:”Putničke agencije”Turistička štampa”, Beograd 1979.
10. Ž. Jovičić:”Osnovi turizma” Naučna knjiga, Beograd 1976.
11. Ž. Jovičić “Turistička Kretanja” Naučna Knjiga, Beograd1966.
12. A. Pushka: Metodotat kuantitative në Gjeografi, Prishtinë 1981.

13. M. Boyer: "Le tourisme", Paris 1970.
14. Tourism and post-disciplinary enquiry. *Current Issues in Tourism*, 9(5), 293–319.
15. Hall, C. M., Timothy, D. J., & Duval, D. T. (Eds.). (2003). *Safety and security in tourism: Relationships, management, and marketing*. New York: Haworth Hospitality Press.
16. Faulkner, B., & Russell, R. (2000). Turbulence, chaos and complexity in tourism systems: A research direction for the new millennium. In B. Faulkner, G. Moscardo and E. Laws, (Eds.), *Tourism in the 21st century: Lessons from experience* (pp. 328–349). London: The socio – Economic
17. E-International Scientific Research Journal
18. World Tourism Organisation (UNWTO) Statistics Department.
19. World Travel and Tourism Council (2004), *Annual Report: Progress & Priorities 2004/05*.
20. Tooman, L.A. (1997), "Tourism and Development," *Journal of Travel Research*, Vol. 35, No. 4, 33-4
21. Rudolf Bičanić: "Tipologija tržišta", informator, Zagreb, 1968.
22. S. i Z. Marković: "Ekonomika turizma", Zagreb, 1967.

KUD 339 162.3/.4
RREGULLAT MATERIALE TE SHITBLERJES

Bekë Kuqi
beka.kuqi@hotmail.com

Abstrakt

Rregullimi material i shitblerjes është rregullim i rregulluar me akte nderkombetare dhe me kushtetuten e vendit si dhe me ligjet perkatese te hartuar ne perputhshmeri me kushtetuten. Shitberja perpos akteve te shkruar jemi edhe rregullativ morale etike te sjelljes ne mes shitesit dhe blerjes. Keto perpos qe rregullohen me kontrat ajo kerkohet nga palet edhe te respektohet dhe te zbatohen ne praktik. Shitblerja vazhdon deri sa konsumatorët e kerkojne dhe e deshirojn mallin e caktuar.

Fjalët kyçe: rregullat materiale, shitblerja, kontrata

Hyrja

Rregullat material të shitblerjes janë rregulla të cilat edhe janë të shkruara dhe po ashtu të konbinuara më praktika të mira ndërkombetare dhe vendore. Rregullat juridike dhe ekonomike te shitblerjes janë të rregulluara më Konventa Ndërkombetare, si dhe në vendin tonë më Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe më ligjet përkatëse duke filluar nga Ligji për mbrojtjen e Konsumatorëve, rregullat e shitblerjes, statutet e institucionëve që merren me prodhimin, shitjen, blerjen e mallrave të ndryshme.

Si rregulla të kriterit të përgjithshëm është struktura e konventës, kun në përmbajtje do shtjellojmë raportin dhe rëndësin e shitblerjes.

Po ashtu tek rregullat e shitblerjes të rëndësishme janë edhe parimet e pranimit dhe dërgimit, cenimi esencial i kontratës, lajmërimi për shkputje, kërkesa për përmbushje, detyrimet e shitësit, obligimi i dërgimit të mallit, Obligimi i dërgimit të mallit pa të meta material, konformiteti kontraktues, rregullat plotësuese për konstatimin e konformitetit, të drejtat e blerësit në rast të cënimit të kontratës nga ana e shitësit, e drejta e kërkesës për përmbushje, e drejta e kërkesës për zvoglimin e qmimit, e drejta e shkëputjes së kontratës, e drejta e shpërblimit të dëmit.

Ajo qka është më e rëndësishme në këtë punim që do zgjerohemi më tepër është për detyrimet e blerësit dhe shitësit si dhe të drejtët e tyre të cilat janë të mbrojtura nga ligji.

Në fund do i ofrojmë përfundimet të cilat do kenë edhe rolin e rekomandimeve dhe konkluzionëve për institucionet përkatëse, që merren më mbrojtjen e shitësve dhe blerësve për vendin tonë.

RREGULLAT MATERIALE TË SHITBLERJES

Në ekonomin e tregut dhe lirin e qarkullimit të mallrave si mbrenda dhe jashtë shtetit janë mjaftë të rëndësishme për vendit dhe përmes kësaj e shofim edhe lëvizjen ekonomike të vendit. Nuk mund të kemi një ekonomi stabile dhe serioze në vend për derisa nuk kemi një infrastruktur të mirë ligjore dhe një treg të lirë.

Treg i lirë konsiderohet atëherë kur blersit dhe shitësit të drejtat e tyre të jenë të mbrojtur nga ana e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe ligjëve përkatëse, dhe ato jo vetëm që të jenë të mbrojtura por edhe të krijojnë mekanizma praktikë të mbrojtjes. Mekanizma praktikë mendojmë se duhet të jenë që personat përgjegjes të jenë sa më afër shitësve dhe blersve të mallrave të ndryshme.

E rëndësishme për shitësit është se shteti duhet t'iu krijojë hapsirë investuese, dhe lehtësira të hyrjes së mallrave por ato lehtësira, të jenë praktike, dhe përmes këtyre lehtësirave shtetit përfiton nga tatimet e qarkullimit dhe punsimit të një numri të madh të punëtorëve, dhe përmes kësaj të ndikojë pozitivisht në arkenë shtetore të vendit.

Shitësit duhet të kenë një rregull të përgjithshme të sjelljes ndaj blerësit dhe të ofroj mallra me kushte dhe kritere të mira, sepse nëse ofrohet një mallë jashtë standarteve të krijuarara ndërkombetare atëherë shitësi bënë një shkelje ligjore dhe etike të mallrave dhe kujdesin ndaj konsumatorëve (blerësve).

Tregu i lirë si dukuri tejet e rëndësishme shoqërore dhe përherë aktuale, mund të bëhet në mënyrë dhe në aspekte të ndryshme, varësisht nga qëllimi dhe interesi i caktuar. Kështu, tregu mund të shqyrtohet nga aspekti shoqëror – ekonomik, si dhe nga aspekti shoqëror – politik. Po ashtu, tregu i përhershëm mund të shqyrtohet edhe nga aspekti i funksionimit të tij në praktikë në tërësi ose në ndonjë segment të tij të veçantë, siq janë: qarkullimi i mallrave dhe i shërbimëve, afarizmi me botën e jashtme, sistemi kredito- monetary, sistemi doganor dhe ai devisor etj.⁵²

⁵² Hetemi, Mehdi, “ Funksionimi i tregut të lirë dhe mbrojtja e tij nga paraqitjet jolohale në qarkullimin e mallrave, Prishtinë, 1993, fq. 1-304.

Shikuar relacionin dhe mënyrën e organizimit, lirisht mund të themi se tregu është kategori kushtetuese- ligjore dhe institucionale, e që pa marrë parasysh sistemin politiko – shoqëror të vendit të caktuar, atij i kushtohet rëndësi e posaqme sin ë aspektin juridik të rregullimit, ashtu edhe në aspektin ekonomik dhe politik.⁵³ Të tri këto elemente duhet të koekzistojnë, të harmonizohen dhe të bashkëveprojnë, gjë që në praktikë nuk është edhe aq lehtë të sinkronizohen, materializohen pa kundërthënie dhe vështërsi.

Rregullat e karakterit të përgjithshëm

Strukturën e Konventës siq e kemi cekur në pjesën e tretë të Konventës e përbëjnë rregullat me të cilat është rregulluar shitblerja ndërkombetare e mallrave, d.m.th. rregullat me të cilat janë të rregulluara detyrimet e shitësit dhe blerësit.⁵⁴ Para këtyre janë veqar disa rregulla të karakterit të përgjithshëm.⁵⁵ Këto janë:

1. Rregullat për mënyrën në të cilën deklarohet vullneti dhe rregulla për konvalidimin e kontratës mbi shitblerjen.
2. Koncepti i cenimit esencial të kontratës.
3. Rregulla lidhur me atë se kur mund të kërkohet përmbushja e kontratës.⁵⁶

Parimi i pranimiit dhe dërgimit

Konventa përmban rregullën sipas të cilës deklarimi i vullnetit duhet të arrijë te përoni të cilitr i është drejtuar.⁵⁷ Teoria e pranimiit është aplikuar në pjesën e dytë të Konventës⁵⁸ e cila përcakton rregullën për lidhjen e kontratës. Kjo ka të bejë me ofertën, pranimin dhe deklaratat tjera të deklarimiit të vullnetit në procedurën e lidhjes së kontratës (siq janë tërheqja e ofertës, revokimi i ofertës, refuzimi i ofertës, përcaktimi i afatit për pranimin e ofertës, tërheqja e pranimiit).⁵⁹

⁵³ Po aty, fq. 5.

⁵⁴ Hetemi, Mehdi, “ E drejta Ndërkombetare Tregtare – Afariste”, Prishtinë, 2004, fq, 279.

⁵⁵ Po aty, fq, 279.

⁵⁶ Po aty, fq, 279.

⁵⁷ Po aty, fq. 279.

⁵⁸ Është e rëndësishme të bëhet dallimi në mes konventës bilateral dhe multilateral në këtë rastë. Konventat multilateral në vendin tonë janë të aplikueshme, këtë e ka parapa edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, por më herët edhe Korniza për vetqëverisjen lokale në Kosovë. Arsye pse është sepse konventat multilateral nënshkruhen nga dy tri apo më shumë shtete dhe janë të aplikueshme edhe për vendete e treat siq është Kosova. Ndërsa Konventat Bilaterale nënshkruhen vetëm në mes dy shtetëve dhe vlenë vetëm për ato shtete nënshkruese.

⁵⁹ Hetemi, Mehdi, “ E drejta Ndërkombetare Tregtare – Afariste”, Prishtinë, 2004, fq, 279.

Sipas konventës konsiderohet se lloji i cekur i deklaratës ka arritur të përsoset të cilëve u është dërguar, nëse u është kumtuar me gojë ose më ndonjë mënyrë tjetër u është dorëzuar personalisht ose iu është dorëzuar në selin e tyre, a në adresën postare, e nëse nuk ka seli, respektivisht adresë postare, atëherë në vendqënimin e tij të rregullt (neni 24 I Konventës).⁶⁰

Sajuesit e Konventës me gjithatë i nënshtrohet teorisë së dërgimit sipas të cilës deklarata është bërë, nëse ajo është dërguar. Teoria e dërgimit aplikohet drejtëpërdrejtë në pjesën e tretë e konventës e cila përmban rregullat material të shitjes.⁶¹

Teoria e dërgimit arsyetohet me faktin së marrëdhëniet në deklarim të shkaktuar me lëshim të adresatit që në mënyrë korrekte ta përmbush kontratën.

Cenimi esencial i kontratës

Njëra nga specificitetet e Konventës është si bazë për shkëputje të kontratës. Për të paraqitur cenimin esencial të kontratës është e nevojshme që të plotësohen dy kushte:

- Që cenimi i kontratës ia merr palës tjetër atë që ajo është e autorizuar të pret nga kontrata.
- Që pala e cila ka cenuar kontratën, si qdo person i kuptueshëm i llojit të njëjtë, në rrethana të njëjta ka pasur mundësi të parashih atë pasojë.

Siq e sqaronë shkenca është e nevojshme që të plotësohen dy kritere:

- Cënimi i asaj që është pritur e që ka të drejtë sipas kontratës (blerësi sipas kontratës e pret mallin, shitësi qmimin ose përmbushjen në afat) dhe
- Parashkrimi i pasojave të cenimit.⁶²

Sqarimi teorik është si vijonë: cenimi esencial i kontratës është orientuar në rëndësinë e interes të cilin kontrata dhe detyrimi i tij i mëvetësishëm krijojnë për kreditorin, e jo në dëmin i cili i shkaktohet më mospërmbushje. Është e njohur se kontrata nuk krijon vetëm detyrime për kontraktuesit, por edhe i përcakton se sa janë ato me rëndësi për kreditorin.⁶³

Lajmërimi për shkëputje (neni 26 I Konventës)

⁶⁰ Po aty, fq. 279.

⁶¹ Po aty, fq. 279.

⁶² Po aty, fq. 280.

⁶³ Po aty, fq. 280, 281.

Për t'u shkëputur kontrata është e nevojshme që të jepet deklarata për këtë. Lajmrimi sipas Konventës mund të plotësohet pa kurrfarë kërkesë bë aspektin e formës, përveq nëse kontrata apo doket afariste nuk parashohin diq tjetër.⁶⁴ Lajmrimi për shkëputje duhet t'i dërgohet palës tjetër.⁶⁵ Afati për lajmërimin për shkëputjen e kontratës është përcaktuar si afat i gjatësisë së kuptueshme.⁶⁶

Shkputja e kontratës në mes shitësit dhe blerësit për mallin e blerë duhet të ketë edhe arsye të shkputjes, por kontrata mund të shkëputet edhe pa arsye, sepse blerësi nuk e dëshiron më mallin apo komunikimin më blerësin.⁶⁷

Kërkesa për përmbushje

Sipas kontratës në rast të mospërmbushjes së kontratës kreditori ka të drejtë të zgjedhë në mes të dy mjeteve. Ai mund të kërkojë nga debitori që të përmbush detyrimin ose mund të kërkojë nga debitori që të përmbush detyrimin ose mund të kërkojë shpërblimin e dëmit për shkak të mospërmbushjes.

Detyrimet e shitësit

Detyrimet themelore të shitësit janë: që ta dërgojë mallin që konform me kushtet e kontratës t'i dorëzoj dokumentet dhe ta bartë pronën në mall.

Obligimi i dërgimit të mallit

Detyrimi i parë dhe esencial i shitësit sipas Konventës është detyrimi i shitësi që ta dërgojë (dorëzojë) mallin.⁶⁸ Vetë dërgesa do të thotë bërjen e blerësit pronar të sendit i cili është objekt i shitblerjes.

Vendi i dërgimit.- Vendi i përmbushjes së detyrimit është vendi i cili me kontratë konkrete e parashohin shitësi dhe blerësi. Nëse në kontratë nuk është paraparë, dallohet vendi i dërgimit të mallit nga kontrata për shitblerje

⁶⁴ Po aty, fq. 281.

⁶⁵ Po aty, fq. 281.

⁶⁶ Po aty, fq. 281.

⁶⁷ Të intervistuarin M. S, thotë se më nuk dëshiroj të blejë mallin tek Firma____, sepse komunikimi nuk është në nivelin e duhur, malli i blerë nuk i plotëson kushtet për konsumatorë, sepse ajo mallë përbërja e prodhimit dhe nuk është kalorik, këtë e thonë konsumatorët, sepse ka rënë dukshëm blerja. E verteta është sepse edhe cilësia e tretjes ruajtjes që kërkohet nuk e run afatin e kërkuar kështu se paku ndëgjojë prej konsumatorëve.

⁶⁸ Më për së afërmi shih: U. Huber, Komentimi i nenit 31, fq. 222-251; P, Schlechtreim, komentimi fq. 180-187.

e cila e përfshinë dhe transportin e mallit dhe kontratës mbi shitblerjen e cila nuk e përfshinë edhe transportin e mallit.

Obligimi i dërgimit të mallit pa të meta material

Është obligim i shitësit që ta dërgojë mallin pa të meta materiale. Rregullat e Konventës me të cilat është rregulluar obligimi i dërgimit të mallit pa të meta material janë të bazuara në konceptin unik të konformitetit. Sipas tij, dërgimi i mallit jokonform përfshinë dallimin jo vetëm në cilësi të mallit të dërguar, por edhe dallimet në sasinë e mallit të dërguar, dërgimi i mallit të llojit tjetër (aliud), të metat në ambalazh dhe paketim, etj.

Të drejtat dhe detyrimet e blerësit dhe shitësit

Të drejtat e shitësit në raport me të drejtat e blerësit në aspektin ligjor janë të barabarta përpos që shitësi ka obligime shtesë, duke llogaritur që nga respektimi i blerësit komunikimi dhe ofrimi i kushteve të tregut, ndërsa blerësi duhet të sillet në raport me qmimin që e ofron shitësi nëse nuk i tejkalon qmimin e përcaktuar nga shteti dhe standartet e kërkuar në qmimin real të tregut.

Detyrimet janë ato të cilat përcaktohen me kriteret e parapara në kontratën që kanë lidhur për kushtet e kontratës dhe kriteret që duhet të respektohen si nga shitësi edhe nga blerësi.

Obligimi blerësit është që të paguaj qmimin më kohë dhe ashtu siq është parapar në kontratë po ashtu edhe nga ana e shitësit duhet të ofroj mallin e cilësisë që është paraparë në kontratë.

Mos respektimi i kontratës apo më mirë të themi mos përmbushja më kohe e kontratës ajo mund edhe të ndërpritet, dhe mund të pasoj edhe më padi për kompenzimin e dëmit, sepse përmes mos përmbushjes së kontratës shitësit i ka shkaktuar dëm ose e kundërta, dhe për fitimin e humbur mund të paguaj edhe kompenzim.

Përfundimet

Rregullat material të shitblerjes janë ato rregulla pa të cilat nuk mund të krijohet treg të lirë dhe të mirëfilltë dhe më mallin dhe qmimin tonë nuk mund të konkurojmë në asnjë tregë të lirë, dhe malli ynë nuk mund ti plotësoj kriteret e kërkuara.

Prandaj rekomandoj përpos që kontrata duhet të jetë saq më profesionale dhe të përpilohet nga profesionalisti ajo edhe duhet të prodhoj efekte

juridike, ekonomike. Pastaj shitësi duhet ta respektoj në rapor të barabartë më blerësin dhe të krijojnë një praktik të mirë të komunikimit.

Blerësi nuk duhet të keqpërdor raportin më shitësin dhe blerësi mallin e marrë duhet ta respektoj firmen e caktuar, mirëpo për dallim nga shitësi blerësi duhet ta ketë një komoditet më të mirë sesa shitësi sepse shitësi është i varur nga blerësi dhe si rezultat i konkurences duhet të ofroj kushte të mira blerësit si dhe mallin sa më cilësor.

Literatura

1. Hetemi, Mehdi, “ E drejta Ndërkombetare Tregtare – Afariste”, Prishtinë, 2007.
2. Hetemi, Mehdi, “ Mbrojtja e Tregut të Lirë nga Konkurenca Jolojale”, Prishtinë, 2007.
3. Libri i Përmbledhjeve, Takimi i katërt vjetor ndërkombetarë i Institutit Alb- shkenca “ IASH- 2009” Studiusit Shqiptarë në Rrjedhat e Shkencës Botërore, Tetovë, 31. 08, 1 – 2.09.2009.
4. A.Garro, A, Zuppi, Compraventa internacional de marcaderias, Buenos Aires, 1990.
5. Revista e “ Drejta” Prishtinë 2009.
6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
7. Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorëve.

=====

KUD 338.24

NDIKIMI I AUDITIMIT TË JASHTËM NË NGRITJEN E CILËSISË SË RAPORTIMIT FINANCIAR

*MSc. Brikenda Vokshi
kenavokshi@yahoo.com*

Abstrakt

Sa me shumë konkurent të aktivizohen në ekonominë e tregut, aq më të rëndësishme për shfrytëzuesit e pasqyrave financiare bëhen informatat financiare të cilat janë të qëndrueshme, të besueshme dhe kuptimplotë. Qeveria mbështetet në raporetet financiare për t'i mbledhë në mënyrë efikase, të drejtë dhe proporcionale tatimet. Ndërmarrjet mbështeten në raporete financiare për thithjen e investimeve, për blerjen e aksioneve dhe pjesëve të ndërmarrjeve tjera. Investuesit mbështeten në raportet financiare për të rritur kapitalin apo zgjeruar operacionet biznesore. Kjo ndikon në dobi të krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjes ekonomike. Në mënyrë që këto shenime financiare të cilat u shërbejnë shfrytëzuesve të jashtëm të jena sa më bindëse, të qëndrueshme dhe të drejta, ato duhet të vërtetohen. Kjo e paraqet detyrën parësore të funksionit të auditimit, njëkohësisht edhe ngritjen e cilësisë së raportimit financiar.

Fjalët kyçe: Pasqyra financiare, auditim, cilësi, raportim, ngritje.

JEL kualifikimi: M4 , M42

1. Hyrje

Auditimi është procesi sistematik i përfitimit dhe vlerësimit objektiv i evidencave të auditimit mbi të cilat mbështeten pohimet e menaxhmentit për veprimet dhe ngjarjet ekonomike të entiteteve të ndryshme në mënyrë që të përfitohet një siguri e arsyeshme mbi shkallën e përputhjes së këtyre pohimeve, kriterëve të vendosura për pregaditjen e tyre si dhe komunikimit të rezultateve përmes pasqyrave të raportuara ndaj palëve të interesuara për to.

Me qëllim që një proces i auditimit të ketë një efekt sa më të madh, auditimi duhet të bazohet në një kornizë konceptuale të shëndoshë dhe më

shumë logjike. Këtë e mundësojnë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA –të) të cilat kanë ndikim global në procesin e auditimit.

Auditimi i jashtëm nuk është pjesë e brendshme e organizatës, është i pavarur nga entiteti të cilin e auditon. Pra, është i pavarur dhe për punën që e bënë kuptohet kompenzohet nga organizata që i ka angazhuar. Zakonisht auditorët e jashtëm bëjnë auditimin e pasqyrave financiare me qëllim që të krijohet një opinion i saktë mbi korrektësinë e veprimeve afariste të organizatës, duke konstatuar a janë përpiluar pasqyrat financiare në pajtim me parimet e përgjithshme për pregaditjen dhe raportimin e tyre.

Auditimi nuk është qëllim në vete por një pjesë e pazëvendësueshme e sistemit rregullator, qëllim i të cilit është zbulimi i devijimeve nga standardet e pranura dhe shkeljet e parimeve të ligjshmërisë efikasitetit, efektshmërisë dhe ekonomisë së menaxhimit financiar; aq herët sa për ta bërë të mundur ndërmarrjen e masave korrektuese në rastet individuale, për të bërë që personat përgjegjës të marrin përgjegjësinë, për të siguruar kompenzimin apo për të ndërmarrë hapa për parandalimin apo të paktën për t'i bërë më të vështira shkeljet e tilla.

2. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare

Qëllimi i matjes dhe i regjistrimit të aktiviteteve të biznesit është që të ofrojë informacione të dobishme për ata të cilët kanë nevojë të marrin vendime. Kontabiliteti raporton informacione për vendimmarrësit në formën e raporteve financiare.

Raportet financiare janë raporte që përmbledhin rezultatet e veprimeve kontabël të një organizate për një periudhë fiskale. Zakonisht, pasqyrat financiare përpilohen dhe prezantohen në bazë të kohës njëvjeqare për një gamë të gjërë të shfrytëzuesve të rëndomtë. Shumë nga këta shfrytëzues mbështeten në këto pasqyra financiare si burim kryesor të informative për arsye se nuk kanë qasje tjetër në informata më të hollësishme për nevojat e tyre të veqanta.

Objektivi i pasqyrave financiare është të japë një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë ekonomike raportuese.

Pasqyrat financiare përdoren nga shfrytëzues të brendshëm dhe të jashtëm.

Pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë së njësisë ekonomike raportuese, sipas Standardit nr.1 të Kontabilitetit vetëm dhe vetëm nëse:⁶⁹

⁶⁹ Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar SNRF, IASCF , 2007, faqe 75

(a) ato janë të sakta e të plota në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;

(b) përgatitja e tyre bazohet në vlerësime të arsyeshme e të bazuara (në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme);

(c) shënimet në pasqyrat financiare janë përgatitur me detaje të mjaftueshme për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të një njësie ekonomike raportuese, në mënyrë të tillë që lexuesit kompetentë të mund të nxjerrin konkluzione të arsyeshme.

Informacioni kontabël i raportuar nga organizatat duhet të auditohet. Auditimi është ekzaminim i hollësishëm i raporteve financiare të një organizate. Ai përfshin ekzaminimin e sistemit të informimit të përdorur për të pregaditur raportet financiare dhe përfshin ekzaminimin e procedurave të kontrollit që përdorin organizatat për të siguruar saktësinë e informacionit kontabël. Qëllimi i një auditimi është të vlerësojë se kur një informacion që i raportohet marrësve të jashtëm të vendimeve është një paraqitje e drejtë e aktiviteteve ekonomike të organizatës. Standardet për pregaditjen dhe raportimin e informacionit ndihmojnë në sigurimin e besueshmërisë së pasqyrave financiare.

Auditimi i pasqyrave financiare përcakton nëse pasqyrat e përgjithshme financiare japin pamjen e vërtetë dhe të sinqertë duke iu përmbjatur kriterëve specifike. Si kriter shërbejnë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK).

Pasqyrat financiare të cilat auditohen zakonisht janë:

- a. Bilanci i gjendjës;
- b. Pasqyra e rrjedhjes së parasë (Cash Flow);
- c. Pasqyra e të ardhura, dhe
- d. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet.

Synimi i auditimit të pasqyrave financiare është t'i mundësohet auditorit të shprehë mendimin se këto pasqyra janë përpiluar sa i përket aspektit material në pajtim me kornizën raportuese në fuqi. Që ta përmbushë këtë auditori siguron prova të mjaftueshme dhe të caktuara si themel të përfundimit të vet.⁷⁰

Opinion i audituesit e përforcon besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe ndihmon në rritjen e besimit të veprimtarive ekonomike të ndërmarrjeve. Si objektiv kryesor i auditimit të jashtëm është t'i mundësohet auditorit që ta shprehë opinionin nëse pasqyrat financiare të publikuara japin 'një pamje të vërtetë e të sinqertë' të pozicioneve financiare dhe rezultateve të veprimtarive për periudhën për të cilën janë pregaditur pasqyrat.⁷¹

⁷⁰ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, (ISA), IFAC, 2000, faqe 11

⁷¹ Dr.L.Zager, B.Tusek, Revizija, Zagreb, 2007, faqe 65

Për të formuar një opinion mbi pasqyrat financiare, audituesi kërkon të arrijë një siguri që informacionet në përmbajtje të dokumentëve kontabël të paraqitura dhe të dhënat e tjera bazë janë të besueshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur pregaditjen e pasqyrave financiare. Raporti i auditimit, ose mendimi i auditimit, japin një njoftim publik të besimit të auditorit mbi ndershmërinë dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare.

Puna e një auditori të jashtëm është:

- a. Të bëjë hetimin periodik me një kohë të kufizuar kohore;
- b. Të bëjë hetimin e sektorëve të ndryshëm të organizatës, e më së shpeshti të kontabilitetit duke vlerësuar kryesisht rregullsinë juridike të veprimeve afariste.

3. Përgjegjësia e auditorëve për të marrë parasysh rreziqet në pasqyrat financiare

Auditori dhe menaxhmenti i ndërmarrjes së cilës i bëhet auditimi kanë përgjegjësi të ndara dhe të veqanta. Auditori është përgjegjës për formulimin dhe dhënien e opinionit për pasqyrat financiare. Kurse në anën tjetër menaxhmenti kanë përgjegjësinë për përpilimin dhe prezantimin e pasqyrave financiare në pajtim me rregulat dhe standardet e pranuar për pregaditjen e tyre. Fakti se pasqyrat financiare janë të audituara nuk e lirojnë menaxhmentin nga përgjegjësia mbi anomalitë e mundshme në pasqyrat financiare.

Pra, auditori për shkak të natyrës së evidencave të auditimit mund të jap vetëm një siguri të arsyeshme, por jo absolute që janë gjetur anomalitë materiale ose ndonjë gabim në pasqyrat financiare⁷². Auditori nuk ka asnjë përgjegjësi për të planifikuar dhe kryer auditimin për të përfituar një siguri të arsyeshme për sa i takon anomalive jomatereiale, qofshin këto të shkaktuara nga ndonjë gabim, mashtrim ose akt ilegal.

Pasqyrat financiare të cilat përpilohen nga menaxhmenti përmbajnë pohime rreth përbërësve të pasqyrave financiare. Nga provat e mbledhura nga zbatimi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, auditorët deklarojnë që pasqyrat financiare nuk përmbajnë anomaly material të paraqitura në mënyrë të gabuar. Materialiteti është një kriter për caktimin e rëndësisë së keqvendosjeve të mundshme të pasqyrave financiare të audituara⁷³.

Pasqyrat financiare përmbajnë vlerësime dhe vendosje që varen nga vendimi i menaxhmentit. Përveq kësaj në gjetjen e gabimeve në rexhistrimet

⁷² Dr.L.Zager, B.Tusek, Revizija, Zagreb, 2007, faqe 129

⁷³ Robert W. Ingram, Thomas Albright and Bruce A. Buldwin, Financial Accounting, faqe 262

kontabël, auditorët mund të mos bien dakord me menaxherët për vlerësimet dhe caktimet e tyre. Përderisa këto gabime dhe mosmarrëveshje janë matreiale (të rëndësishme) për shumën e përgjithshme të paraqitur në raportet financiare, gjithsesi auditorëve nuk u kërkohet të marrin masa për këto qështje.

Menaxhmenti është përgjegjës për pregaditjen e pasqyrave financiare dhe informacionet lidhur me to që raporton në mënyrë të drejtë veprimtaritë e biznesit të një ndërmarrje. Menaxhmenti është gjithashtu përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi të auditimit të brendshëm.⁷⁴

Standardet e auditimit i klasifikojnë pohimet e menaxhmentit në pesë kategori:

1. Ekzistenca ose ndodhja,
2. Plotësia,
3. Të drejtat dhe detyrimet,
4. Vlerësimi dhe shpërndarja, dhe
5. Paraqitja dhe shpalosja.

Puna e një auditori të pavarur përmban realizimin e përfitimit dhe vlerësimit të evidencës që ka të bëjë me këto pohime. Megjithatë, është poashtu e mundur që një auditor të kryejë një auditim në përputhje me SNA dhe të japë një opinion pa rezervë, ndërkohë që pasqyrat financiare të përmbajnë akoma anomaly matreiale.

4. Ndikimi i auditimit të jashtëm në ngritjen e cilësisë së raportimit financiar

Ruajtja e një sistemi të besueshëm të kontabilitetit dhe e raportimit të informacionit, që paraqet ndershmerisht veprimtaritë ekonomike të ndërmarrjes është një detyrë e rëndësishme që i shoqëron pasqyrat financiare të një ndërmarrje. Auditorët e lëshijnë një raport auditimi sipas përfundimit të punës së tyre të kontrollit. Auditori përpiket të verifikojë që numrat dhe shpalljet e bëra nga menaxhmenti në raportet e tij financiare janë në përputhje me pozitën financiare të ndërmarrjes, rezultatet operuese dhe rrjedhjen e parave.

Auditori në raportin e auditimit, gjatë shqyrtimit të gjetjeve të bëra në pasqyrat financiare jep edhe ndikimin e këtyre gabimeve në pasqyrat financiare , poashtu edhe rekomandimet se si duhet të veprohet me tutje në mënyrë që pasqyrat financiare të pregaditen sa me drejtë dhe të paraqesin pamjen e vërtetë dhe të plotë të entitetit që auditohet. Menaxhmenti i

⁷⁴ Auditing & Assurance Services; A systematic approach Messier, W. and C. Emly, Mc Grow – Hill, Ryerson Limited, 2005, faqe 169

ndërmarrjes është përgjegjëse që t'i merr për bazë rekomandimet e bëra nga ana e auditorit të jashtëm.

Planet e Zbatimit dhe Përcjelljes së Rekomandimeve janë rrënjësore për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të Auditimit të Jashtëm mbi përmirësimin e kontrollit dhe ngritjen e cilësisë së raportimit financiar. Plan i Zbatimit duhet të përgaditet për secilin auditim të kompletuar. Ai duhet të regjistrojë të gjitha rekomandimet dhe datën e implementimit të tyre.

Ndjekja e rekomandimeve duhet të mbështetet nga të dhënat mbi rekomandimet e bëra më parë. Ndjekja e rekomandimeve mund të bëhet nga:

- Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve;
- Përfundimi e rishikimit të dokumenteve, i cili përfshin një rishikim më të detajuar të zbatimit të rekomandimeve, por nuk përfshin vëzhgimin në terren;
- Një rishikim të detajuar që përfshin vëzhgimin në terren në lidhje me rekomandimet e bëra gjatë raportit të auditimit;
- Një rishikim të përgjithshëm të rekomandimeve kryesore që janë të njëjtit tip në të njëjtin ent ose në ente të ndryshme për të analizuar arsyet e përbashkëta të ecurisë/vazhdimësisë së ngritjes së cilësisë së raportimit financiar.

Procesi i ndjekjes së rekomandimeve është jetësor për arsye se:

- përmirëson procesin e punës,
- rrit ekonomicitetin, efikasitetin dhe efektivitetin në subjekt.
- mos realizimi i rekomandimeve do të sjellë një efektivitet të ulët.

Sa më të pakta janë rekomandimet aq më cilësore do të jenë raportet financiare:

- a) Sa më të rregullta të jenë auditimet e P.F., aq më të mëdha janë gjasat për të marrë mendim kompetentë për P.F.;
- b) Sa më të rregullta të jenë auditimet P.F., aq më të pakta do të jenë rekomandimet për korigjime;
- c) Sa më të rregullta të jenë auditimet P.F., aq më cilësore dhe më të besueshme do të jenë P.F.

4. Përfundimi

Paraqitja e drejtë dhe e plotë e aktiviteteve ekonomike të ndërmarrjeve dhe prezantimi i pasqyrave financiare është i nevojshëm për shumë shfrytëzues të brendshëm dhe të jashtëm. Kontabiliteti është kritik për veprimet e një ekonomie tregu. Që shoqëria jonë të vazhdojë të zhvillohet është shumë e rëndësishme që ata të cilët marrin vendime t'a kuptojnë informacionin kontabël të prezantuar në pasqyrat financiare dhe

mënyrën se sit a përdorin këtë informacion për të vlerësuar aktivitetet e ndërmarrjes.

Mirëpo, që ky informacion të jetë më i besueshëm ai duhet të auditohet. Auditimi është ekzaminimi i hollësishëm i pasqyrave financiare të një ndërmarrjeje. Auditimi përfshin një hetim të detajuar e sistematik të vertetimit të pohimeve të mezxhmentit të përfshira në pasqyrat financiare. Me qëllim që auditimi të ketë efekt sa më të madh ai duhet të bazohet në një kornizë konceptuale apo në standardet dhe rregullat në fuqi.

Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është t'i mundësohet auditorit të shprehë mendimin e vet se prezantimi dhe përpilimi i pasqyrave financiare është bërë Brenda kornizës raportuese dhe se nuk përmbajnë ndonjë anomali materiale. Mendimi i auditorit e rrit besueshmërinë e pasqyrave financiare. Auditori i verifikon pasqyrat financiare nëse ato paraqesin drejtësisht veprimtaritë e biznesit të një ndërmarrjeje. Auditori nuk përbënë ndonjë garanci që ndërmarrja do të jetë e suksesshme. Nëse një ndërmarrje nuk ecën mirë pasqyrat financiare të saj duhet t'i paraqesin problemet. Informacioni i mirë nuk nënkupton që një ndërmarrje po ecën mirë ose se investitorët mund të nxjerrin kthime të larta. Auditori verifikon cilësinë e informacionit financiar, jo cilësinë e menaxhimit ose aftësisë së menaxhmentit për të marrë vendime të drejta biznesi.

5. Referencat

1. Grup autorësh, Auditim, Tiranë, 2007.
2. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA), IFAC, 2000.
3. Dr. L. Zager, B. Tusek Revizija, Zagreb, 2007.
4. William f. Messier Jr, DBA, CPA AUDITING, Mc Graw – Hill, INC.
5. Douglas R. Carmichel, John J. Willingham, Auditing Concepts and Mc Grow Hill INC.
6. RICK Hayes, Arnold Schilder, Roger Dessen, Phil Wallaye, PRICIPLES OF Auditing and INTERNACIONAL PERSPECTIVE, Concepts and methods McGraw – Hill, INC.
7. Abbott, L. J. and S. Parker. 2000. Auditor selection and audit committee characteristics. *Auditing: A Journal of Practice & Theory* 19.
8. Abbott, L. J., S. Parker, G. F. Peters. 2001. The effectiveness of blue ribbon recommendations in mitigating financial misstatements: an empirical study. *Auditing Mid-year Conference*. Houston, Texas.

9. Carcello, J., D. R. Hermanson, T.L. Neal and R. Riley, Jr. 2002. Board characteristics and audit fees. *Contemporary Accounting Research*.
10. Carcello, J., and T.L. Neal. 2003. Audit committee characteristics and auditor dismissals following “new” going concern reports. *The Accounting Review* .
11. Cutting, Thomas (January 12, 2008). "How to Survive an Audit". PM Hut.

KUD 502.3(496.51)

**MJEDISI I SHËNDOSHË NATYROR PËR NJË ZHVILLIM TË
QËNDRUESHËM**

*Mr. Driton Sylqa
dsylqa@gmail.com*

Abstrakt

Ky punim ngërthen në vete idenë se mjedisi natyror ka rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillim dhe rritje të qëndrueshme ekonomike. Nga analiza e gjendjes ambientale në Kosovë vlerësohet se të gjithë elementet dhe komponentët e mjedisit jetësor (ajri, uji, dheu) janë të rrezikuara. Rrezikimi i ambientit në Kosovë është rezultat i ndotjes së ambientit, i ndërtimeve të pakontrolluara, prerjes së pakontrolluar të pyjeve, erozionit të dheut, nga menaxhimi i dobët i mbeturinave, si dhe aktiviteteve të tjera humane. Raporti i mjedisit natyror me rritjen ekonomike është reciprok sa edhe i ndërlikuar. Një zhvillim i qëndrueshëm i sektorëve të ndryshëm ekonomik nuk mund të imagjinohet pa një mjedis të shëndoshë natyror. Lidhur me këtë tematikë në punim janë trajtuar konceptet kyçe të mjedisit dhe janë identifikuar sektorët e ndryshëm ekonomik që kanë ndikim në mjedisin natyror. Në përmbyllje, është propozuar një model i detajuar me masat adekuate për mbrojtjen e mjedisit dhe rrjedhimisht inicimin e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik.

Fjalët kyçe: mjedisi natyror, ambienti, sektori ekonomik, zhvillimi ekonomik

JEL klasifikimi: M1, Q01, Q5

Hyrje

Mjedisi natyror dhe burimet e saj nuk janë të mira të lira apo të pafundme. Përvoja e gjertanishme ka treguar se shumë nga të mirat dhe shërbimet që ofron mjedisi natyror janë të kufizuara / të shterrueshme. Për më tepër ato nuk i takojnë vetëm një brezi shoqëror. Ato do të përbejnë bazën natyrore e materiale të jetës edhe për gjithë brezat që do të vijnë, të cilët gëzojnë të njëjtat të drejta. Nga kjo pikëpamje në administrimin e mjedisit dhe burimeve natyrore duhet nisur nga ideja që i konsideron ato si një hua e dhënë nga brezat e ardhshëm dhe njëkohësisht edhe si një trashëgimi që duhet t'u lihet atyre.

Përvoja e derisotme në Kosovë tregon se as rritja dhe as zhvillimi i qëndrueshëm nuk janë bërë ende tendencë konstante dhe e përgjithshme e planeve dhe strategjive afatgjata të qeverisë. Aq më pak, ato përbëjnë një tendencë në qëndrimin e individëve. Historia e viteve të fundit e vërteton plotësisht një gjë të tillë.

Një qëndrim tjetër tipik dhe i gabuar është pranimi apriori i idesë se mjedisi kushton. Praktika e vendeve të zhvilluara dhe bizneseve të suksesshme në këtë drejtim ka treguar se kosto e administrimit të mjedisit është mjaft më e ulët nëse për mjedisin mendohet paraprakisht. Kjo ide është mjaft e qartë nga thënia e famshme se “Të parandalosh është më mirë se të kurosh”, që edhe në këtë fushë ka kuptim thuajse universal. Lidhur me këtë, eksperiencia e Bankës Botërore në këtë fushë tregon se 20-30% e ndotjes nga industria mund të evitohet pa ndonjë investim kapital, kurse një 20% tjetër mund të evitohet me investime kapitale relativisht të vogla që përgjithësisht vetëshlyhen brenda një periudhe disamujore.

Zhvillimi i qëndrueshëm nuk do të thotë domosdoshmërisht që të mendohet vetëm apo në radhë të parë për mjedisin. Ai nënkupton që çështjet e mjedisit të kihen parasysh dhe të përfshihen në të gjitha politikat, strategjitë dhe vendimet sektoriale. Të gjitha këto duhet të parashikojnë edhe efektet e mundshme në mjedis dhe masat e nevojshme për zbutjen e tyre.

Mjediset e pyllëzuara kanë një rëndësi të veçantë, pasi ofrojnë një gamë të gjerë të përfitimeve mjedisore, ekonomike dhe sociale. Jetike për një jetesë të shëndetshme dhe, në të njëjtën kohë, për ruajtjen e ekuilibrave natyrorë, hapësirat e pyllëzuara marrin një rëndësi të veçantë për një shtet që ka detyrën e menaxhimit dhe përdorimit të tyre. Shërbimet në mbrojtje të pyjeve janë thelbësore për zbutjen e fatkeqësive natyrore, si përmybtjet, thatësirat dhe rrëshqitjet e tokës, që mund të kenë pasoja për popullsinë. Një përkufizim i përbashkët i menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, do të thotë administrim dhe përdorim i pyjeve dhe tokave pyjore, në një mënyrë që ruan bio-diversitetin, produktivitetin, kapacitetin regjenerues, vitalitetin dhe potencialin e tyre për të përmbushur funksionet jetësore. Një kuptim i përbashkët i asaj që konsiderohet menaxhim i qëndrueshëm, mund të arrihet vetëm përmes bashkëpunimit mes ministrive dhe autoriteteve lokale, bazuar në kornizën ligjore që rregullon këtë çështje⁷⁵.

Shënime gjeografike, relievi dhe klima në Kosovë

Kosova ka një sipërfaqe prej 10,887 km². Ajo kufizohet me Shqipërinë (në jugperëndim), me Maqedoninë (në juglindje), me Serbinë (në

⁷⁵ Studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional, Prishtinë, 2003

lindje, veri dhe verilindje) dhe me Malin e Zi (në perëndim). Kosova është vend malor dhe me ultësira, i përbërë nga Fusha e Kosovës (me lartësi mbidetare 510-570 m) dhe Rrafshi i Dukagjinit (lartësia mbidetare 350-450 m).⁷⁶

Kosova karakterizohet me katër pellgje kryesore, e ato janë: Pellgu i Drinit të Bardhë, Pellgu i Ibrit, Pellgu i Moravës së Binçës dhe Pellgu i Lepencit. Lumenjtë e Kosovës rrjedhin në drejtim të tri deteve:

- Pellgu i Drinit të Bardhë, përmes Shqipërisë, derdhet në detin Adriatik;
- Morava e Binçës dhe Ibri, nëpërmes Serbisë dhe Rumanisë, derdhet në Detin e Zi;
- Lepeci përmes Maqedonisë dhe Greqisë derdhet në Detin Egje.

Në vitet me lagështi mesatare, nga rrjedhat e lumenjve të Kosovës rrjedhin në dete 3.8 miliard m³ ujë ose 120 m³/s. Kosova posedon gjashtë liqene (akumulacione) artificiale e ato janë: Ujmani, Radoniqi, Batllava, Badovci, Përlepnica dhe Livoçi.⁷⁷

Në Kosovë shtrihen disa male të larta, si: Malet e Kopaonikut (në veri), Rogoznës dhe Moknës (në veriperëndim), Bjeshkët e Nemuna (në perëndim), Pashtrikut dhe Koritnikut (në jugperëndim), Malet e Sharrit (në jug), Mali i Zi i Shkupit (në juglindje) e të tjera, të rrethuara me ultësira. Maja më e lartë është Gjeravica (2,655 m) e cila gjendet në vargmalet e Bjeshkëve të Nemuna. Relievi vullkanik është i pranishëm në pjesën veriore të Kosovës (kupa e vjetër vullkanike në Zveçan, me lartësi mbidetare 799 m).

Klima - Klima është e mesme-kontinentale, me ndikim mbizotërues të klimës adriatiko - mesdhetare në Rrafshin e Dukagjinit, përmes luginës së Drinit të Bardhë, si dhe me ndikim më të vogël të klimës së ndryshuar adriatiko-egjeniane në fushën e Kosovës. Të reshurat mesatare vjetore 596 mm. Temperaturat mesatare vjetore të Kosovës janë 10 °C, me temperaturën e arritur minimale -27,2 dhe maksimale 39,2.⁷⁸

Biodiversiteti

Në artikullin 2 të Konventës për Deklaratës së Rios, Biodiversiteti përkufizohet:

“Ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë që jetojnë në ekosistemet tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore dhe komplekset

⁷⁶ Raport mbi gjendjen ambientale ne Kosove, Qeveria e Kosovës, MMPH, 2004

⁷⁷ Ibid

⁷⁸ Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.

=====

ekologjike, në të cilat ato bëjnë pjesë; kjo përfshin diversitetin brenda llojit, midis llojeve dhe ekosistemeve”⁷⁹

Termi diversitet biologjik shpreh numrin dhe gjithë larminë e organizmave të gjallë në planet. Brenda këtij termi përfshihet diversiteti i gjeneve, llojeve dhe ekosistemeve që janë produkt i një procesi evolutiv prej më se 3 miliardë vjet. Njerëzimi dhe mbijetesa e tij varet nga ky diversitet biologjik. Në këtë kuptim termi diversitet biologjik është sinonim i termit “Jeta në planet”⁸⁰.

Vendi ynë dallohet me një shumëllojshmëri të florës dhe faunës. Në bazë të hulumtimeve të deritanishme janë të inventarizuara rreth 1800 lloje bimore, mirëpo besohet se numri i llojeve duhet të jetë diku afër 2500. Ndërsa sa i përket faunës mund të themi se janë të përhapura rreth 230 lloje të egra të kurrizorëve, kurse pakurrizorët janë shumë pak të hulumtuar dhe nga ky grup ekzistojnë të dhëna për afro 150 lloje të fluturave. Ajo që florën dhe faunën e Kosovës e bënë të rëndësishme dhe joshëse është numri i madh dhe llojllojshëm i bimëve krahasuar me sipërfaqen e saj. Janë konstatuar rreth 200 lloje bimore endemike, endemorelikte dhe subendemike. Zonat më të begatshme me faunë në Kosovë janë Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna ku llogaritet që ekzistojnë: 8 lloje peshqish, 13 ujëtokësorësh, 12 lloje rrëshqitësish, 154 lloje shpendësh, 37 lloje gjitarësh dhe 147 lloje flutura ditore. Ajo çka e bënë mosnjohjen e numrit të saktë të llojeve bimore dhe shtazore është mungesa e inventarizimit të biodiversitetit në Kosovë. Mungon gjithashtu edhe baza ligjore me të cilën do të mbrohej biodiversiteti dhe që për pasojë kemi humbje të pakontrolluar.⁸¹

Mjedisi natyror dhe roli i tij në rritjen ekonomike

Mjedisi natyror lidhet me rritjen ekonomike në një raport kompleks e reciprok. Rritja ekonomike do të thotë që bruto produkti kombëtar (BPK) për kokë banori të rritet me kalimin e kohës. Megjithatë, kjo tendencë për rritje nuk do të thotë që rritja është e qëndrueshme.

Rritja ekonomike e qëndrueshme do të thotë që BPK për kokë banori të rritet me kalimin e kohës dhe kjo rritje në të ardhmen nuk do të kërcënohet / kufizohet nga ndotja, shërrimi i burimeve apo nga problemet sociale që lidhen me to.

⁷⁹ Rio Declaration on Environment and Development, Having met at Rio de Janeiro from 3 to 14 June 1992, për shumë shih ne <http://www.unep.org/Documents.Multilingual/Default.asp?documentid=78&articleid=1163>

⁸⁰ Studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional, Prishtinë, 2003

⁸¹ Raport për mbrojtjen e mjedisit, MMPH, 2008

Mjedisi është kapitali natyror që së bashku me kapitalin fizik të krijuar nga njeriu dhe kapitalin njerëzor realizojnë rritjen ekonomike. Nga ana tjetër rritja ekonomike ndikon mbi mjedisin: mund të cenojë vlerat e tij si në aspektin cilësor (dëmtohet cilësia e burimeve dhe komponentëve të veçantë të mjedisit) ashtu dhe në aspektin sasior (pakësohet kontingjenti i burimeve për të ardhmen). Mjedisi natyror jo vetëm ofron burime për rritjen ekonomike por bart edhe pasojat e kësaj rritje (ndotjen, mbetjet industriale dhe urbane, pakësimin e pyjeve, të ajrit dhe ujit të shëndetshëm, etj. Duke e parë raportin rritje-mjedis nga kjo pikëpamje, literatura bashkëkohore e ekonomisë së mjedisit dallon midis rritjes dhe rritjes së qëndrueshme, dhe për më tepër midis zhvillimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Nga kjo pikëpamje, dhe sidomos në kushtet kur ekonomia jonë po fillon të rindërtohet, interesi ynë nuk duhet të jetë thjesht për rritjen ekonomike, por për rritjen ekonomike të qëndrueshme, bile nën një këndvështrim me perspektivë ai duhet të fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm.⁸²

Sektorët ekonomik dhe ndikimi i tyre në mjedis

1. Industria dhe xehetaria

Deri në fund të viteve të 80-ta, industria dhe xehetaria bënë pjesë me gati 50% në bruto produktin vendas dhe mbështetej kryesisht në shfrytëzimin e resurseve minerale, (thëngjilli, xehet metalike, xehet jometalike etj.). Pas përfundimit të luftës, (1999) pjesa më e madhe e aktiviteteve xehetare dhe industriale është ndërprerë pothuajse tërësisht (minierat e xeheve të metaleve dhe jometaleve dhe komplekset përkatëse metalurgjike). Sektori privat i veprimtarisë prodhuese ka filluar të zhvillohet gjatë dekadës së fundit, mirëpo pa ndonjë koncept të mirëfilltë. Për shkak të zvogëlimit drastik të prodhimit, shkalla e ndotjes së mjedisit nga industria dhe xehetaria është zvogëluar, mirëpo problemet mjedisore të së kaluarës janë ende të pranishme: deponitë industriale, që zënë një sipërfaqe të madhe të tokës dhe janë ndotës permanent të ajrit, ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor.

2. Energjetika

Rreth 97% e energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë sigurohet nga djegia e linjtit në termocentralet A dhe B, kurse nga rrjedhat ujore sigurohen vetëm afër 3% të prodhimtarisë vjetore. Fuqia e instaluar e

82 Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, IPVQ Raport Sektorial – Mjedisi, 2008

termocentraleve njehson 1.478 MW, kurse furnizimi me linjit bëhet nga mihjet sipërfaqësore të Mirashit dhe Bardhit, me kapacitet të projektuar të shfrytëzimit të linjtit, prej 16 milionë tonë në vit. Shkalla aktuale e shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese të termocentraleve është e ulët - vetëm rreth 30% të fuqisë së instaluar. Kosova nuk ka burime vetanake të karburanteve të lëngët dhe të gaztë, kështu që furnizimi me këta karburant bëhet ekskluzivisht nga importi. Në përgjithësi, efikasitetit i shfrytëzimit të energjisë është i ulët. Sektori i energjisë i Kosovës është ndotës i madh i mjedisit, sidomos në regjionin e gjerë të Prishtinës. Gazrat e emetuara nga termocentralet përmbajnë sasi të mëdha të pluhurit, oksideve të azotit, dyoksidit të squfurit, metaleve të rënda, etj. Ujërat e shkarkuar nga termocentralet lëshohen në lum të patrajtuar dhe shkaktjnë ndotjen e rrjedhave ujore, veçanërisht me fenole.

Problem paraqesin edhe deponitë e hirit të depozituara në rreth 160 ha të tokës punuese, Në bazë të llogaritjeve TC-të, A dhe B, së bashku prodhojnë rreth 1 milion ton të hirit në vit, prej tyre 700.000 t janë të depozituara në deponitë e hirit, ndërsa 300.000 t lirohen në ajër.⁸³

3. Bujqësia

Gjendja e bujqësisë në Kosovë është e rëndë. Shumë ferma janë lënë pas dore, kurse infrastruktura është shkatërruar pjesërisht e në disa raste plotësisht. Bujqësia si sektor kontribuon me rreth 30% në GDP e Kosovës, ndërsa bashkë me pylltarinë përbëjnë rreth rreth 35 %. Kosova nuk i përmbushë nevojat e popullatës me prodhime vetanake bujqësore andaj 80% të prodhimeve bujqësore importohen. Cilësia e tyre është i dyshimtë dhe i pakontrolluar në mënyrë kompetente. Importimi dhe përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve bëhet pa kontroll dhe monitorim.

Problemët kryesorë në sektorin e bujqësisë janë:

- mungesa e infrastrukturës ligjore në fushën e bujqësisë, prodhimtaria ekstensive,
- kontrolli i pamjaftueshëm i cilësisë së produkteve bujqësore të - prodhuara në vend dhe të importuara, përdorimi jo adekuat i plehrave dhe pesticideve.
- ndotja nga mbeturinat e kafshëve të therura, të ngordhura dhe nga pularia
- mungesa e trajtimit të plehrave të fermave të mëdha dhe të mesme blegtorale;
- mungesa e fondeve ekologjike për bujqësi.

⁸³ Raporti sektorial i mbrojtjes së mjedisit, 2004

4. Transporti

Transporti në Kosovë bazohet kryesisht në transportin rrugor, derisa ai hekurudhor nuk është vënë në funksion të plotë pas luftës. Gjithsej janë 1.925 km rrugë të shfrytëzueshme magjistrale dhe regjionale, të cilat me gjithë investimet e bëra ende janë në gjendje të rëndë. Pas përfundimit të luftës është shënuar një shtim enorm i automjeteve, kështu që aktualisht qarkullojnë rreth 215.000 automjete të regjistruara. Pjesëmarrja e transportit publik në transportin e përgjithshëm është e vogël. Numri më i madh i automjeteve që aktualisht qarkullojnë në Kosovë janë të vjetra, teknikisht jo të rregullta, me përdorim të lëndëve djegëse jocilësore dhe pa përdorim të katalizatorëve. Në këtë mënyrë ato paraqesin burim të ndotjes së ajrit, por edhe të rrjedhave ujore dhe tokës dhe shkaktojnë zhurmë mbi normat e lejuara. Gjithashtu edhe hedhja e pakontrolluar e vajrave të shfrytëzuara të automjeteve shkakton një ndotje të madhe të tokës, dhe ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor.

5. Pylltaria

Pyjet mbrojnë pellgjet tona ujore dhe ruajnë tokën tonë. Ato ndihmojnë për të luftuar ndryshimet klimatike, duke thithur dhe ruajtur sasi të mëdha karboni, sigurojnë ushqim, materiale ndërtimi dhe medikamente, dhe janë shtëpia e 80 % të biodiversitetit në botë.

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara ka shpallur 2011-ën si Viti Ndërkombëtar i Pyjeve (Pyjet 2011). “Pyjet për Njerëzit” është tema kryesore e Vitit. Ajo thekson lidhjen dinamike mes pyjeve dhe njerëzve që varen nga ato. Një seri aktivitete, të planifikuara të zhvillohen përgjatë gjithë vitit në mbarë botën, në nivel rajonal, kombëtar dhe lokal, synojnë të nxisin pjesëmarrjen e gjerë të publikut në çështje që lidhen me pyjet. Aktivitetet përfshijnë mbjelljen e pemëve, përpjekjet për ripyllëzime, panairë për pyllin, konferenca dhe konkurse fotografish e pikturash për pyjet. Aktivitete të tjera përfshijnë publikime librash, materiale edukuese, shpallje për shërbime publike dhe fushata mediale.

Kosova ka rreth 455 000 ha pyje prej të cilave 54 % janë në pronë shtetërore, ndërsa 46 % janë në pronësi private. Në vitin 2002 për nevoja si teknike dhe për ngrohje janë prerë 185 890 m³ dru⁵. Vetëm rreth 2000 ha janë ripyllëzuar.

Problemet kryesore të evidentuara në menaxhimin e pyjeve janë:⁸⁴

- menaxhimi i dobët i pyjeve;

⁸⁴ Edukimi dhe Ndërgjegjësimi Mjedisor, 2009

- prerjet ilegale dhe mosdefinimi qartë ligjorë për masat ndëshkuese ndaj prerësve ilegal të pyjeve;
- monitorimi dhe kontrollimi i dobët i pyjeve;
- mundësitë investive të kufizuara.

Zhvillimi i qëndrueshëm përmes krijimit të një mjedisi të shëndoshë

Nocioni “zhvillimi i qëndrueshëm”, i cili sipas definimit nënkupton kënaqjen e nevojave të brezit të sotëm duke mos rrezikuar mundësitë e brezave të ardhshëm që të kënaq nevojat e veta personale, përgjithësisht, prandaj edhe kur zbatohet në hapësirë, bashkon dy lloje qëllimesh:

- Përmbushja/kënaqja e nevojave ekonomike, shoqërore, kulturore, shëndetësore dhe politike të banorëve, dhe
- Kontrollimi ose kufizimi i ndikimit të aktiviteteve të njeriut në mjedisin jetësor, gjegjësisht, pengimi i degradimit dhe harxhimit të burimeve natyrore, ashtu që baza e lëndës së parë, energjisë dhe e ekologjisë është e domosdoshme për aktivitetet e njeriut të ruhen për kohë të gjatë.

Ky parim është bazuar/themeluar në Konferencën e KB për mjedisin jetësor dhe zhvillimin nëpërmjet “Agjendës 21”, me çka është vendosur qasja urbane gjithëpërfshirëse e aspektit të zhvillimit të qëndrueshëm.⁸⁵

Zhvillimi i qëndrueshëm do të thotë që me kalimin e kohës dobia apo mirëqenia për kokë banori së bashku me një grup treguesish të zhvillimit rriten. Në këtë aspekt zhvillimi mund të konsiderohet si një grup objektivash sociale që duhen arritur dhe jo si një objektiv i vetëm. Ai përfshin: rritjen e të ardhurës reale për frymë, përmirësimin e gjendjes shëndetësore dhe të ushqimit, përmirësimin e nivelit arsimor, shpërndarjen e drejtë të të ardhurave dhe burimeve, rritjen e shkallës së lirisë, etj.

Mesazhi i zhvillimit të qëndrueshëm është se me shumë vëmendje i duhet kushtuar variablave ambientale, se mirëqenia e përgjithshme sociale nuk mund të sigurohet vetëm nga mirëqenia materiale dhe çdo vend duhet parë nga këndvështrimi i përparimit të tij ekonomik, por edhe të atij ambiental. Komisioni Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin (Komisioni Brundtland) që e përdori i pari në vitin 1987 termin “zhvillim i qëndrueshëm” e përkufizon atë si “zhvillimin që realizon nevojat e të tashmes pa komprometuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të realizuar nevojat e tyre.

Zhvillimi i qëndrueshëm nënkupton që rritja dhe zhvillimi ekonomik të realizohen mbi mundësitë reale të natyrës për t’i mbështetur ato. Kështu,

⁸⁵ Raporti sektorial i mbrojtjes së mjedisit, 2004

edhe rritja ekonomike nuk mund dhe nuk duhet t'i tejkalojë mundësitë që i jep natyra. Në këtë rast do të thuhet se rritja dhe zhvillimi janë mbështetur mbi mundësitë që i lejon natyra dhe se mund të jenë të qëndrueshme në kohë. Në rast të kundërt do të thuhet se rritja apo zhvillimi nuk është i mbështetur, pra as i qëndrueshëm, dhe se shpejt do të fillojnë të shfaqen probleme që janë shumë të vështira për t'u zgjidhur qoftë nga pikëpamja ekonomike, qoftë nga ajo teknike.

E pambështetur ose paqëndrueshme do të konsiderohej rritja ekonomike që bazohet në përdorimin e burimeve të papërsëritshme deri në atë masë që sjell shpërrimin e shpejtë të tyre, ose që bazohet në shfrytëzimin e burimeve natyrore të përsëritshme në atë mënyrë që shkakton dëmtimin e cilësisë së tyre.

Përdorimi dhe shfrytëzimi i burimeve natyrore, të përtëritshme ose jo, me kalimin e kohës çon pa dyshim në pakësimin e tyre nga pikëpamja sasiore dhe në ndryshimin e cilësisë së tyre. Rritja ekonomike, veç të tjerash mund të arrihet edhe nëpërmjet zbatimit të politikave të mençura të mjedisit, menaxhimit të qëndrueshëm të mjedisit dhe përdorimit racional të burimeve natyrore.

Nga ky këndvështrim rritja mund të shikohet si:

- Potencial për futje vlerash në buxhetin nacional;
- Rritje e trashëgimisë së kapitalit nacional natyror, siç është oferta për ajër dhe ujë të shëndetshëm, toka të punueshme të shëndetshme, etj.;
- Rritje e pasurisë nacionale.

Mjedisi natyror dhe burimet e tij ofrojnë bazën natyrore të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të një vendi. Burimet natyrore si mineralet, lëndet djegëse, pyjet, fauna dhe flora, pasuritë hidrike etj. Së bashku me komponentë të tjerë të mjedisit si klima, etj. janë baza mbi të cilën ngrihen industritë, zhvillohet bujqësia, tregtia, etj. me qëllim që rritja ekonomike të jete e qëndrueshme.⁸⁶

Masat adekuate për mbrojtjen e mjedisit

Në mënyrë që problematika komplekse e mbrojtjes së mjedisit të realizohet në mënyrë të suksesshme, është e nevojshme të zbatohen masat përkatëse mbrojtëse, të cilat janë përmbledhur në një model, i cili prezantohet në vijim:⁸⁷

⁸⁶ Revistë, Mjedisi Sot, nr.131, 2011

⁸⁷ <http://www.mmph-ks.org/>

Konceptet për mbrojtjen e mjedisit

- Kompletimi i legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, plotësimin gradual të standardeve të BE, dhe zbatimi efikas i atij ekzistues;
- Përkrahja e programeve të riciklimit të ujërave të zeza dhe mbeturinave;
- Ndërtimi i institucioneve kompetente, të afta, të pajisura me kapacitete njerëzore dhe instrumente për zbatimin e politikave mjedisore, si institucionet vendimmarrëse, monitoruese, dhe kontrolluese / inspektive.
- Sigurimi i mjeteve të nevojshme financiare për një mbrojtje të mjedisit në harmoni me zhvillimin ekonomik / themelimi i Ekofondit;
- Krijimi dhe funksionimi i rrjetës së monitorimit të mjedisit në nivel vendi duke e shtrirë atë me prioritet në subjektet e mëdha ndotëse industriale në Kosovë;
- Rritja graduale e përqindjes së qasjes së popullatës në ujë të sigurt të pijes, në sistemin e kanalizimit, në sistemin e trajtimit të mbeturinave;
- Përdorimi dhe shfrytëzimi racional i resurseve natyrore: tokë, ujë, minerale, pyje etj.;
- Rritja e sipërfaqes dhe mbrojtja e zonave të trashëgimisë natyrore krahas rritjes së kapaciteteve për një menaxhim efikas të tyre në pajtim me parimet e Deklaratës së Rios;
- Zhvillimi i programeve afatgjata edukative, arsimore, kampanjave të ndërgjegjësimit si dhe përkrahja e projekteve shkencore të fokusuara në mjedis;
- Përkrahja e konceptit të sjelljes së teknologjive të pastra në Kosovë në fazën e startimit të industrive të reja dhe ristartimit të industrive ekzistuese;
- Aplikimi i konceptit të efikasitetit energjetik në të gjithë sektorët e shfrytëzimit të energjisë.

Masat përkatëse për zhvillim të qëndrueshëm

- Sforcimi i autoritetit, respektimi dhe jetësimi i ligjit për mbrojtjen e mjedisit;
- Shfrytëzimi racional i resurseve të natyrës si princip bazë për zhvillimin e qëndrueshëm;
- Sigurimi dhe mbështetja e kërkimeve dhe punimeve shkencore të veçanta në lëmin e mjedisit;

- Të sigurohet shfrytëzimi racional i natyrës e sidomos për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e biodiversitetit dhe vlerave natyrore funksionale;
- Përpjekjet për tejkalimin e punëve me nguti dhe jo të organizuara para marrjes së vendimeve për shfrytëzimin e hapësirës;
- Insistimi në vendimet komplekse rajonale, duke u nisur nga platforma e përbashkët e urbanizmit, interesave ekonomike të zhvillimit dhe të mbrojtjes së mjedisit jetësor;
- Përpilimi i një liste për mbrojtje në baza hapësinore (rurale, urbane dhe industriale).

Masat direkte për luftimin e ndotësve seriozë

- Të identifikohen ndotësit e mjedisit, të bëhet përcjellja sistematike dhe evidentimi i shpeshtë e i mjaftueshëm i dukurive të dëmshme;
- Sa më parë të definohen vlerat e lejuara të koncentrimave të ndotësve në ujë, ajër, tokë dhe ushqim, si dhe periudhat në përputhshmëri me direktivat e BE;
- Vërtetimi i masave tekniko-teknologjike në kuptimin e ndryshimit të teknologjisë së vjetër, me të reja dhe më efikase, rekonstruktimin e atyre ekzistuese;
- Tek komunikacioni duhet të parashihen masat për sjelljen në minimum të koncentrimit të dëmshëm të ndotësve të cilët emitohen në ajër;
- Tek zhvillimi i vendeve dhe qyteteve të shikohen mundësitë e ngrohjes së kontrolluar, lëshimi i ujërave fekalike, trajtim i gjithanshëm dhe pastrim;
- Vendosja sistematike dhe deponimi, riciklimi dhe kontrollimi i mbeturinave komunale dhe industriale, e posaçërisht materieve të rrezikshme;
- Inicimi i hulumtimeve për energji alternative, pasi që 97 % e prodhimit të energjisë bëhet nga eksploatimi sipërfaqësor i lignitit;
- Eksploatimi i resurseve natyrore e posaçërisht atyre mbitokësore, rreptësisht duhet të jenë të kushtëzuara me ri-kultivimin e tokës;
- Ndërprerja e procesit të zënies së pakontrolluar të tokës pjellore bujqësore e kualitetit më të lartë për qëllime ndërtimi dhe për hapësira banimi;
- Të sigurohet bashkëpunimi ndërkufitarë dhe rajonal në lëmin e mbrojtjes së mjedisit;

- Të themelohet shërbimi i inspektoratit në të gjitha nivelet për kontrollin e mjedisit jetësor dhe të kryhet verifikimi i planeve urbanistike nga aspekti i mbrojtjes së mjedisit jetësor;
- Për të gjitha projektet e investuara të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis dhe vlerësimi i aplikimit të kriterëve ekologjike.

Përfundim

Propozimet e bëra në këtë punim le të shërbejnë si një thirrje për mobilizim të përgjithshëm për të bërë diç më tepër për mjedisin. Të gjithë ne, anëtarët e shoqërisë duhet të përpiqemi me aq potencial sa kemi për të ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin e mjedisit natyror në vendin tonë. Për këtë nevojitet një përfshirje sa më e gjerë e aktorëve të këtij sektori: pushteti vendor dhe qendror, shoqatat e pyjeve, ekonomitë pyjore, shërbimet e ndryshme pyjore, OJQ-të, donatorë, etj. Sidoqoftë, rolin kryesor padysim se e mban njeriu, si pjesëtar i shoqërisë civile, duke qenë plotësisht i vetëdijshëm dhe i ndërgjegjshëm për rëndësinë enorme të mjedisit në cilësinë e jetës në të një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik.

Një motiv shtesë për të ndjekur këtë kurs që tani, le të jetë viti 2011, një vit ky i shpallur si viti Ndërkombëtar i Pyjeve nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara.

Literatura

1. Deklarata e Rios / Konventa për Diversitetin Biologjik, Rio de Zhaneiro, 1992 <http://www.unep.org/Documents/Multilingual/Default.asp/=78&articleid=1163>;
2. Edukimi dhe Ndërgjegjësimi Mjedisor, 2009;
3. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës;
4. Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, IPVQ Raport Sektorial – Mjedis, 2008;
5. Raport mbi gjendjen ambientale ne Kosove, Qeveria e Kosovës, MMPH, 2004;
6. Raport për mbrojtjen e mjedisit, MMPH, 2008;
7. Revistë, Mjedis Sot, nr.131, 2011;
8. Studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional, Prisht, 2003;
9. Ligji për mbrojtjen e mjedisit Nr. 03/ L – 025;
10. Ligji për mbrojtjen e natyrës nr. Nr. 2004;

KUD 005.2

**UTICAJ PROMJENE MENADŽMENTA U PREDUZEĆU NA
ZAPOSLENE**

MSc. Emin Neziraj
emin_neziraj@yahoo.com

Abstrakt

Promena menadžmenta u preduzeću povlači za sobom pritisak na zaposlene i u tom trenutku mogu nastati veliki problemi. Zbog toga promene moraju biti realne, izvodljive i merljive. Menadžeri moraju biti sigurni da se zaposleni slažu sa promenama, ili da ih bar razumeju, kako bi date promene bile sprovedene. Promjene u svetu su stalno prisutne, mnoge od njih stvaraju probleme, a problemi traže rešavanje. Problemi se ne mogu zauvek rešiti. Kada se resi jedan niz problema, nužno se pojavljuje nova grupa problema. Svrha menadžmenta se sastoji u rešavanju aktuelnih problema i spremnosti da se suočava sa problemima sutrašnjice. Po teoriji dr. Adizesa upravljanje promjenama je funkcionalan složeni proces koji u sebi uključuje dva osnovna procesa: Odlučivanje i sprovođenje odluka. Odlučivanje i sprovođenje odluka nisu kompatibilni procesi, odnosno različit je način na koji se ova dva procesa odvijaju.

Ključne reči: Menadžment, promene, preduzeće, stres

1. UVOD

Promjene su jedina stalna kategorija u prirodi i u zajednici ljudi. Od atmosferskih do političkih, od malih do upečatljivih i suštinskih, sastavni su deo svake organizacije i zahtevaju stalno prilagođavanje zaposlenih i resursa poslovanja. Prilagođavanje samo po sebi nije dovoljno da bi organizacija isla u željenom pravcu razvoja i uspeha, zato što svaka promena ne mora biti, i obično nije sama po sebi promjena na bolje. Potrebno je inicirati konstruktivne promjene i znati upravljati njima, ovo zahteva proaktivan pristup rada i razmišljanja koji podrazumeva predviđanje budućih događaja, stvaranja potrebne klime za promjene, i odgovarajuće okruženje koje može da omogućiti da se promjene odvijaju u željenom pravcu. Sve su to zahtevi koji se stavljaju pred menadžment organizacije. Međutim karakteristika modernog poslovanja

ukazuje na činjenicu da samo delovanje menadžmenta ma kako uspešan bio nije dovoljno u velikom broju uočenih promjena. Sposobnost menadžmenta neke organizacije ogleda se u mogućnosti prenosa pozitivne energije prema promjenama na sve strukture zaposlenih i podrške koju tom prilikom dobijaju.

Uspeh kroz ostvarivanje promjena sadrži ogromnu uloženu energiju zaposlenih fokusiranu na pronalaženje i ostvarivanje najboljeg načina da se na promjene utiče i da se od njih izvede što veća korist za organizaciju.

Ovaj zadatak nije ni malo lak. Poznata je činjenica da su ljudi u opštem smislu rezervisani prema velikom broju promjena a naročito prema onima čiji im je cilj nepoznat, nejasan ili najblaže rečeno sumnjiv opasan po egzistenciju. Otpor prema promjenama raste i sa godinama staza kao i sa rastom birokratizacije privatnom i porodičnom životu.

Upoznavanje sa promenama menadžmenta izaziva kod zaposlenih velike zdravstvene probleme od kojih se posebno izdvaja stres. Promene mogu biti uslovljene izmenom postupaka procesa proizvodnje, upoznavanjem sa novim tehnologijama, spajanjem ili razdvajanjem između organizacija, upoznavanjem sa novim proizvodima ili usled revizije strukture menadžmenta.

2. Organizacione promjene i otpor na promjene

U svakom razmatranju u vezi donošenja promena neophodno je razmisliti o efektima na organizaciju generalno i efektima na pojedinca na svim nivoima organizacije. Michael Green, konsultant na polju menadžment promena, u svom radu *Praktični pristup Susretu poslovnih potreba u budućnosti* (1982) naveo je osam specifičnih smetnji promenama u organizaciji, i to (Martinović M 2008:56) :

- a) Nepostojanje vizije i misije .Ako organizacija nema viziju, nema osećaj šta želi da stvori na svetu, onda nema nade da će inspirisati svoj menadžment ili zaposlene da prihvate zadate promene. Bez vizije ne postoji pravac. Bez misije, ne postoji svrha.
- b) Nedostatak društvenih vrednosti. „Kako želimo da delujemo, dosledno u svojoj misiji, i ujedno težimo ispunjenju naše vizije?“ Svaka organizacija mora da ima određeni set vodećih principa po kojima se proces rada obavlja svakodnevno. Oni mogu sadržati integritet, duh partnerstva, kontrolu troškova i inovacije. Kakvi da su, sigurno je, da bez njih, ne možete imati pravilno vođen biznis i pravićete različite poslove na različite načine, što će voditi ka nedoslednosti u poslovanja i konfliktu.

- c) Nedostatak uravnoteženosti. Cesto se dešava da cilj pojedinca ili grupe nije fokusiran na ukupni zajednički uspeh. Kada zaposleni ne rade za zajedničku viziju ili zajednički cilj efikasnost i efektivnost kompanije opada i izaziva velike troškove.
- d) Nedostatak prilagodljivosti. Ako postoji set značajnih vrednosti ili vodećih principa onda menadžeri i ostali zaposleni moraju da se ponašaju u saglasnosti sa njima. Oslanjanje na njih i verovanje u ispravnost odluka je potvrda da će oni moći da se pouzdaju u druge da rade isto. Podešavanje i prilagođavanje doprinosi pouzdanosti, trajnosti, povezanosti i celovitosti.
- e) Nedostatak menadžerske sposobnosti. Ako brzina promena brza tada se javlja potreba za novom generacijom menadžera koji moraju posedovati sposobnost da pridobiju i motivišu zaposlene za svoje strateške vizije.
- f) Najveća timska neefikasnost. Sve više organizacija kreće se ka manjoj hijerarhiji, većoj fleksibilnosti radnih zadataka, i porastu potrebe timskog rada. Kao uvek kod smene menadžmenta, rad top menadžera je od najvećeg praktičnog i simboličnog interesa.
- g) Individualna neefikasnost. Okolnosti kada pojedinac pokazuje neefektivnost u brzini postizanja organizacionog cilja: položaj problema, nedostatak sposobnosti, konflikti među osobljem, nedostatak samopouzdanja a član je menadžerskog tima onda on postaje prepreka procesa.
- h) Protivljenje osoblja promenama. Postoji mnogo dokumentacije na otpor prema promenama i načina da se to reši. Istraživanja su pokazala da jedanput utvrđene vizija i vrednosti koje su na pravom mestu, opredeljuju način prema izvršenju odupiranje promenama.

Ako jedna od tih smetnji stane na put promenama, onda zaposleni postaju stresni. Stres nastaje kada su ljudi sukobljeni sa promenama, u bilo kojoj oblasti života i kada osećaju da nemaju mogućnosti ni sposobnosti da izađu na kraj sa novonastalom situacijom. Upoznavanje sa promenama (Martinović M 2009:123). Problemi oko usaglašavanja i podešavanja prema promenama, treba da budu osmišljeni prilično pažljivo pre nego što je i jedan značajniji proces promena otpočeo. Jedan od najboljih načina za ostvarenje tih faktora je jednostavno izvršiti istraživanje u pogledu predloženih promena. Menadžeri su ponekad i uplašeni u vezi sa ovim pristupom jer strepe od odgovora anketiranih.. Postoji alternativa koja zaposlenim dozvoljava da izlože svoje mišljenje slobodno, pismeno ili na sastanku uz garantovanu diskreciju.

3. Promjene u menadžmentu kao uzrok konflikta

Promena menadžmenta u organizaciji povlači za sobom pritisak na zaposlene i u tom trenutku mogu nastati veliki problemi. Zbog toga promene moraju biti realne, izvodljive i merljive. Menadžeri moraju biti sigurni da se zaposleni slažu sa promenama, ili da ih bar razumeju, kako bi date promene bile sprovedene. Komuniciranja lice u lice trebalo bi da se koristi za obrađivanje osetljivih tema uključenih u organizacione promene menadžmenta. E-mail i pisana komunikacija su veoma slab oblik prijema i razumevanja promena.

Za organizacione promene koje iziskuju nove akcije, plan i sprovođenje za grupu ili tim ljudi, radni sastanci bi trebali da se koriste za postizanje razumevanja, angažovanosti, planiranja, merljivih ciljeva, akcija i obaveza. Ovi principi bi trebali da budu primenjeni za velike promene koje mogu zahtevati suviše, zatvorene i integracione elemente naučne organizacije. Vrhunski menadžeri moraju imati svoj stav i ne treba da se skrivaju iza menadžera srednjeg nivoa i promenljivih oblika pisane komunikacije. Menadžeri koji se ne konsultuju i ne uključuju svoje zaposlene u vođenju osuđeni su na neuspeh dok menadžeri koji drže do humanosti i respekta, mogu očekivati da će im biti uzvraćeno (Thompson A.A, Strickland A.J 2005:56).

Principi organizacionih promena menadžmenta su:

1. Postojanje povezanosti i odobravanje unutar sistema,
2. Promena mora biti jasna za svakoga zaposlenog u organizaciji,
3. Promena mora biti razumljiva, sa stanovišta ciljeva,
4. Razvoj ka višim ciljevima trebalo bi planirati u merljivim fazama,
5. Postojanje odgovarajućih komunikacija, primenljivost i interpretacije objašnjenja da će sprovedene promene biti uspešne.

Promjene u svetu su stalno prisutne, mnoge od njih stvaraju probleme, a problemi traže rešavanje. Problemi se ne mogu zauvek rešiti. Kada se resi jedan niz problema, nužno se pojavljuje nova grupa problema. Svrha menadžmenta se sastoji u rešavanju aktuelnih problema i spremnosti da se suočava sa problemima sutrašnjice. Po teoriji dr. Adizesa upravljanje promjenama je funkcionalan složeni proces koji u sebi uključuje dva osnovna procesa (C.L.Karrass 1997:111): Odlučivanje i sprovođenje odluka. Odlučivanje i sprovođenje odluka nisu kompatibilni procesi, odnosno različit je način na koji se ova dva procesa odvijaju.

Kvalitet menadžmenta je funkcija kvaliteta odluke i efikasnosti sprovođenja te odluke. Da bi odluka bila zaista kvalitetna mora biti doneta nakon obimnih konsultacija, argumenata **za** i **protiv**, uz legitimno i kolegijalno neslaganje i otvoren razgovor. Sprovođenje demokratski

donete odluke zahteva diktat i obavezu svih koji su učestvovali u donošenju odluke da je odlučno i brzo sprovedu.

Demokratičnost u odlučivanju i diktaturu u sprovođenju odluka prof. Adizes naziva- "demokratura". Metodologija funkcionalnog menadžmenta podrazumeva dobro upravljanje procesima, i usredsređenost na sredstva postizanja ciljeva, a ne samo na ciljeve i postizanje rezultata koji su u stvari samo proizvod dobrog vođenja. Mala greška u usmeravanju procesa može da oslabi željene rezultate.

Funkcionalni menadžment podrazumeva organski pristup. To je sposobnost organizacije u kojoj nema nezamenljivih, da se na tzv organski način prilagođava nastalim promjenama i da poseduje sposobnost adaptacije na izazove tržišta, okruženja i unutrašnjih konflikata. Dobro donete odluke, čine organizaciju efektivnom i efikasnom u kratkoročnom i dugoročnom periodu. One organizaciju čine funkcionalnom, sistematizovanom, proaktivnom i daju joj organsku svest. Ove četiri osobine organizacije u suštini predstavljaju osnovne uloge odlučivanja, neophodne "vitamine" za postizanje kvalitetnih odluka.

4. Pristup menadžera pri vladanju krisom nastalom promjenama

Mnogi menadžeri prolaze kroz krizne situacije, koje mogu nastati usled određene situacije, a neke mogu biti udružene sa lošim vremenom menadžmenta. Menadžeri vladaju krizom u svojim životima na različite načine uz sledeća pravila (C.M. Wheeler 2007:23):

1. Stanite i razmislite. Udahnite duboko nekoliko puta i rezultat je otklanjanje trenutne fizičke reakcije koja proizilazi iz krize.
2. Sakupljajte i beležite činjenice. Procenite njihove posledice i ako imaju bilo koju značajnu prednost nacrtajte ih.
 1. Označite vašu nepristrasnost. Šta je najvažnije kod nepristrasnosti?
 2. Planirajte unapred. Označite šta je potrebno da se uradi i kojim redosledom.
 3. Stavite vaš plan u funkciju. Uverite se da se to događa i ovo je najteži deo.
 4. Razgovarajte sa pojedincima koji imaju obostrani interes. Ko je još uključen i/ili treba da zna?
 5. Procenite koliko dobro vladate krizom. Promenite svoj plan za nepredviđen slučaj u budućnosti ako je neophodno.

5. ZAKLJUČNA RAZMATRANJA

Zašto su neki menadžeri uvek „u cajtnotu“ pred sastanak, donošenje odluka ili odlazak na posao? Oni imaju jednostavno nedostatak organizacije i planiranja njihovog efektivnog vremena . Pravila koja utiču na poboljšanje vremena su:

1. Odvojiti vreme za planiranje i organizovanje. Odvojeno vreme za razmišljanje i planiranje unapred je dobro utrošeno vreme. Uradite sve što možete danas i ne ostavljajte ništa po strani kako bi to uradili sutra.
2. Definisane ciljeva. Ciljevi određuju pravac delovanja pojedinaca i treba da budu specifični, realni i izvodljivi. Kontrolom utvrdite da li ste ostvarili neke od definisanih ciljeva.
3. Prioritet. Koristite 80-20 pravilo koje je prvi koristio italijanski ekonomista Vilfredo Pareto koji je zabeležio da 80% nagrada dolazi od 20% od zalaganja. Prioritet je da vaše vreme koncentrišete na tih 20% koji daju najbolji rezultat.
4. Napravite listu poslova, koja sadrži poslednji posao koji je urađen prethodnog dana ili prvi posao za sledeći dan.
5. Budite fleksibilni. Rezervišite vreme za prekide i odvracanja. Preko prirode posla, može biti jedino izvodljivo planiranje unapred do 50% ili manje, uzimajući u obzir potencijalna uznemiravanja od strane kolega, telefona i neplaniranih „vanrednih stanja“.
6. Analizirajte vaše biološko glavno vreme. Razmislite o vremenu u toku dana kada su najbolji uslovi za rad. Neki od zaposlenih najbolje rezultate na poslu postižu u jutarnjim časovima dok drugi to postižu u podnevnim i noćnim časovima. Znajući najbolje vreme kada postižete najbolje rezultate u toku dana možete da planirate budući rad.
7. Uradite pravu stvar ispravno: Piter Drucker, dobro poznati guru menadžmenta, je govorio „raditi pravu stvar je mnogo važnije nego raditi stvari ispravno“. Raditi pravu stvar je efikasnost; raditi stvari ispravno je ekonomičnost. Fokusirajte se prvo na efikasnost, a zatim se koncentrišite na ekonomičnost.
8. Eliminirajte brzinu. Hitni zadaci imaju kratkoročne posledice dok zadaci kod dugoročnih ciljeva imaju važan uticaj na poslovanje. Realno je da se moraju smanjiti zadaci klasifikovani kao hitni, da se omogući veći prioritet dugoročnim, da bi poslovali uspešno.
9. Sprovodite umeće „inteligentnog nemara“. Učinite napor da bi se eliminisali trivijalni zadaci ili zadaci koji nemaju dugotrajne posledice. Može biti moguće da se delegira neki od tih

najtrivijalnijih zadataka i rad na tim zadacima koji zahteva tvoju specijalnu pažnju.

10. Izbegavajte perfekcionizam. Pojedinci koji sebi postavljaju standarde izvođenja bazirane na perfekciji, kao što je, na primer, usmeriti preteranu pažnju na detalje, neizbežno će patiti od stresa kada ti standardi ne budu ispunjeni.
11. Izborite se za odlaganje. Jedna isprobana tehnika je „Swiss sir“ metoda. Kada izbegavte nešto, izdelite ga na manje zadatke ili vremenske intervale i tako radite na većem zadatku . Radeći po malo u toku vremena, najzad ćete doći do tačke gde vi želite da završite određeni zadatak.
12. Naučite da kažete „Ne“. Mnogi menadžeri pate od prekomernog rada što je izazvano nemogućnošću da se kaže „Ne“ za naredne zahteve u njihovom vremenu. Naučiti reći „Ne“ je trivijalno, manje važni zahtevi, udruženi su sa smanjenjem stresa usled preopterećenja.
13. Nagradite sebe. Definišite ciljeva koji su merljivi i ostvarivi. Kada postavljeni ciljevi budu ostvareni, dopustite sebi obećanu nagradu.

6. LITERATURA

1. Martinović M, Menadžment, VPTŠ Užice, 2009.
2. Martinović M, Organizacija preduzeća, VPTŠ Užice, 2008.
3. Thompson A.A, Strickland A.J, Strategic management, Irwin/Mc Graw Hill, Boston 2005
4. C.L.Karrass, „In Business As In Life- You Don t Get What You Deserve, You Get What You Negotiate“, Stanford Street Press, Los Angeles California 90404, 1996.
5. Bulat V., Industrijski menadžment, ICIM, Kruševac, 1997.
6. C.M. Wheeler: 10 simple solution to stress, New Harbinger Publications, Inc., Oakland USA, 2007.

=====

KUD 368.1(96.51)

INDUSTRIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE – INSTITUCIONET E SIGURIMIT SI PJESE E SAJ

Dr. Fatos Ukaj
fatos_ukaj@yahoo.com

Abstrakt

Ndodhë që shpesh të kemi mëdyshje rreth asaj se si të emërtohet pjesa e ekonomisë që merret me kryerjen e veprimtarisë në kuadër të operacioneve me financat por aty na paraqitet ndarja e këtyre operacioneve në ato: Bankare dhe Jobankare. Në pjesën e Industrisë së Shërbimeve Financiare që emërtohet si Jobankare hynë edhe Institucionet e sigurimit. Sigurimi si emërtim e ka rendësinë e vetë si sinonim i mbrojtjes dhe besimit në garancën e dikujt, po ashtu e ka rendësinë ekonomike dhe juridike. Në Kosovë çështja e Sigurimeve është e trajtuar në një periudhë kohore me se 100 vjeçare duke kaluar neper periudha të ndryshme të implementimit të sigurimit qoftë të pasurisë po ashtu edhe të jetës. Periudha e cila mund të trajtohet si kohe e instalimit të një sistemi ku institucionet e sigurimit patën shtrirje dhe forcim të veprimtarisë së vetë, është periudha që nga viti 2000 e këndej. Nevoja për individin dhe subjektet juridike të kenë mbrojtje nëpërmes sigurimit e mundësuan që institucionet e sigurimit të shtohen në numër dhe në fuqinë e vetë financiare për të ofruar mundësi për mbulimin e të papriturave. Sigurimi si veprimtari edhe në Kosovë përveç rendësisë së vetë në aspektin nacional, po e fiton rendësinë edhe në nivel internacional.

Fjalët kuqe: Industria e Shërbimeve financiare, Sigurimet, Siguria, I siguruari.

Jel klasifikimi: G2 - Financial Institutions and Services, G22 - Insurance; Insurance Companies

Abstract

It happens often that we doubt the issue of how to name a part of economy that deals with activities in specific field of finance, but there we have the separation of these operations in two groups, which are: Banking and Nonbanking. In the field of Financial Industry and Financial Services that are named as Nonbanking, Institutions of Insurance take place also. Insurance as a term, has its own importance like a synonym of protection

and confidence on guaranty given by someone you trust, also it has its own economic and legal importance. In Kosovo, Insurance issue is treated in a time period of more than 100 years, passing through different periods of implementations, those of property insurance and life also. The period which can be treated as a time of installation of a system where the insurance institutions had a range and strengthen of their own activity, is the period from the year 2000 and onwards. The need of individual and legal subjects to have protection via insurance enabled the insurance intuitions to increase in number and their own financial power in order to be able to offer the chance of covering the contingencies. Insurance as an activity, in Kosovo also except of its importance in national terms, it is gaining importance in international level.

Key words: Industry of Financial Services, Insurances, Security, Insured,

JEL classification: G2 - Financial Institutions and Services, G22 - Insurance; Insurance Companies

1. HYRJE

Ne historinë e re të Kosovës është evidente se ka një qasje serioze në ndërtimin e një Industrie të Shërbimeve Financiare. Duke u nis nga nevoja e shkëmbimit në nivel vendi dhe ati ndërkombëtar ju kushtua rendësi formimit të një sistemi bankar efikas dhe optimal për nevojat e popullsisë dhe ekonomisë se vendit. Vëmendja me kohe u orientua edhe në kuadër të nevojës se paraqitur për shërbimet e sigurimit të pasurisë dhe jetës. Implementimi i ligjeve mbi sigurimet e detyrueshme e mundësuan funksionalizimin e shoqërive të sigurimit të formuara si etnitete juridike Kosovare , me kapital vendor dhe ndërkombëtar. Përvoja e periudhës para vitit 1999, dhe disponimi me resurse materiale dhe njerëzore të specializuara për punët në Sigurime, e mundësuan ngritjen e shpejt të një numri shoqërish për sigurime, që e mbuluan nevojën e paraqitur për sigurime në nivel vendi. Deri në vitin 199 në Kosove ka operua Bashkësia e sigurimeve të personave dhe pasurisë “Kosova”, si dhe Filialet e Bashkësive të Sigurimit nga pjesët tjera të ish Jugosllavisë. Janë 14 shoqëri të sigurimit të licencuar nga na e Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për operime në Kosove në lëmit e ndryshëm të sigurimeve[BQK01/2011]. Dështimi i pjesshëm në arritjen e ndërkombëtarizimit të Industrisë Kosovare të Sigurimeve e lanë popullsinë dhe ndërmarrjet Kosovare jashtë mundësisë që me policat e Shoqërive Kosovare të Sigurimeve të mund të ishin të mbuluar edhe jashtë shtetit, pra pranimi i policave të Shoqërive të Sigurimit nga Kosova në vendet Evropës e me gjere. Duhet përmendur si përparësi për të siguruarit në sistemin TPL

marrëveshja e arritur me Maqedoni dhe Shqipërinë për mbulimin e sigurimit me polica Kosovare në këto vende.

2. ROLI DHE RËNDËSIA E SIGURIMEVE

Njeriu vazhdimisht është përball me mundësin e pësimit të humbjes apo pësimit të ndonjë të papriture që ka si rrjedhojë dëmtimin, apo humbjen e jetës, shëndetit apo pasurisë. Për këtë arsye edhe janë organizua mënyra të ndryshme të sigurimit, që janë përsosur pasi që edhe gjithnjë në këtë shoqëri dinamike paraqiten rreziqe të reja. Përveç se njerëzit dhe ndërmarrjet marrin hapa në sigurimin e vete ata gjithashtu e shohin si të nevojshme që të organizojnë mbrojtje nga aktiviteti vete që munde të rezultojë me humbje për jetën dhe pasurin e personave tjerë. Por duhet cekur se në shumicën e rasteve nuk ekziston mundësia dhe fuqia financiare që vete të organizohet mbrojtja nga rreziqet.

Sigurimet kane një histori të veten të zhvillimit si aktivitet në kuadrin e shërbimeve financiare, apo si biznes është i lidhur me individët dhe grupet e individëve por edhe me ndërmarrje dhe grupe ndërmarrjesh qofte ato prodhuese apo shërbyese. Që në Historinë e lashtë të Kinës dhe Babilonisë, duke vazhdua në Greqinë antike e Romen antike, me pastaj në Mesjete ku kemi themelet e një aktiviteti të veçantë në lëmin e sigurimeve të mallrave dhe pasurisë. Në vijim dallojmë themelimin e institucioneve për sigurime si Angli, “Loyds” që nga viti 1688 si grupim i nënshkruesve(undewriter) e gjer në vitin 1771 kur Loyds u institucionalizua si shoqëri e sigurimeve, në Gjermani Shoqata e zjarrfikësve “Feuer Casse” në vitin 1591, Në SHBA themelohet grupi ”Philadelphia Contributionship for the Insurance of Houses from loss by Fire” në vitin 1752 [I.Hoti 2008; K.Klasić& I.Andrijaniq 2009], e kështu me radhe deri në kohërat moderne kur shtrirja dhe format e shoqërive të sigurimit morën forma dhe mbulojnë rreziqe nga me të ndryshmit , duke u përshtat zhvillimeve shoqërore, ekonomike dhe teknologjike.

Edhe në Kosove ndeshemi me zhvillimin e biznesit të sigurimeve sidomos pas vitit 1999, dhe dallojmë shoqëritë e sigurimit të cilat mund të jene të specializuara për lloje të veçanta të aktiviteteve në sigurime, apo ato universale që në fakt merren me aktivitete në me shume lloje të sigurimeve. Nevoja e vendit për të pas zhvillim ekonomik, si dhe lidhjet me ekonominë ndërkombëtare e nxiten edhe zhvillimin e biznesit të sigurimeve, që në fakt ka dy funksione që i ndihmon shtetit dhe ekonomisë, njëra është funksioni i saj në zvogëlimin e pasigurisë për individ dhe ndërmarrje dhe në anën tjetër funksioni i grumbullimit të kapitalit. Në industrinë e sigurimeve të Kosovës janë tri lloje të aktiviteteve në sigurime, apo sigurimet ndahen në tri lloje, dhe atë në: sigurime të përgjithshme, sigurime të jetës, dhe risigurime.

=====

Rëndësia e një mundësie për tu sigurua është inkurajuese sidomos për bizneset dhe Investitorët e jashtëm që dëshirojnë të zhvillojnë biznes në Kosovë. Shoqëritë e sigurimit janë të obliguara që të menaxhoj me nikoqirllëk me burimet e veta dhe me investimet ashtu që në çdo rast të jete në gjendje ti plotësoj obligimet e arritura ndaj të siguruarve. E këtë do të duhej ta arrijnë duke e zbatua politiken e menaxhimit të rregullt të likuiditetit. Mbikëqyrja e shoqërive të sigurimit në Kosovë behet nga Banka qendrore e Kosovës(BQK).

3. ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

Në Kosovë një shoqëri e sigurimit mundet dhe duhet të organizohet në forme të shoqërisë aksionare. Aksionet janë pjese e kryegjësë themelore, dhe janë të bartshim, ashtu që të mundë të shiten dhe të blihen. Shoqëritë e sigurimit në Kosovë mundë të themelojnë personat vendor fizik dhe juridik, por edhe ata të huaj. Në këtë vazhde është e përcaktuar edhe shuma e kapitalit themelues për lloje të caktuara të sigurimit, që është e rregulluar me ligj dhe e njëjta mund të ndryshohet vetëm me vendimet e BQK, si mbikëqyrëse e institucioneve financiare , pra edhe të shoqërive të sigurimit. Përpos kushteve të përcaktuara nga BQK, shoqëritë duhet të përmbushin edhe kushtet e përcaktuara me ligjin mbi shoqëritë tregtare. Pra të regjistrohen si biznese vendore, pa marre parasysh prejardhjen e kapitalit, a është vendor apo nga jashtë vendit. Në baze të ligjit mbi shoqëritë tregtare edhe organizohet dhe udhëhiqet si subjekt ekonomik. Është e përcaktuar se një shoqëri e sigurimit nga fusha e sigurimit të përgjithshëm nuk duhet të ofroj shërbime nga siguri i jetës, dhe anasjelltas. Në baze të autorizimeve, BQK e rregullon me rregullore dhe udhëzime licencimin dhe i mbikëqyr shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit. Në fushën e sigurimit lejohen dhe veprojnë filialet e shoqërive të sigurimit, agjencitë, agjentet, nënagjentet dhe komisionarët e sigurimeve. Është e përcaktuar nga BQK edhe shuma e mjeteve që duhet të mbajnë brenda Kosovës, për të mbuluar kërkesat për zhdëmtim, e që duhet të jene të mjaftueshme. Këtë duke e dite se një prej funksioneve të sigurimit është grumbullimi i mjeteve financiare të cilat investohen dhe sjellin interes. Mjetet nga siguri kane funksion financiar-akumulues dhe shoqëror-social, ne shoqëri [Xh.Bakraqi 2007]. Duhet nënvizuar se BQK i cakton limitet që kane të bëjnë me shumën e premive që shoqëria e sigurimit mund të shkruaj. Premia si çmim i sigurimit, duhet të jetë proporcionale ndaj rrezikut te siguruar ne kohën e caktuar, pra që të jetë adekuat ndaj periudhës kohore në të cilën mbulohet rreziku.[P.Šuljević 2005] Ndërsa për shumën e humbjeve të parapara maksimale,shoqëritë e sigurimit duhen marre masa për risigurimin e atyre

rasteve, dhe atë vetëm me kompanitë e pranueshme për BQK-ne. Për një numër të rasteve kur shoqëritë e sigurimit dëshirojnë të hyjnë në transaksione financiare siç janë produktet derivate në sigurime (opsionet, këmbimet, variacionet, etj) duhet të marrin miratimin paraprak nga BQK. Shoqëritë e sigurimeve që janë bashkësi e të siguruarve e kanë synim realizimin e fitimit, por në raste kur realizohet fitimi, asnjë pjese e tij nuk mund të shpërndahej qoftë për aksionaret, qoftë për stimulimin e të siguruarve, pa miratimin e BQK. Kontrolli i shoqërive të sigurimit nga ana e BQK bëhet edhe nëpërmes mbikëqyrjes se vazhdueshme ,që mund të rezultojnë me ndëshkime dhe anulime të licencës, që mund të bëhet edhe pa njoftime paraprake të vete shoqërisë se sigurimeve apo të ndërmjetësuesve të sigurimit konkret. Pra masat që nga vërejtjet me shkrim, ndëshkimet dhe deri tek tërheqja e licencës, janë të plotësuar edhe me masat ndaj menaxhmentit dhe vete aksionarëve. Ekziston mundësia dhe kjo është implementu në praktik, ku sipas rregullores shoqërisë se caktuar të sigurimeve ju ka marre licenca, është fut në procesin e likuidimit dhe është shitur, me këtë është ndërrua pronësia. E gjithë kjo bëhet me arsyetim të mbajtjes se disiplinës në funksionimin e tregut të sigurimeve, mos të mbizotëroj konkurrenca jolojale , por edhe të mbrohen të siguruarit nga hazardi moral i shoqërive të sigurimit. Shoqëritë e sigurimit e kanë formuar për interesa të përbashkëta Shoqatën e sigurimeve të Kosovës(IAK), e cila është në bashkëpunim të ngushtë me BQK si institucion që e mbikëqyr dhe e kontrollon edhe industrinë e sigurimeve.

Tabela 1. të dhënat për aktivitetet e shoqërive të sigurimit për muajin Nëntor 2010

Nr	Emërtimi	PPT	Policat Kufitare	Tjera (jo PPT)	Gjithsejtë
1	Shuma e premive të pranuar	37.6	9.8	18.7	66.1
2	Numri i Policave të Shitura(ne 000)	238	175	83	496
3	Shuma e dëmeve të paguara	17.3	1.0	5.3	23.7

Burimi: BQK 01/2011

Mbetet edhe me tej produkti kryesor që e kontraktajnë e shoqëritë e sigurimit në Kosovë , Sigurimi i përgjegjësisë ndaj palës së Tretë (PPT), me se 61% e tërë premive të arkëtuara janë nga shitja e policave PPT. Në të njëjtën periudhë, muaji qershor 2010 shuma e dëmeve të paguara arriti vlerën e me se 13 milion eurosh, dhe në këtë shumë demet e paguar për mbajtësit e policës së PPT ishte me se 74% e të gjitha dëmeve të paguara[BQK 2010].

4. OPERACIONET E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT NË TREGJET E KAPITALEVE

Ne aktivitetet e tyre shoqëritë e sigurimit arkëtojnë premitë në momentin e lidhjes së kontratës, dhe si rrjedhojë është fakt se behet grumbullim i vlerave monetare të cilat ka mundësi që të investohen. Në anën tjetër shoqëritë e sigurimit e kanë edhe një alternativ tjetër për të instrumentalizua rrezikun, duke e bërë sigurimin e rrezikut me shëndrrimin e rrezikut në të sigurt financiare (financial security).

Kur behet fjale për procesin e instrumentalizimit të rrezikut e gjitha fillon me lëshimin e obligacioneve të katastrofës, dhe opsioneve të klimës, si instrumente financiare [I. Hoti 2008].

Me këtë rast kemi të bëjmë me lidhjen e një kontrate ku palët pajtohen se do të behet: investimi, niveli i normës së interesit, afatin e kontratës, e cila parasheh kthimin e investimeve në të ardhmen. Me këtë rast shoqëria e sigurimit emeton “obligacionet e katastrofës” dhe huamarrin duke ju zotuar blerësve të obligacioneve se pas maturimit do të fitojnë për kapitalin e huazuar një interes me përqindje fikse. Mirëpo çështja është se këtë interes ata do ta fitojnë vetëm nëse nuk ndodhë katastrofë, me këtë rast pra ata do të marrin shumë themelore dhe interesin. E çka nëse ndodhë katastrofa, shtrohet pyetja. Pra huadhënësi në këtë rast do të zbritet humbja e rezultuar nga katastrofa (për shoqërinë e sigurimit) nga shuma e investuar në obligacione të katastrofës, si dhe nga interesi i grumbulluar nga investimi në obligacione. Duhet potencuar këtu se shoqëritë e sigurimit në këtë rast ofrojnë interes të lartë, por edhe ky investim paraqitet me rrezik të lartë, në tregjet e kapitalit, dhe ju tërhiqet vërejtja për këtë investitorëve potencial.

Tek instrumenti tjetër financiar i përdorur nga shoqëritë e sigurimit e që është “Opsioni i Klimës” që në realitet është instrument që lidhet për demet e pësura nga goditjet klimatike. Këto dame mund të jenë si pasojë e thatësisë, reshjeve, ngricave, breshëri, etj. Ai i cili investon në këtë instrument e përfiton kompensimin nëse ndodhin demet e shkaktuar nga ndryshimet ekstreme në klimën e vendit, të cilat rezultojnë me humbje, zakonisht katastrofike.

Edhe pse e cekem se këto instrumente në fakt kanë rrezik të lartë, për to ka interesim të atyre që dëshirojnë të bëjnë diversifikimin e kapitalit të vetë, por edhe shoqëritë e sigurimit në këtë mënyrë e rrisin aftësinë e vetë, apo kapacitetin sigurues [I. Hoti 2008].

Mënyrë tjetër e angazhimit të mjeteve të mbledhura nga të siguruarit, që përdoret nga shoqëritë e sigurimit është investimi i këtyre mjeteve në instrumente të ndryshme në tregjet financiare, normalisht se edhe këtu i kushtohet kujdes, shpërndarjes apo diversifikimit të këtyre investimeve në formë të ndryshme që nga investimet në letra me vlerë, blerjen e aksioneve të korporatave të ndryshme, pjesëmarrja në ndërtimtari, investimi në banka, depozitimi i mjeteve tek institucionet bankare, etj. Këto mjete të fituara nga këto investime, për shoqëritë e sigurimit paraqet burim

për mbulimin e humbjeve të siguruara të përjetuara, pjese e këtij fitimi mund të ndahet edhe për dhënien e lirimeve në forme bonusi për të siguruarit e vete, etj. Këtu duhet bere të qarte se premitë e pranuar në vlera monetare ka mundësi që e humbin vlerën e vete, apo fuqinë blerëse nga shume faktorë , e një nder ta numërohet inflacioni. Shoqëria e sigurimit pra i kushton kujdes nevojës se ruajtjes se vlerës se mjeteve të grumbulluara por edhe ka detyre që ta rrisë atë vlerë me menaxhim maksimal të rrezikut gjate investimeve.

6. PËRFUNDIM

Praktikat e sigurimit në bote por edhe në Kosove hasen gjithnjë e me shpesh tek individët dhe ndërmarrjet apo institucionet. Format e organizimit janë nga me të ndryshmet dhe kane një trend të shtrirjes në të gjitha aktivitetet private dhe profesionale të individëve dhe ndërmarrjeve, pra me shtimin e produkteve të sigurimit. Organizimi i industrisë se sigurimit në Kosove ka pas në periudhën e deritanishme një ekspansion dhe i gjithë organizimi behet në baza të funksionimit të tregut dhe konkurrencës lojale të shoqërive të sigurimit të licencuara. BQK si institucion mbikëqyrës i shoqërive të sigurimit e bene kontrollin dhe rregullimin e kësaj veprimtarie me anën rregulloreve dhe udhëzimeve të veta, e krejt me qellim të mbrojtjes se mbajtësve të policave të sigurimit. Shoqëritë e sigurimit e kane formuar për interesa të përbashkëta Shoqatën e sigurimeve të Kosovës(IAK), me qellim të mbrojtjes se pjesëmarrësve në tregun e sigurimeve, avancimin e veprimtarisë se shoqërive të sigurimit, bashkëpunimin në mese të shoqërive të sigurimit vendore me ato ndërkombëtare, etj. Duhet dalluar se edhe përkundër avancimeve të bëra mbesin dallimet apo ngecjet në lëmin e sigurimeve në Kosove që janë specifike si rezultat i trashëgimisë historike, nga tranzicioni i zgjatur i ekonomisë vendore, çështja pronësore është një prej frenuesve të zhvillimit të mëtejme, ngritja e kuadrit profesional është gjithashtu një sfidë në vete. Kycja e shoqërive të sigurimit në hapësirën ndërkombëtare me produktet e veta është një sfidë e cila po zgjate shume gjate, dhe kjo e bene që edhe siguresit të mos kenë besim në aftësitë e shoqërive vendore, kur behet fjale për punët me karakter ndërkombëtar. Anëtarësimi në shoqatat e siguresve dhe risiguresve të Evropës dhe me gjere duhet të jete një prioritet për BQK, IAK, dhe Shoqëritë e sigurimit, sidomos pas njohjes se pavarësisë nga shume vende në bote.

Ndryshimet që ndodhin në lëmin e sigurimeve duhet të përcillen edhe me adaptimin e ndryshimeve në ligj mbi sigurimin, rregulloret dhe udhëzimet e BQK, me shfrytëzimin e konsulences profesionale, ose mundësisht me asistencën e organizatave ndërkombëtare.

7. LITERATURA

- [1] Ilir Hoti, “Industria e sigurimeve dhe Menaxhimi i Rrezikut”, Instituti i Inxhinierisë Financiare për Banke&Sigurime, Tirane, 2008.
- [2] Ksenija Klasiq dhe Ivo Andrijaniq, Bazat e Sigurimit, Universiteti Victory dhe Instituti i H.Sh . Victory, Prishtine ,2009.
- [3] Xhevat Bakraçi”Menaxhmenti i rrezikut dhe Sigurimet, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, Prishtine, 2007.
- [2] Predrag Šulejić, Pravo Osiguranja, Centar za Publikacije Pravnog Fakulteta u Beogradu, Beograd ,2005.
- [4]. Fatos Ukaj ” Support of Small - Medium Size Enterprises (SME) - Opportunity for Kosovo to Overcome Economic Crisis”, First on-line International conference “World’s Economies In and After Crisis: Challenges, Threats and Opportunities”-WECTO, ASERS Publishing, <http://www.asers.eu/asers-publishing>
- [5] Banka Qendrore e Kosovës. <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2011/BMS%20112.pdf>
- [6] Banka Qendrore e Kosovës , Raporti i stabilitetit Financiar 1, <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2010/Raporti%20i%20Stabilitetit%20Financiar%20Nr.%201.pdf>
- [7] Enti i Statistikës së Kosovës <http://www.ks-gov.net/esk/>
- [8] Departamenti i Thesarit, MEF: <http://www.mef-rks.org/sq/download/2162-buletini-makroekonomik>

KUD 338.486(496.51)
**TURIZMI GJENDJA DHE PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT NE
REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Dr. Fetah Reçica
fetahreqica@hotmail.com

Abstrakt

Turizmi dhe potencialet e turistike te Republikës se Kosovës janë te rëndësishme për tu marr për bazë sepse gjendja e tanishme nuk le për tu dëshiruar. Ndërsa perspektiva do te jetë e suksesshme dhe profitabile për ekonominë vendore. Turizmi është njëra prej veprimtarive me komplekse në shoqërinë e sotme moderne. Ne vendet e zhvilluara ka marrë formën e një industrie të plotë me të cilën ndërveprojnë shumë veprimtari si ; ekonomia, politika, kultura dhe të gjitha veprimtaritë dhe aktivitete njerëzore. Ne vendin ton është i përciellur me fatin e ekonomisë se vendit. Zhvillimi i kësaj veprimtarie do te angazhoj fuqi punëtore dhe do te shkoj ne favor te zhvillimit dhe sigurimit te mirëqenies shoqërore te popullsisë vendore dhe ne ngritjen e standardit jetësor.

Fjalët çelës; Turizmi, Potencialet turistike, perspektiva e zhvillimit, Mjedis i përshtatshëm, Ndërmarrjet hoteliere, Baza materiale.

Hyrje

Turizmi ne kohet e fundit është zhvilluar në rrethana mjaftë të vështira në aspekte të ndryshme si politike, ekonomike, shoqërore. Ne vitet e fundit vështërsite dhe kufizimet themelore nuk kanë qen vetëm në nivel kombëtar, por edhe me gjere në nivel regjional. Shkaktar për këtë ishin rrethanat e krijuara nga luftërat në ish Republikën Federative të Jugosllavisë. Zhvillimi i turizmit është në lidhshmëri me zhvillimin ekonomik te vendit. Kosova me potencialet e sajë mund të jetë vendi me zhvillim ekonomik ne të cilin turizmi do të jete njeri prej vendeve ku premtojnë investimet në këtë sektor. Gjithherë duke marrë për bazë vendet e regjionit si Maqedoninë, Bullgarinë, Kroacinë, Slloveninë, Shqipërinë , ku turizmi është njëra prej sektorëve të ekonomisë i cili ka thithur investime nga investitorët e huaj dhe të qëndrueshëm ne këto vende. Edhe Kosovës me potencialin e konsiderueshëm turistik i nevojiten investime të shumta për zhvillimin

turizmit. Gjithnjë duke marrë për bazë prioritete si në planin afatshkurtër ne të cilin mendohet të shkohet në modernizmin dhe rekonstruktimin e objekteve hoteliere për vendosje të dëmtuara dhe ndërtimin e objekteve të reja për infrastrukturën turistike. Nevojat për zhvillimin e turizmit janë prioritete të cilat na japin një kërkesë të qëndrueshme e cila bazohet në komunitetin (bashkësinë ndërkombëtare) të vendosur në Kosovë.

Zhvillimi i turizmit në periudhën e pasluftës, ka arritur një zhvillim të konsiderueshëm të bazës materiale, i cili është përciellur më përmasa brengosëse. Kosova me kushtet e saja në disponim paraqet bazë potenciale për zhvillimin e turizmit me degët e tij si: Turizmit malor, turizmit balnear , turizmin fshatar , turizmin kongresist, turizmin transit , turizmin kulturor etj. Kosova disponon me vlera të shumta të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, me motive të shumta që nga e kaluara e lashtë deri në ditët e sotme.

Tabela 1. Tabela e kohës për të arritur deri në vendet turistike të Kosovës për njësi ore

Vendi i nisjes	Prishtinë			Brezovicë			Prizren			Pejë-Deçan-Istog		
	Aeropl-an	Tr-en	Auto-bus	Aer opl an	Tr-en	Aut-obus	Aero-plan	Tren	Autobus	Ae-ropl an	Tren	Autobus
Beograd	1	7	6	-	8	7	-	10	7	-	9	8
Zagreb	2	13	11	-	14	12	-	16	12	-	15	13
Novi Sad	2	9	7	-	10	8	-	11	8	-	15	10
Nish	-	4	3	-	5	4	-	7	4	-	6	6
Kopenhagën	4	22	29	-			-			-		
Londër	4	21	29	-			-			-		
Minhen	3	20	26	-			-			-		
Prag	3	20	28	-			-			-		
Romë	3	31	25	-			-			-		

Roli i turizmit për zhvillimin e ekonomisë

Turizmi është njëra prej veprimtarive me komplekse në shoqërinë e sotme moderne. Ne vendet e zhvilluara ka marrë formën e një industrie të plotë me të cilën ndërveprojnë shumë veprimtari si ; ekonomia, politika, kultura dhe të gjitha veprimtaritë dhe aktivitete njerëzore. Roli i turizmit për zhvillimin e ekonomisë është mjaftë i lartë sepse turistët, konsumojnë ne vendin i cili vizitohet. Zhvillimi i turizmit në ekonominë e një vendi mund të ketë ndikime të drejtpërdrejta , indirekte dhe multiplikative. Në sferën e ndikimeve direkte që bën turizmi në ekonomi, me të rëndësishme janë ndikimet në produktin shoqëror dhe të ardhurat nacionale, në zhvillimin e veprimtarive ekonomiket cilat përbëjnë ekonominë turistike si hoteleria, tregtia, transporti, institucionet kulturore për argëtime etj. Mandej

inkuadrimi i popullsisë në punë e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë në ngritjen e standardit jetësor, ngritjen e investimeve, në ekuilibrin e shkëmbimit me jashtë si dhe zhvillimin e vendeve dhe rajoneve më pak të zhvilluara.

Efektet e turizmit janë edhe indirekte, në ato veprimtari ekonomike, të cilat nuk marrin pjesë në shërbimet e drejtpërdrejta të vizitorëve, por janë në shërbim të ekonomisë turistike; bujqësia, ndërtimtaria, industria, tregtia etj.

Baza për një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e turizmit në Kosovë

Zhvillimi i turizmit për secilin vend është i lidhur me qëndrueshmërinë politike dhe sociale. Arritja e tyre mund të bëhet në qoftë se ka rritje ekonomike të qëndrueshme. Rritja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm mund të arrihet vetëm atëherë kur kemi një mjedis të sigurt të sektorit privat. Për vendosjen në vend të një klime makroekonomike të qëndrueshme dhe një ekonomie të tregut duhet të bëhen përpertime në reformat ekonomike të cilat kanë munguar deri në periudhën e pasluftës.

Mjedisi makroekonomik i qëndrueshëm është prej prioriteteve për të përfituar investitorët. Vendi duhet të jetë i sigurt nga veprimet e dëmshme si kriminaliteti, korrupsioni, të cilat ndikojnë në stabilitetin dhe zhvillimin e vendit. Gjithëherë do të ishte e preferueshme, për të krijuar një mjedis i favorshëm për investitorët e jashtëm, por edhe ata të vendit. Kosovës i mungon politika turistike. Kjo është e vështirësuar se edhe pas përfundimit të luftës, ende nuk ka një vizion e as një koncept të zhvillimit makroekonomik, e lëre me një strategji të zhvillimit të hartuar nga institucionet kompetente e cila është në përgatitje. Edhe pse ekzistojnë studime të shumta nga banka Botërore dhe organizmat përkatës të Bashkësisë Evropiane për mundësitë e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Kosovës ende i mungojnë indikatorët bazik makroekonomik për formimin e politikave ekonomike duke përfshirë edhe atë turistik. Tani Kosova ka në dispozicion ligjin për turizmin i cili përfshin veprimtaritë hoteliere, atë të agjencive turistike, të ciceroneve turistike etj.

Në Kosovë ende nuk është krijuar një mjedis në të cilin investitorët, vendor dhe ata ndërkombëtarë do të fitojnë besimin për të investuar. Kjo kërkon miratim të shpejtë të pakos legjislative për të rregulluar aktivitetet e investimeve dhe biznesit komform standardeve ndërkombëtare. Tani pas zgjedhjes së statusit siç duket është në rrugë të mbarë.

Disa forma te intervenimit të shtetit në shtetet e Evropës perëndimore dhe shtete në tranzicion për zhvillimin e turizmit

Ne të gjitha vendet e botës, pa marrë parasysh zhvillimin shoqëro-ekonomik të vendit, shumë çështje lidhur me turizmin rregullohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga ana e shtetit. Turizmi përfshinë sferat e ndryshme të jetës shoqërore si politike, ekonomike, kulturore, sociale, atëherë edhe lënda e politikës turistike e përcaktuar kryesisht nga shteti, përfshinë grupet e aktiviteteve shoqërore të cilat i takojnë politikës sociale, ekonomike, shëndetësore, politike, kulturore dhe elementeve përbërëse të tyre. Ne të gjitha vendet ligji i rregullon pjesën me të madhe të raporteve dhe dukurive të turizmit, duke i përfshirë të gjitha veprimtaritë si në hotelieri, transport, të tregtisë, të politikës sociale, shëndetësore, industriale, bujqësore etj.

Ne përgjithësi kompetencat me të rëndësishme të organeve shtetërore për turizëm me vendet e Evropës perëndimore dhe vendet fqinje të Kosovës janë:

- Përgatitja dhe hartimi i planeve për zhvillimin e turizmit,
- Përgatitja e dispozitave ligjore nga lëmi i turizmit,
- Monitorimi dhe zbatimi i dispozitave dhe punës së organizatave të rëndësishme turistike,
- Caktimi i politikave të çmimeve të shërbimeve të vendosjes dhe të ushqimit,
- Sigurojnë orientimin e mjeteve të kredive financiare për zhvillimin hotelierisë si dhe merren me veprimtaritë informative-propagandistike me interes kombëtar si dhe organizojnë punën e përfaqësive turistike në botën e jashtme.

Veçoritë e ndërvarjeve hoteliere dhe ecuria e zhvillimit të tyre

Numrin me të madh e përbejnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ku kemi të bëjmë kryesisht me rritjen e shpejtë ekonomike. Krijimi i strukturës së re ekonomike të Kosovës, synimi është që sa më i zhvilluar të jetë sektori privat e cila do të pasoj me rritjen e vendeve të punës dhe migrimin social për popullatën.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme edhe pse janë në zhvillim të vazhdueshëm, janë duke u ballafaquar me një numër të barrierave të cilat kanë të bëjnë me mungesën e rrethinës ligjore, konkurrencën jolojale dhe mungesën e qasjes në burimet financiare eksterene.


Duke e ndjekur veprimtarinë e biznesit hotelier privat në rrjedhën e vetë kronologjike, vihet re një rritje e shpejtë e tij në periudhën e parë 1970-1996, pastaj një rënie, që fillon në vitet 1996-1999 si pasojë e dhunës

së ushtruar nga pushteti serb, duke arritur me rritjen me të madhe të krijuar gjatë viteve 1999-2002 e tutje e cila vazhdon.

Pas luftës së fundit të viteve 1988 dhe 1999, turizmi dhe hoteleria zënë vend të rëndësishëm në aktivizimin ekonomik të Kosovës. Pjesëmarrja e ekonomisë turistike (duke përfshire sektorin shoqëror dhe atë privat) i cili kohëve të fundit veç ka arritur ngritje në produktin bruto vendor aktualisht vlerësohet se është 6-7 %, krahasuar me përudhen 1970-1999 ka qenë 1.9 % deri 2.3 %. Rritja e pjesëmarrjes në ekonominë turistike në bruto produktin vendor është rezultat i rënies drastike të aktivitetit ekonomik të sektorit shoqëror dhe bruto produktin vendor është rezultat i rënies drastike të aktivitetit ekonomik të sektorit shoqëror dhe publik të ekonomisë, pastaj ndryshimet të ambientit makroekonomik dhe rivalitetit të madhe të sektorit privat dhe hotelerisë.

Duke e analizuar strukturën e veprimtarive ekonomike, e cila është e ndarë në 17 seksione, seksioni i hoteleve dhe restoranteve është në vendin e katërt për nga numri i bizneseve të regjistruara, ajo pas seksionit të tregtisë me shumicë dhe pakicë, industrisë përpunuese dhe transportit, magazinimit dhe komunikacionit.

Duke e analizuar numrin e përgjithshëm të gjitha bizneseve të regjistruara deri në qershor 2002, ku janë regjistruar 50,399 biznese, bizneset në lëmin e veprimtarive hotelier marrin pjesë me 8.48 %, ose gjithsejtë 4275, biznese. Edhe pse nga numri i të punësuarve, hoteleria me 10.929 të punësuar zë vendin e katërt në numrin e përgjithshëm të punësuarve në ekonominë e Kosovës e cila kap shifrën 180.568 të punësuar. Për periudhën e pasluftës hapja e bizneseve të reja hoteliere është përqendruar kryesisht në biznese të mesme dhe biznese të vogla. Si veçori bazë e zhvillimit të biznesit hotelier në Kosovë është zhvillimi i tij në formën e bizneseve të vogla, e cila shoqërohet me disa pasoja si; mundësi të vogla, për krijim e vendeve të punës, por për te ndikuar edhe në uljen e papunësisë; si mundësi relativisht të kufizuara për të ardhurat nga taksat dhe tatimet e ndryshme.



Shpërndarja e objekteve hoteliere ne regjionet e qendrave me te mëdha të Republikës së Kosovës

Shpërndarja hapësinore për objektet hoteliere dhe ndërmjetësimi turistik është përafërsisht në përputhshmëri me aktivitetin ekonomik që realizohet në komunat e Kosovës. Ne shpërndarjen e objekteve hoteliere te vendit ekziston kjo pjesëmarrje: Prishtina merr pjesë me 1373 biznese hoteliere ose shprehur ne përqindje me 32.11%, Prizreni me 530 biznese hotelier ose 12.39 %, Peja merr pjesë me 165 biznese hoteliere ose 3.85%, Ferizaj me 102 biznese hoteliere ose 2.38 %, Gjilani me 239 biznese hoteliere ose 5.59 %, Mitrovica me 288 biznese hoteliere ose 6.37 % dhe Gjakova me 196 biznese hotelier ose 2.81 %.

Kjo lëmi ka mangësitë e saj, sepse ne bazë te analizave nuk janë te ndërtuara te gjitha bizneset hotelier sipas standardeve. Por ka edhe te atilla qe i plotësoin kriteret për këtë veprimtari sipas standardeve te cilat do te plotësonin ofertën turistike.

Ne mungesa te dhënave për momentin, ne fare pak kemi njohuri për strukturën sipas moshës, nivelin arsimor, te pronave të bizneseve hotelier.

Ne bazë të strukturës se te punësuarve ne bizneset hotelier numri me i madhe është femra 75% ndërsa numri i pronarëve ne bizneset hoteliere femra është me i ulet së 2 %.

Subjektet hoteliere janë ne fazën fillestare të formimit te tyre ne bazë të kapitalit te tyre privat. Te gjitha paraqesin bazë solide për zhvillimin e ofertës turistike. Ne perspektiv do te jen mjaft profitabile.

Përfundimi

Turizmi ne vendin tonë është zhvilluar në rrethana mjaftë të vështira në aspekte të ndryshme si politike, ekonomike, shoqërore. Ne vitet e fundit vështërsite dhe kufizimet themelore nuk kanë qenë vetëm në nivel kombëtar, por edhe me gjere në nivel regjional. Shkaktar për këtë ishin rrethanat e krijuara nga luftërat në ish Republikën Federative të Jugosllavisë. Zhvillimi i turizmit është në lidhshmëri me zhvillimin ekonomik te vendit. Kosova me potencialet e sajë mund të jetë vendi me zhvillim ekonomik ne të cilin turizmi do të jete njeri prej vendeve ku premtojnë investimet në këtë sektor. Gjithherë duke marrë për bazë vendet e regjionit si Maqedoninë, Bullgarinë, Kroacinë, Slloveninë, Shqipërinë, ku turizmi është njëra prej sektorëve të ekonomisë i cili ka thithur investime nga investitorët e huaj dhe të qëndrueshëm ne këto vende. Shfrytëzimi i potencialeve turistike do te ndikoj ne ngritjen e ekonomisë. Kjo mbetet te realizohet ne perspektiv. Me qen se ende vendi ka vështërsi ekonomike. Zhvillimi ekonomik, investimet, shfrytëzimi i resurseve dhe potencialeve ne mënyrë te qëndrueshme do te na japin bazë te mirë edhe për zhvillimin e turizmit. Ku zhvillimi i tij ka efekt multiplikativ ne zhvillimin ekonomik te vendit.

Literatura

1. Dumazdier:, “Vers une civilistaion de loisir”, Paris,1972.
2. Rudollf Bičanić:”Tipologjia tržišta”, informator, Zagreb, 1968.
3. S. i Z.Marković:”Ekonomika turizma”, Zagreb, 1967.
4. Boris Vukonić:”Marketing u turizam, Zagreb, 1986.
5. Jelena kabilo:”Ekonomike turizma , Beograd,1980.
6. B. Millaku “ Tema e Magjistarures” Prishtinë 2008.
7. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës Prishtinë 2009.
8. M .Gashi : “Bazat e Turizmit”Universiteti i Kosovës, Prishtinë, 1986.
9. M. Gashi “Vlerat turistike ne Kosovë” Plani regjional hapësinor i KSAK Prishtinë 1969.
- 10 .M. Gashi : “Uslovi i mogčnosti za razvoj turizma SAP Kosovu, Prishtinë 1977.
11. M. Gashi : “Osnovni potencial turističkih vrednosti Kosova”,ekspertiza izrađena za potrebe i rade regionalnog prostornog plana Kosova, Priština 1969.
12. Tourism Victoria (2002) The Tourism Industry Strategic Plan 2002-2006, Available at: <http://www.tourism.vic.gov.au/> (accessed in September 2009).

13. UNCED (1992), Agenda 21, Rio Declaration on Environment and Development, United Nations Conference on Environment and Development, Rio de Janeiro, Available at: <http://www.un.org/> (accessed in July 2009).
14. Gjendja dhe problemet e zhvillimit të turizmit në Kosovë”, prill 2002,
15. “Analiza e shkaqeve dhe tendencave të pavoritshme në zhvillimin e turizmit në Kosovë në periudhën e pasluftës”, janar 2003.
16. Enti i Statistikës i Kosovës: Vjetarët statistikorë 1969 – 1989,
17. Pasqyrë statistikore mbi bizneset në Kosovë, nëntor 2002. D/. Zyra e Regjistrimit të bizneseve pranë MTI-së, qershor 2010.

KUD 336.71(496.51)

BANKAT DHE SISTEMI BANKAR NË KOSOVË

*Msc. Fidane Spahija,
fidane.spahija@gmail.com*

Abstrakt

Bankat janë një nga institucionet më të rëndësishme të ekonomisë së një vendi. Me rritjen e konkurrencës është rritur dhe rëndësia e tyre. Sipas literaturës kemi banka të nivelit të parë dhe të dytë. Banka e nivelit të parë është banka qendrore kurse nivelit të dytë janë bankat komerciale, investive, afariste, hipotekare, etj. Banka qendrore është subjekt i pavarur juridik dhe kryen të gjitha funksionet në shërbim sa më të mirë të ekonomisë së vendit. Bankat sekondare janë bankat të cilat kryejn shërbime të ndryshme varësisht nga veprimtaria që operojnë.

Shërbimet e bankave dita ditës po shënojnë rritje me qëllim të krijimit të lehtësive për komitentët e vet. Sa u përketë bankave në Kosovë, kemi Bankën Qendrore të Kosovës dhe tetë banka komerciale. BQK-ja është institucion i pavarur i cili mbikqyrë institucionet financiare dhe kujdeset që të kemi një zhvillim më të mirë ekonomik. Bankat komerciale përfshijnë të hyrat më të mëdha të sistemit financiar të Kosovës dhe njëkohësisht ofrojnë lloje të ndryshme të shërbimeve të cilat janë të përafërta me bankat e vendeve evropiane, kjo si pasojë e kapitalit të cilën e posedojnë.

Fjalët kyçe: Banka, llojet, komerciale, qendore, shërbime.

JEL kualifikimi: G0, G2, G21.

Hyrje

Me këtë punim shkencor bëhen përpjekje të sqarohen: Njohuritë mbi definimin dhe rëndësinë e bankave në përgjithësi, llojeve të bankave dhe shërbimeve të tyre në ditët e sotme, dhe krejtësisht në fund flitet rreth bankave që veprojnë në Kosovë. Për hartimin e punimit janë përdorur literatura të ndryshme vendore dhe të huaja, poashtu hulumtime në internet, media elektronike dhe të shkruara. Metodatat e përdorura për të arritur qëllimin e punimit kryesisht janë: analitike, krahasuese, abstraksionit, etj.

1. Ç'është banka?

Banka është një nga institucion më të rëndësishme në ekonominë e një vendi. Ato janë burim kryesor i kredive për individët, familjet, insitucionet e ndryshme, ndërmarrjet, etj. Bankat e para janë paraqitur qysh para 3000 vjetësh në Babiloni, në kuadër të pallateve mbretërore apo tempujve janë kryer punët depozitare dhe dhënia e huasë. Me zhvillimin e tregtisë janë zhvilluar edhe punët bankare. Më parë bankat kanë qenë krijueset e vetme të likuiditetit dhe bartëset e funksionit depozitar. Mirëpo me zhvillimin e ekonomisë bashkëkohore krijohen një mori organizatash të tjera financiare të cilat, krahas me bankat, luajnë një rol të rëndësishëm në fushën e mobilizimit të mjeteve monetare dhe financimit të nevojave të ekonomisë. Disa nga këto institucione punojnë me emrin bankë, kurse disa të tjera ose shumica e tyre e bazojnë afarizmin në një fushë të ngushtë të aktivitetit financiar. Pra, sot hasim në shumë insitucione financiare të cilat nuk mund të quhen banka dhe pikërisht për këtë arsye është i domosdoshëm definicioni i bankës në mënyrë që të shihet dallimi në mes të organizatave tjera financiare. Koncepti i bankës shpesh barazohet me konceptin e ndërmarrjes kreditore ose institucionit monetar (kreditor). Zakonisht me konceptin bankë janë të lidhura punët rreth krijimit të parave, grumbullimit të depozitave dhe kryerjes së qarkullimit të pagesave. Duke i përfshirë disa nga kriteret e lartëcekura, mund të themi se: banka është një institucion i posaçëm financiar i sistemit monetar kreditor që merret me marrjen dhe dhënien e kredisë në mënyrë profesionale, si dhe ndërmjetësimin në qarkullimin e pagesave të komitentëve. Sipas Dr. Felix Somary në veprën e tij “Bankpolitik”, thuhet se banka është një ent, puna kryesore e së cilës është marrja e kredive në formë të parave.⁸⁸ Somary i qaset funksionit bankës jo nga aspekti i dhënies së kredisë ose kryerjes së punëve të tjera bankare, por nga aspekti i ngarkimit me borxh (debitimit) të bankës. Ky definicion na bën të ditur se kuptimi i bankës nuk është vendimtar vetëm nga ana aktive, por nga ana pasive e bilancit për arsye se mjetet e bankës janë shumë të vogla në krahasim me mjetet që janë marrë hua. Për këtë arsye fuqia e bankës vlerësohet sipas sasisë së obligimeve të saj dhe besimit të cilin gëzon banka te deponuesit e saj.

2. Llojet e bankave dhe shërbimet e tyre

Ndërlikueshmëria, llojllojshmëria e aktiviteteve ekonomike dhe dinamika e tregut bashkëkohor të vendit dhe të jashtëm, detyruan bankën që

⁸⁸ Luboteni, Gazmend, “Menaxhmenti bankar”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2008, fq.17

të jetë në trend me një gjendje të tillë dhe që afarizmin e saj ta harmonizojë me realizimin e rentabilitetit maksimal dhe të sigurisë së afarizmit të saj. Që të realizojë këtë, banka duhet të deponojë një kapital të caktuar, i cili do t'ia sigurojë kontinuitetin e afarizmit të veprimtarië saj. Dikur dominonin bankat e tipit universal, mirëpo me zhvillimin e forcave prodhuese bëhet specializimi gjithnjë e më i madh i bankave. Kriteri më i përhapur i klasifikimit të bankave është ai se si i siguron banka mjetet financiare.

Sipas këtij kriteri bankat ndahen në: Banka qendrore (emituese), banka komerciale (depozitare), afarsite, investive, të specializuara, universale, hipotekare, rregjionale, multinacionale, kursimore, etj.⁸⁹

- **Banka qendrore** – është banka e vetme e cila bën emitimin e parasë. Karakteristikë e bankave qendrore është se qëllimi i tyre nuk është fitimi, gjë që i bën të dallohen nga bankat tjera. Në të shumtën e rasteve bankat qendrore mbajnë emrin e shtetit të tyre, p.sh Banka qendrore e Kosovës (BQK), “Bank of England”, “Banque de France”, etj. Banka qendrore kryen këto punë me rëndësi: bën emisionin e parave, zbaton politikën montare – kreditore e cila ka të bëjë me rregullimin e sasisë së parave në treg dhe stabilitetin monetar të vendit, kujdeset për likuiditetin ndërkombëtar, kryen punë në llogari të shtetit, etj. Një nga çështjet bazike të pozitës dhe të rolit të bankës Qendrore, është shkalla e pavarësisë së saj në raport me pushtetin ekzekutiv. Bashkëpunimi me bankat qendrore të vendeve të tjera jep rezultate efikase përmes së cilës mundësohet lehtësim dhe mbrojtje në nga spekulimet e ndryshme në tregun ndërkombëtar financiar.
- **Bankat komerciale** - janë bankat që bëjnë kreditimin afatshkurtër të prodhimit dhe të konsumit. Këto banka mjetet i formojnë nga depozitat e ekonomisë dhe kursimit të popullësisë. Në bazë të burimeve të mjeteve, japin kredi afatshkurtër për blerjen e mallërave dhe për këtë arsye quhen banka komerciale. Këto banka paraqesin bankat më të përhapura në botë dhe janë bazë e sistemit të ndërmjetësimit financiar. Karakteristikë e këtyre bankave është se kanë shumë komitentë dhe filiale të organizuara sipas principit territorial.
- **Bankat afariste** - paraqiten në vendet e zhvilluara duke disponuar kapitale të mëdha dhe zakonisht bëjnë kreditimin e ndërmarrjeve gjidante industriale. Banka të tilla janë: Bank of america, First National City Bank, etj.

⁸⁹ Luboteni, Gazmend, “ Bankat dhe afarizmi bankar ”, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2006, fq.12

- **Bankat investive** - janë organizata të specializuara bankare për kreditimin e investimeve, qka do të thotë se kreditimi i tyre është afatgjatë. Mjetet këto banka i sigurojnë duke dhënë fletëobligacione, afatizimin e depozitave investive, etj. Për shkak afatit të gjatë këto banka kërkojnë supergaranci për kthimin e mjeteve.
- **Bankat e specializuara ose të degëve** - janë bankat që themelohen për finncimin e degëve të ndryshme të ekonomisë (industrisë, bujqësisë, zejtarisë, tregtisë së jashtme, etj.)
- **Bankat universale** - janë banka të tipit të përzier të cilat merren me të gjitha punët bankare.
- **Bankat hipotekare** – janë organizata bankare për kreditim afatgjatë. Mjetet i sigurojnë duke bërë emisionin e plasmanin e aksioneve në treg duke rritur kështu kapitalin vetanak. Hipoteka është pengu i kredive të këtij lloji bankar.
- **Bankat rregjionale dhe bankat për zhvillim** – janë banka të cilat e ushtrojnë veprimtrinë e tyre në një territor të caktuar me qëllim të financimit të investimeve në ekonomi dhe infrastrukturë. Këto banka mund të punojnë në territorin e një vendi apo ta shtrijnë veprimtarinë në disa shtete. Banka të tilla janë: Banka Europiane Investive, Banka për Likuidimin e Llogarive në Bazel, etj.
- **Bankat komerciale** – janë bankat të cilat mobilizojnë mjetet e tyre me bashkimin e kapitaleve të bankave të njohura botërore. Këto banka lejojnë të gjitha llojet e kredisë, kryejnë punët me letra me vlerë, marrjen e depozitave, etj. Janë bankat më të përhapura dhe disponojnë mjete të shumëta financiare, gjë që ndikon në zhvillimin ekonomik të një vendi.
- **Kursimorja** – është formë e veçantë e organizatës bankare, që zhvillon kursimin dhe mbledh depozitat e kusrimit të shtresave të gjerë të popullësisë, mban llogaritë rrjedhëse të qytetarëve dhe bën kreditimin e popullësisë. Paraqesin insitucionet më të vogla monetare, të cilat nëpër qytete e fshtatëra i pranojnë me kamatë kursimet e popullësisë dhe i lejojnë në formë të kredive konsumuese për popullësisë.

Në ditët e sotme bankat ofrojnë një numër të madh të shërbimeve, disa nga më të rëndësishmet janë: Dhënia e kredive të ndryshme, dhënia e këshillave financiare për biznese dhe individ, menaxhimi i parasë së gatshme, dhënia e pjimeve me qira, financimi i kompanive të reja, sigurimi dhe ruajtja e kursimeve dhe instrumenteve të ndryshme fiannciare, ofrimi i polisave të sigurimit të kredisë, ofrimi i planeve për pensionim, kryerja e shërbimeve të brokerëve, kryerja e shërbimeve lidhur me investimet dhe

=====

punët tregtare, ofrojnë informata mbi kontabilitet, investime, kredit kartela, llogari të ndryshme, e-banking, tregun, etj. Në përgjithësi del se bankat e sotme ofrojnë një spektër të gjerë të shërbimeve mirëpo edhe përkundër kësaj, lista e shërbimeve të cilat kryejnë bankat, vjen e zgjerohet vazhdimisht sepse qëllimi i vëtëm është krijimi i lehtësive sa më të mëdha për komitentët e vet.

3. Bankat në Kosovë dhe shërbimet e tyre

Sistemi bankar në Kosovë përbëhet nga banka e nivelit të parë e emëruar si Banka Qendrore e Kosovës dhe tetë banka komerciale.

- **Banka Qendrore e Kosovës (BQK)** – është pasardhëse e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është subjekt juridik publik që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese. Është përgjegjës për licencimin e bankave dhe institucioneve tjera financiare.. Objektivat e BQK-së sipas ligjit në fuqi janë: Objektivi parësor i Bankës Qendrore është të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave; Objektivi shtesë i Bankës Qendrore i cili i nënshtrohet objektivit parësor të saj, është të kontribuojë në arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve vendore; Pa paragjykuar arritjen e këtyre objektiveve, Banka Qendrore mbështet politikat e përgjithshme ekonomike të Qeverisë dhe vepron në pajtim me parimin e ekonomisë së tregut të hapur me konkurrencë të lirë, duke favorizuar shpërndarjen efikase të resurseve.⁹⁰
- Një nga planet strategjike të BQK-së për bankat komerciale është zbatimi i standardeve Bazeli II që kërkohet dhe për antarësim në BE, poashtu BQK ka për detyrë të mbikëqyrë sigurimin minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave, identifikimin e rreziqeve dhe vlerësimin e qëndrueshmërisë, zbatimin e skemës për sigurimin e depozitave, etj.⁹¹
- **Bankat komerciale në Kosovë** – përfshijnë pjesën më të madhe të aseteve nga të gjitha institucionet tjera financiare. Bankat komerciale që operojnë në Kosovë janë: **“Procredit Bank (PCB)”**, **“Raiffeisen Bank Kosovo (RBK)”**, **“Nlb Prishtina Bank (NLB)”**, **“Banka Ekonomike e Kosovës (BEK)”**, **“Banka Private e Biznesit (BPB)”**, **“Turkish European Bank (TEB)”**,

⁹⁰ <http://www.bqk-kos.org/>

⁹¹ Pani strategjik 2010-2015, Banka Qendrore e Kosovës.

“Banka Kombëtare Tregtare (BKT)” dhe “Komercijalna Banka ad Beograd” në Mitrovicë. Nga gjithsej këto tetë banka që operojnë në Kosovë, gjashtë janë me pronësi private dhe dy me pronësi shtetërore. Pjesëmarrja e bankave me kapital të huaj në gjithsej asetet e sektorit bankar është 91.6 përqind, ndërsa bankat me kapital vendor menaxhojnë 8.4 përqind të gjithsej aseteve. Kapitali i huaj në sektorin bankar në Kosovë kryesisht ka origjinën nga vendet e Bashkimit Evropian, siç janë Gjermania, Austria dhe Sllovenia, ndërsa me një shkallë më të vogël merr pjesë edhe kapitali nga Turqia, Shqipëria dhe Serbia. Rritja e konkurrencës në sektorin bankar u manifestua edhe me zgjerimin e vazhdueshëm të rrjetit të bankave komerciale. Zgjerimi i rrjetit deri në vitin 2010 kishte një ritëm më të ngadalshëm krahasuar me vitin paraprak, si rezultat i ngadalësimit të aktivitetit të sektorit bankar si pasojë e krizës financiare globale.

Tabela 2. Rrjeti i sektorit bankar⁹²

	2007	2008	2009	2010
Numri i degëve dhe nëndegëve	219	231	267	292
Numri i të punësuarëve	2,329	2,701	3,430	3,664
Numri i ATMve	116	155	275	293
Numri i POSve	1,767	2,554	3,723	4,900
Numri i llogarive Ebanking	2,872	4,742	13,051	39,156

Numri i degëve dhe nëndegëve bankare në vitin 2010 arriti në 292 (nga 267 sa ishte në vitin 2009). Rritja e numrit të degëve është shoqëruar edhe me rritjen e numrit të të punësuarëve në sistemin bankar. Gjithsej numri i të punësuarëve në sistemin bankar është rritur nga 3,430 sa ishte në vitin 2009 në 3664 në vitin 2010, që paraqet një ngritje prej 6.8 përqind. Megjithatë, në fund të vitit 2010 vërehet një stagnim pothuajse i plotë për sa i përket rritjes së numrit të të punësuarëve. Nga tabela mund të shohim se bankat komerciale në Kosovë ofrojnë shërbime të llojeve të ndryshme. Kryesisht këto shërbime janë: hapja e llogarive rrjedhëse dhe kursimeve për të rritur dhe fëmijë, transferet kombëtare dhe ndërkombëtare, marrja e depozitave nga ana e bizneseve dhe individëve dhe afatizimi i tyre, ofrimi i linjave kreditore- mbitërheqjeve (overdrafte), ofrimi i kredit kartelave (psh.

⁹² Raporti vjetor i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK)

Starcard që ofrohet nga TEB banka), dhënia me lizing nga Raiffeisen banka, dhënia e kredive të ndryshme, e-banking, etj.

Debit kartelat që i ofrojnë bankat komerciale në Kosovë mund të jenë: Visa Classic, Visa Electron, Maestro, etj. Kurse kredit kartelat mund të jenë: Mastercard, Visa Credit card, etj. Përveq këtyre shërbimeve bankat komerciale në Kosovë ofrojnë edhe pagesa me kartelë përmes pikave terminale të shitjes (POS) dhe tërheqjes së mjeteve përmes bank automatëve (ATM).

Numri dhe shumat e kredive të lejuara dominojnë në pasqyrat e bankave komerciale kjo si pasojë e zhvillimit të dobët ekonomik. Sa i përket kushteve për dhënien e kredisë, janë shtrënguar në kohën e fundit për shkak të krizës financiare globale, gjë e cila nëse vazhdon mund t'i shkaktoj probleme të shumëta ekonomisë së vendit. Llojet e kredive që i japin bankat komerciale në Kosovë janë: Konsumuese për mallëra dhe shërbime, personale (*individuale*), studimore, hipotekare, biznese, auto kredi, për bujqësi, për renovim, për pushime, për blerje truallit, për ndërtim, etj. Kreditë të cilat peng e kanë hipotekën janë më afatgjatë. Duke u krahasuar me vendet në rajon normat e interesit të kredive konsiderohen mjaft të larta. Ato sillen rreth 7% - 24%. Kreditë me normë më të ulët të interesit marrin të punësuarit në institucione publike dhe që i marrin pagat përmes bankës kurse kredi me normë më të lartë të interesit marrin individët të cilët janë të punësuar në biznese private dhe që nuk e marrin pagën përmes bankës, kjo për arsye se egziston rreziku më i lartë të mos kthimit të kredisë tek këta individ. Lartësia e normës së kredive do të qëndrojë e njëjtë deri sa e kemi këtë lartësi të inflacionit dhe këtë zhvillim ekonomik. Me ndryshimin e këtyre dy fenomeneve do të ndryshojë edhe norma e interesit të kredive. Pra siç po e shohim se bankat komerciale në Kosovë ofrojnë shërbime të përafërta me bankat komerciale të vendeve tjera, kjo si pasojë e bashkëpunimit me filialet e tyre amë që gjenden në vendet e Eurozonës.

Përfundimi

Si rezultat i këtij punimi shkencor arrita në përfundim se bankat janë një ndër institucione kryesore financiare të një vendi. Ato ndihmojnë në zhvillim të qëndrueshëm dhe stabilitet ekonomik. Llojllojshmëria e aktiviteteve ekonomike dhe dinamika e tregut bashkëkohor të vendit dhe të jashtëm ka bërë që të kemi lloje të shumëta të bankave. Me rritjen e konkurrencës, zhvillimin e teknologjisë dhe hapjen e firmave prodhuese kemi ekspansion të shërbimeve bankare. Këto lloje të shërbimeve bankare u ofrojnë lehtësira të shumëta klientëve të bankave.

Sipas treguesëve financiar sistemi bankar në Kosovë ka një qëndrueshmëri të lartë dhe përbëhet nga Banka Qendore e Kosovës dhe tetë banka komerciale. Mund të themi se llojet e shërbimeve të bankave komerciale në Kosovë janë të përafërta me llojet e shërbimeve të bankave të vendeve europiane. Kjo gjë ndikon pozitivisht dhe u lehtëson procedurat e bankave komerciale të Kosovës për integrim në BE. Ndër gjërat më shqetësuese për bankat në Kosovë vazhdon të mbetet norma e lartë e interesit të kredive, e cila po i dëmton bizneset dhe ekonominë në përgjithësi, mirëpo nga ana e bankave kjo gjë po arsyetohet për shkak të normës së lartë të inflacionit dhe zhvillimit të pa qëndrueshëm ekonomik. Besojmë se me përmirësimin e zhvillimit ekonomik do të eliminohet edhe ky fenomen dhe do të hapen dhe banka të llojeve tjera siç janë: bankat investive, hipotekare, etj.

Literatura

1. Prof. Dr. Gazmend Luboteni “Afarizmi bankar dhe bankat”, Prishtinë, 2006.
2. Prof. Dr. Gazmend Luboteni “Menaxhmenti bankar” Prishtinë, 2004.
3. Shelagh Heffernan “Modern banking”, London, 2006.
4. George Cooper “The origin of financial crises”, Great Britain, 2008.
5. Prof. Dr. Agim Paca “Bankat dhe sistemi bankar”, Prishtinë, 2005.
6. Xheladin Shatku “Paraja dhe aktiviteti ekonomik”, Shkup, 2004.
7. Raportet financiare periodike dhe vjetore , BQK, Prishtinë, 2009/2010.
8. Buletine dhe raporte statistikore, Bankave komerciale të vendit, 2009/2010.

Web:

www.bqk-ks.org
www.raiffeisen-kosovo.org
www.procreditbank-kos.com
www.bek-bank.com
www.bpbbank.com

KUD 005.5

**KUPTIMI, PËRMBAJTJA DHE RËNDËSIA E BURIMEVE TË
FINANCIMIT TË BIZNESEVE TË VOGLA DHE TË MESME**

*MSc. Fjolla Trakaniqi,
fjollatrakaniqi@gmail.com*

Abstrakt

Kuptimi, përmbajtja dhe rëndësia e burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë trajton disa karakteristika të definicioneve të menaxhimit të burimeve financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme sipas literaturës bashkëkohore, menaxhimin e burimeve financiare në kuadër të sistemit të menaxhimit të ndërmarrjes, njohuri dhe përvoja të menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në biznesin bashkëkohor si dhe rolin e ndërmarrësit dhe menaxherit në zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve të financimit.

Fjalët kyçe: Burime të financimit, menaxhim, financim, biznes, ndërmarrës dhe menaxher.

JEL kualifikimi: G, M2, M20, NO, P34.

Hyrje

Në këtë punim janë paraqitur katër tema që kanë të bëjnë me kuptimin, përmbajtjen dhe rëndësinë e menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme. Të gjitha bizneset, pa marrë parasysh a janë të vogla apo të mesme kanë nevojë për burime të financimit si dhe nevojën për tu menaxhuar. Menaxhimi përfshinë të gjithë procesin menaxhues në një ndërmarrje. Çdo aktivitet i menaxhmentit financiar si investimi, financimi apo shpërndarja e fitimit përfshijnë shumë detyra që kryhen në ndërmarrje. Për marrjen e vendimit financiar në ndërmarrje menaxherët duhet të njoftohen me gjendjen e ndërmarrjes dhe me rezultatet financiare të arritura.

Përveç këtyre në këtë punim janë paraqitur edhe përvoja të menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në biznesin bashkëkohor e veçmas të disa vendeve të zhvilluara dhe vendeve me ekonomi në tranzicion.

I. Disa karakteristika të definicioneve të menaxhimit të burimeve financiare te bizneseve të vogla dhe të mesme sipas literatures bashkëkohore

Mbi menaxhimin janë dhënë lloje të ndryshme të definicioneve nga ato më të thjeshtat si "menaxhimi është ajo çka menaxherët bëjnë" gjer tek ato më të detajuarat. Njeriu i cili kryen këtë funksion njihet si menaxher ose udhëheqës.

Menaxhimi, (*ang.: management - sq.: udhëheqje, prirje, lat.: manum agere = prijë me dorë*), nënkupton planifikimin, organizimin, udhëheqjen, koordinimin dhe kontrollin e një organizmi (të përbërë nga një ose më shumë njerëz ose grupe) për të arritur qëllimin e caktuar.⁹³

Koncepti i sotëm tregon se menaxhimi ka 3 karakteristika kryesore: është një proces që përfshinë një seri aktivitete të vazhdueshme dhe të ndërlidhura, përqendrohet në arritjen e objektivave organizative dhe synon arritjen e këtyre objektivave dhe burimeve tjera të organizatës.

Sipas disa studjuesve dhe autorëve bashkëkohorë, "Menaxhimi është procesi i arritjes së objektivave organizative duke punuar me dhe nëpërmjet njerëzve dhe burimeve të tjera organizative".

I.1. Definicionet e disa mendimtarëve mbi menaxhimin⁹⁴

Peter Ferdinand Drucker (19 nëntor 1909 - 11 nëntor 2005) P. Drucker, për rëndësinë e menaxhimit, pohon se: "Përgjegjësia e menaxhimit në shoqërinë tonë është vendimtare jo vetëm për vet organizatën, por edhe për qëndrimin publik ndaj menaxhimit, për suksesin dhe statusin e tij, për të ardhmen e sistemit tonë ekonomik e social dhe për mbijetesën e organizatës si një institucion i pavarur".

Sipas P. Drucker menaxhimi ka tri detyra kryesore:

- Të realizojë qëllimin dhe misionin specifik të organizatës,
- Ta bëjë punën produktive dhe punëtori ta arrijë atë,
- Të menaxhojë impaktet dhe përgjegjësitë sociale.

Henri Fayol (29 korrik 1841, Istambull, - 19 nëntor 1925, Paris) konsideronte se menaxhimi përbëhet prej pesë funksioneve: planifikimi, organizimi, udhëheqja, koordinimi dhe kontrolli.⁹⁵

Mary Parker Follett (3 shtator 1868 - 18 dhjetor 1933) e definoi menaxhimin si "arti për realizimin e veprimeve përmes njerëzve".⁹⁶

⁹³ <http://sq.wikipedia.org/wiki/Menaxhimi>

⁹⁴ <http://www.slideshare.net/nicky201/menaxhim-pyetje-pergjigje>

⁹⁵ <http://sq.wikipedia.org/wiki/Menaxhimi>

⁹⁶ <http://sq.wikipedia.org/wiki/Menaxhimi>

George Rippey Stewart (31 maj 1895 – 22 gusht 1980) studjuesja e mirënjohur e menaxhimit, R.Stewart, në përpjekjet e sajë për të integruar definicionet e ndryshme të menaxhimit thekson: “Të menaxhosh do të thotë të vendosësh se çfarë të bësh dhe pastaj të vësh njerëzit e tjerë për t’i bërë”.

Sipas **Prof. Dr. Isak Mustafa** “Menaxheri është subjekt përmes të cilit veprimtari profesional mund të drejtojë diturinë, punën dhe kapacitetin e tij drejt rezultateve të përbashkëta dhe përmes të cilit zbulon nevojat, kapacitetet dhe mundësitë e ndërmarrjes anëtarë i të cilës është ai”.⁹⁷

Sipas **Prof. Dr. Isa Mustafa** “Menaxhmi definohet si proces dhe organ i cili është përgjegjës për shtruarjen e qëllimeve themelore, udhëheqjen dhe organizimin e realizimit të qëllimeve të shtruara”.⁹⁸

Brech e përcakton menaxhimin si "Një proces social që ka përgjegjësi për planifikimin dhe rregullimin efektiv dhe ekonomik të operacioneve të një organizate me qëllim që të arrihet një objektivë apo një detyrë e dhënë. Një përgjegjësi e tillë përfshinë:

Vlerësimin e gjendjes dhe marrjen e vendimeve për përcaktimin e planeve, për përdorimin e të dhënave, për kontrollin e performancës dhe të nivelit të progresit kundrejt planeve, udhëheqjen, integrimin, motivimin dhe mbikqyrjen e personelit të organizatës, i cili i kryen operacionet e sajë.

F. Luthanas dhe R. Hodgetts japin një përkufizim më të thjeshtë të menaxhimit: “Menaxhimi është procesi i përcaktimit të objektivave dhe i koordinimit të përpjekjeve të punonjësve për t’i arritur ato”.

C. S. George në lidhje me menaxhimin, ka theksuar: "Nga një pozitë pothuaj e panjohur në vitin 1900, menaxhimi sot është bërë një aktivitet qendror i epokës dhe ekonomisë sonë, një forcë e fuqishme dhe novatore në të cilën mbështetet shoqëria jonë në fushën materiale dhe mirëqenie kombëtare".

Johan Kotter ekspert amerikan thot: “Menaxherët nxjerrin vendime buxhetore dhe plane afatgjata”.

II. Funksioni i menaxhimit të burimeve financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme në kuadër të sistemit të menaxhimit të ndërmarrjes

Menaxhmi përfshinë të gjithë procesin menaxhues në një ndërmarrje duke u nisur nga planifikimi, punësimi, drejtimi, bashkërenditja, ekzekutimi e deri te kontrolli i sajë. Të gjitha aktivitetet financiare në një ndërmarrje janë të pranishme duke filluar nga furnizimi e deri te shitja dhe pagesa. Për realizimin e objektivave dhe detyrave të shtruara të ndërmarrjes ndërmirren

⁹⁷ Prof.Dr.Isak Mustafa, “Drejtori në udhëheqjen e biznesit”, 1993, Prishtinë. fq.20.

⁹⁸ Prof.Dr.Isa Mustafa, “Udhëheqja efiçienca dhe efektiviteti”, 2004, Prishtinë. fq.10.

një varg aktivitete. Këto aktivitete mund të grumbullohen në katër grupe:⁹⁹

- Aktivitetet që kanë të bëjnë me formulimin e strategjisë,
- Aktivitetet që kanë të bëjnë me investimin,
- Aktivitetet që kanë të bëjnë me financimin dhe
- Aktivitetet operative.

Në aktivitetet që kanë të bëjnë me formulimin e strategjisë menaxhmenti vendos qëllimet dhe detyrat e ndërmarrjes e kjo i mundëson gjetjen e alternativave më të mira për realizimin e qëllimeve, e qëllimi kryesor i ndërmarrjes është rritja e pasurisë së ndërmarrjes.

Aktivitetet që kanë të bëjnë me investimet e ndryshme përfshijnë marrjen e vendimeve të ndryshme për angazhimin e burimeve të mjeteve në forma të ndryshme.

Në aktivitetet e financimit të ndërmarrjes përfshihet marrja e vendimeve lidhur me financimin dhe shfytëzimi sa më racional i mjeteve në ndërmarrje. Në këto aktivitete njëherit përfshihet edhe zgjidhja e problemeve të cilat janë të lidhura me burimet e financimit, lartësia e mjeteve dhe struktura e mjeteve financiare.

Në realizimin e qëllimeve të ndërmarrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon menaxhmenti financiar nëpërmes vendimeve që merr lidhur me investimet, financimin, dhe shpërndarjen e fitimit.

Çdo aktivitet i menaxhmentit financiar si investimi, financimi apo shpërndarja e fitimit përfshijnë shumë detyra që kryhen në ndërmarrje qoftë në afat të shkurtër apo të gjatë.

Aktivitetet e ndërmarrjes që lidhen me investimin brenda një afati të shkurtër përfshijnë drejtimin me para të gatshme dhe drejtimin me kërkesat dhe me rezervat. Aktivitetet që lidhen me investimin në afat të gjatë përfshijnë investimin në mjetet e përhershme, ndërtimin ose blerjen e mjeteve themelore dhe plasmanin afatgjatë financiar.

Aktivitetet që kanë të bëjnë me financimin e ndërmarrjes me afat të shkurtër përfshijnë kujdesin për likuiditetin vijues dhe ngarkesën afatshkurtër. Aktivitetet lidhur me financimin për afat të gjatë kanë të bëjnë me sigurimin e kapitalit te bankat, emisionin e fletobligacioneve dhe aksioneve etj. Lidhur me shpërndarjen e rezultatit të ndërmarrjes vendoset se cila pjesë e fitimit ndahet për pronarët e kapitalit, cila pjesë e fitimit mbahet për rezerva dhe cila pjesë mbahet për riinvestim.

Menaxhmenti financiar mirret me qeverisjen e financave të ndërmarrjes. Menaxhmenti bashkëkohor sot ka dimension tjetër dhe krijon pasqyrë të re të rolit dhe pozitës së menaxherit të financave. Menaxheri i financave ka marrë rolin e kërkuesit të mënyrës më efikase të shfytëzimit të

⁹⁹ Prof. Dr.Berim Ramosaj, Doc.Dr. Izet Zeqiri, "Menagement", 2003, Prishtinë, fq.81.

burimeve financiare. Që të kryej rolin e vet si menaxher financiar, menaxheri duhet të ketë lidhje me të gjitha funksionet afariste të ndërmarrjes. Për të shfrytëzuar kapitalin dhe pasuritë e ndërmarrjes në mënyrë sa më efektive menaxheri i financave duhet t'i njeh mirë edhe fushat tjera të ekonomisë së ndërmarrjes.

Ekzistojnë dallime në mes të menaxhmentit klasik dhe menaxhmentit modern financiar. Menaxhmenti klasik financiar përfshinte vetëm çështjet e shfrytëzimit të burimeve të kapitalit të ndërmarrjes. Ndërsa, menaxhmenti financiar modern mirret me përcaktimin e masës së nevojshme, strukturës dhe mënyrës së shfrytëzimit të kapitalit të ndërmarrjes.

Mbështetur në kuptimin e menaxhmentit financiar bashkëkohor, elementet që përfshijnë esencën e punëve që dalin nga ky proces janë:

- Analiza e pozitës financiare të ndërmarrjes,
- Përcaktimi i sakt i strukturës dhe masës së mjeteve afariste,
- Përcaktimi i strukturës së kapitalit si burime financiare të mundshme.¹⁰⁰

Analiza e pozitës financiare të ndërmarrjes - Kjo analizë përfshinë analizën e bilancit të gjendjes, analizën e bilancit të suksesit si dhe raportet financiare të ndërmarrjes të shprehura në rezultatin afarist financiar.

Përcaktimi i sakt i strukturës dhe masës së mjeteve afariste - Këtu bëhet përcaktimi kuantitativ dhe kualitativ i mjeteve themelore dhe xhiruese të ndërmarrjes në kuadër të aktivitetit të bilancit të gjendjes. Për menaxherin e financave njohja e gjendjes nga e kaluara dhe planet reale të mundshme paraqesin kusht themelor për definimin e strukturës optimale të mjeteve afariste.

Përcaktimi i strukturës së kapitalit si burime financiare të mundshme Nevoja e përcaktimit dhe definimit të strukturës së kapitalit që përmban pasivi i bilancit të gjendjes paraqet marrëdhënjet midis burimeve të brendshme dhe të jashtme financiare njëherit edhe marrëdhënjet midis burimeve afatshkurtra dhe afatgjata të financimit.

Për marrjen e vendimeve financiare në ndërmarrje menaxherët duhet të njoftohen me gjendjen e ndërmarrjes në kohë të caktuar dhe me rezultatet financiare të arritura.

Për marrjen e vendimeve në lidhje me financimin e ndërmarrjes menaxhmenti duhet të disponoj me disa lloje të informacioneve edhe atë:

- Informacionet për fluksin e parave,
- Informacionet për qarkullimin e mjeteve gjiruese,
- Informacionet për qarkullimin e mjeteve të përgjithshme,
- Informacione lidhur me normën e kamatës,

¹⁰⁰ Prof.Dr.Berim Ramosaj, Doc.Dr.Izet Zeqiri, "Menagement", 2003, Prishtinë, fq.68.

- Informacionet në lidhje me shpenzimet e borxhit,
- Informacionet në lidhje me çmimin e kapitalit nga burimet interne,
- Informacionet në lidhje me liverazhin etj.

Nga këto informacione të lartpërmendura dhe informacionet tjera financiare menaxhmenti financiar krijon një bazë informative të shëndoshë për marrjen e vendimit në lidhje me financimin e ndërmarrjes.¹⁰¹

III. Disa njohuri dhe përvoja të menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në biznesin bashkëkohor

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX u krijuan kushte për trajtim më të madh të menaxhimit të ndërmarrjeve. Ndër teoricientet dhe biznismenët e parë që u morrën me këtë ishte biznesmeni britanik Robert Owen i cili ndërmorri disa reforma në fabrikën e tij të pambukut.

Marrëdhënieve publik menaxher janë të ngarkuar për të bashkëvepruar me mysafirët e hotelit ose konsumatorët, ekstra reagimet e tyre dhe të ofrojnë zgjedhje të përshtatshme për problemet e tyre, ndërsa ata po qëndrojnë në hotel. Ata duhet të kenë aftësi mbi mesataren e njerëzve të jenë në gjendje të jetë i suksesshëm i marrëdhënieve publik menaxher. Shumicën e kohës, ai do të duhet të përballë me ankesat e miqëve ose klientëve të cilët janë zakonisht tashmë të zemëruar, kështu që ai duhet të jetë gati për të qetësuar nervat e tensionuara duke qenë i sjellshëm dhe i gjindshëm. Ai gjithashtu do duhet të përballë me mediat në lidhje me shqetësimet apo çështjet e të denjë për vëmendjen e mediave. Në rast të paturit e një yll i famshëm si mysafir, të marrëdhënieve publike menaxheri është ai që duhet të gjejnë mënyra që ta mbrojë mysafir nga mediat apo nga njerëzit e tjerë. Për njerëz të tillë, jetën private është një mall shumë i shtrenjtë dhe për këtë arsye është një arsye e vlefshme për zhgënjim me hotelin në qoftë se ndonjëherë një mysafir ndien se jetën e tij private ose të saj është duke u hulumtuar ta arrijnë mbi të.

Menaxhimi materialo financiar i ndërmarrjeve hoteliere, recepcioneve dhe restoranteve

Softveri për hotelieri ju mundëson menaxhimin financiar të shërbimeve hoteliere të qëndrimit të mysafirëve që nga mbërritja deri në largim. Fatura mund të përpilohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Raportet gjenerohen sipas kërkesave të klientëve. Përmes softverit për restorante mundësohet menaxhimi materialo-financiar i të gjitha punëve që kryhen në restorante, bare, kafeteri, kuzhina, si: menaxhimi i kategorizimeve të artikujve, menaxhimi i kamerierëve, menaxhimi i artikujve, menaxhimi i çmimeve, menaxhimi i kuponëve e të tjera. Identifikimi i kamerierëve mund të bëhet me pasvord – fjalëkalim ose me kartelë identifikuese përmes lexuesit të barkodeve. Softveri është i dizajnuar që të përkrahë punën me ekran me prekje “touch screen”, me tastierë të restoranteve, tastierë të rëndomtë apo me Pocket PC, Programi përdor metodën e sistemit të ndarjeve të shpenzimeve sipas normës së paracaktuar – **NORMATIVIT** të produkteve të gatshme

Rekomandimet

Aktualisht në vendin tonë, turizmi nuk është një produkt specifik, por është një qasje për zhvillim ekonomik, i cili u siguron investitorëve të biznesit të vogël të jenë në gjendje të sigurojnë fitime ekonomike të pranueshme të ndershme dhe të qëndrueshme dhe i ndihmon ata të përmirësojnë jetesën e tyre. Turizmi masiv mund të zhvillohet vetëm me përmirësimin e infrastrukturës në përgjithësi dhe asaj rrugore në veçanti, duke lejuar transportimin e sasive të mëdha njerëzish në një hapësirë të shkurtër për të shkuar në vende që kanë interes, në mënyrë që kjo sasi e madhe njerëzish të përfitojë argëtimin që ata kërkojnë në kohën e lirë që ata konsumojnë. Turizmi i këtij tipi është i qëndrueshëm kur: a. Sigurohet që veprimet e sotme nuk të largojnë nga mundësitë e së nesërme; b. Realizohet një qasje për të gjitha bizneset e turizmit jo vetëm ata që janë përfshirë në turizmin malor; c. Miratohet një metodologji efikase për menaxhimin e destinacionit turistik; d. Punohet me partnerët tuaj për të nxitur rritjen e qëndrueshme të turizmit; e. Monitorohet progresi i bërë për të lejuar përmirësim të vazhdueshëm.

Aktualisht është shumë e rëndësishme që ka një strategji të hartuar dhe të miratuar, por ka edhe një ligj të ri për zhvillimin e turizmit Sipas strategjisë të zhvillimit të turizmit njësitë vendore duhet: 1) Të krijojnë një “hartë rrugore” të qartë se si do të zhvillojë turizmin në qytetin e vet. 2) Të gjejnë mënyrat për të kanalizuar procesin për të ndjekur të gjitha rregullat dhe kërkesat. 3) Të përfitojnë nga dhënia direkte e fondeve të disponueshme për asistencë (të bazuara në projekte) për pushtetin vendor dhe nëpërmjet programeve të OJF-ve që asistojnë pushtetin vendor.

Bazuar sa më sipër kërkohet në radhë të parë ngritja e strukturës brenda njësisë vendore. Në bazë të prioritetëve që ka një njësi e caktuar, në bazë të kapaciteteve turistike të saj, struktura mund të jetë e perfaqësuar nga një punonjës i vetëm, nga një zyrë, apo edhe nga një drejtori më vete. është pikërisht kjo strukturë që mbështetur në ligjin e sipër përmendur duhet të bëjë hap pas hapi krijimin e bazës së të dhënave të angazhuar në zhvillimet turistike lokale.

Në mënyrë të përgjithshme vlerësohet se produkti turistik ka një përbërje komplekse dhe përfshin këto pjesë kryesore të cilat duhen mbajtur parasysh: 1-udhëtimin; 2-akomodimin; 3-burimet turistike (aktivitetet); 4-shërbimet. Të shikojmë se si janë të ndërlidhura këto elementë me pushtetin lokal. Për qëllimin e këtij referimi, udhëtimin mund ta ndajmë në transport në linja internacionale, nacionale dhe transporti për lëvizjet e brendshme në njësinë vendore. Lëvizjet e brendshme janë të lidhura ngushtë me pushtetin lokal në këto drejtime: -Hartimi dhe miratimi i sistemit të sinjalistikës

=====

bazuar në planin e qarkullimit rrugor brenda njësisë vendore. Rëndësia qëndron në disiplinimin e qarkullimit të mjeteve të transportit dhe sidomos të vendeve të parkimit brenda njësisë vendore. -Investimi në përmirësimin e infrastrukturës së brendshme rrugore, riparimet apo rikonstruksionet për evidentimin e potencialit turistik në njësinë vendore, për nivelin e performancës të shërbimit turistik në njësinë përkatëse, shkëmbimin e informacionit me institucione të tjera të përfshira në këtë proces dhe përvijimin e kërkesave për kualifikime e trajnime të mëtejshme të stafit përkat e plota parësore e të rrugëve dytësore. - Procedurat e licensimit të taksive furgonëve dhe autobuzëve për udhëtarët e zakonshëm.

Struktura përkatëse që merret me problemet e zhvillimeve turistike lokale ka për detyrë të kërkojë dhe të regjistrojë vendet e mundshme me potencial turistik, të vizitueshëm nga publiku për zbavitje, argëtim, çlodhje, apo me interes tjetër të veçantë dhe njëkohesisht të tërheqë vizitorë ditorë apo turistë. Këto vende mund të jenë burime turistike natyrore dhe arkeologjike, që e kanë të ngritur infrastrukturën e duhur, por mund të përfshijnë edhe veprimtaritë kulturore që zhvillohen në një vend të caktuar. Pushteti lokal nxit dhe promovon këto aktivitete si dhe stimulon dhe inkurajon tregtimin e sendeve që futen në grupin e suvenireve dhe të punëve artizanale të prodhuara si artikuj për shitje për turistët dhe që përfshijnë punime druri, punime argjendi, qëndistari, kostumet popullore, gdhëndje, punime guri, piktura, qeramikë, shportari si dhe harta, fotografi, kartolina dhe mallra të tjera të këtij lloji, si përkujtues të vizitës së tyre në Kosovë. Në ligj përcaktohet se Ministria përgjegjëse për turizmin identifikon, inventarizon dhe promovon burimet turistike, nëpërmjet sigurimit të të dhënave që kanë organet e caktuara publike të qeverisjes qendrore apo vendore. I gjithë materiali i mbledhur duhet të jetë i saktë i pasqyruar për t'u promovuar në faqe të caktuara të internetit. Në ligj shkruhet se personat juridikë dhe fizikë, organet publike qëndrore dhe vendore apo personat privatë, që zotërojnë ose administrojnë burime turistike, janë përgjegjës për administrimin e tyre, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të lidhura me të. Organet e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për bashkërendimin e punës së bashkive, komunave dhe organeve publike, të angazhuara në zhvillimin e turizmit brënda territorit të tyre, për mbrojtjen, rritjen dhe përdorimin e burimeve turistike për maksimizimin e potencialit ekonomik të tyre, në përputhje me nenet e këtij ligji. Shërbimet - Janë elemente të konsumit turistik që nuk blihen direkt por janë pjesë përbërëse e një pakete të plotë. Për arsyen se një pjesë e madhe nga komponentet e produktit total turistik janë me natyrë shërbimi, turisti bie në kontakt me një numër shumë të madh punonjësish të shërbimeve në hotele dhe motele, kamarierë në restorante, shitësa nëpër dyqane, shoqërues turistësh si dhe popull i thjeshtë në vendin ku turisti qëndron. Këta të fundit janë kryesisht

individë që jetojnë në terren, atje ku konsumohet produkti turistik dhe si të tillë janë të lidhur ngushtë dhe ndikohen nga performanca e pushtetit vendor. Shërbimet e ndryshme, zakonisht nuk tërheqin apo joshin në vetvete turistët por mangësia e tyre shkakton një dëmtim shumë të madh; niveli i ulët i shërbimeve krijon shmangien e turistit drejt një destinacioni të caktuar. Peisazhi i vendit mund të jetë shumë tërheqës, por nëse turisti nuk ndjehet mirë, pra nuk krijohet një klimë që ai të ndjejë mikpritje nga njerëzit e vendas, atëherë turisti do të largohet ose të paktën nuk do të kthehet herë tjetër në këtë destinacion, madje do të përhapë dhe opinion negativ për përshtypjet e tij. Duhet mbajtur parasysh fakti se përshtypjet që trasmetohen tek të afërmit e turistëve janë elementë që ndikojnë në rritjen apo uljen e numrit të turistëve në një destinacion të caktuar. Njëkohësisht produkti turistik përmban dhe një numër shërbimesh me të cilat turisti nuk merr më kontakte direkte por që në mënyrë indirekte influencojnë në shërbimin turistik. Këtu mund të përmendim sektorin e financës, sektorin e sigurimeve shëndetsore, sektorin e shtypshkrimeve, sektorin e shitjes me shumicë e pakicë, sektorin e shërbimeve komunale, sektorin e sigurisë publike etj. Nga më sipër, del domosdoshmëria për monitorimin e performancës së njërive vendore në këtë sektor, për forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit midis institucioneve qendrore e vendore të përfshira në këtë proces, për të krijuar bazën për një punë të qëndrueshme dhe për të rritur besimin se në Kosovë zhvillohet turizëm masiv bashkëkohor, është një dëshirë e kahershme e shqiptarëve kudo që janë.

Literatura

1. Hetemi Dr. Mehdi, E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste, Prishtinë 1996
2. Folsom R., *European Union Law*, Ts. Paul, v.1999
3. Goldštajn, A., Privredno ugovorno pravo., Informator, Zagreb 1980
4. Inskepp E., *Tourism Planning. An Integrated and Sustainable Development*, New York, v.1990
5. Krasniqi Mr. Armand., E drejta në turizëm dhe hotelieri, Pejë 2004
6. Krasniqi Mr.Armand Administrimi i shërbimeve në turizëm dhe hotelieri, Pejë 2005
7. Kripendorf, J., Reconciling Tourist Activities with Nature Conservation Council of Europe, Trasbourg, 1992
8. Jovanović Dr. Spirović Lucija., Privredno Pravo, Beograd 1999
9. Ligji mbi veprimtarinë Turistike dhe hoteliere i Kosovës, Nr. 2004 / 16

10. Viša sila i slušaj u obligacionom pravi., Pravni informator., http://www.informator.co.yu/informator/tekstovi/sila_607.htm, marrë me 01.10.2007
 11. EUROPARC Federation Strategy *Challenges and opportunities for European protected areas*
 12. Ligji për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë Nr. 03 / L – 025
 13. Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor në Kosovë Nr. 03 / L – 015
 14. Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis në Kosovë Nr. 03 / L – 024
 15. Ligji për veprimtaritë turistike dhe hoteliere në Kosovë Nr. 2004 / 16
- Web faqe :
1. <http://www.europarc.org>
 2. <http://www.unwto.org>

=====

KUD 339.13(496.51)
**NDIKIMI I ANALIZËS SË REALIZUESHMËRISË (FIZIBILITETIT)
NË SUKSESIN E FIRMAVE TË BIZNESIT NË TREGUN KOSOVAR**

MSc. Sokol J. Domniku
sdomniku@gmail.com

Abstrakt

Kushtet dhe rrethanat e sotme politike dhe ekonomike në Republikën e Kosovës, të cilat nga njëri segment ofrojnë mundësi për zhvillimin e bizneseve të vogla, por kushte dhe rrethana që njëkohësisht edhe i pamundësojnë bizneseve të ushtrojnë ashtu siç kërkohet veprimtarinë e tyre ekonomike në mënyrë që atyre të ju garantohet qëndrueshmëria dhe zhvillimi i kontinuitetit të suksesshëm afarist. Në njërën anë këto janë arsyet dhe faktorët kryesorë se përse shumë biznese sot dështojnë, që mund t'i klasifikojmë si faktorë që burojnë nga jashtë, por edhe i faktorëve të karakterit të brendshëm, që burojnë nga pakujdesia dhe mosdija e ndërmarrësve të rinj të cilët nuk i marrin parasysh në fazën fillestare disa aspekte dhe konsiderata, ku këto të fundit krijojnë mundësinë që bizneset e tyre edhe të falimentojnë. Si një nga pikat kyçe që duhet të merret parasysh përpara se të ndërmerret hapi i parë (*the first step*) pra të deponohet kapitali dhe të startojë biznesi, zgjidhja më e mirë në mënyrë që të tejkalohen shumë vështirësi dhe të krijohet një bazë e mirë që garanton suksesin afarist, është të aplikohet dhe të kryhet analiza e fizibilitetit. Në këtë punim do të ofrohen disa të dhëna kyçe që e përshkruajnë nga aspekti teorik kuptimin dhe mënyrat e realizimit të analizës së fizibilitetit, gjenden faktike në Kosovë duke përshkruar shkallën e aplikimit të analizës së fizibilitetit, nëpërmes të dhënave nga gjetjet empirike, pastaj definimi i përfundimeve kryesore të punimit si dhe propozimi i masave dhe i rekomandimeve në lidhje me këtë problematikë.

Fjalët kyçe: Analizë e fizibilitetit, Produkt/Shërbim, Biznes, Sukses, Treg, Kosovë.

JEL Kualifikimi: M20; M13; M19;

1. Hyrje

Iniciativat për të krijuar dhe zhvilluar biznese janë prezente gjithmonë në ato vende ku lejohet dhe stimulohet ndërmarrësia dhe sektori privat. Tregu është i shoqëruar me një fluks të lartë të hyrjeve të

reja të firmave të ndryshme të biznesit, mirëpo shoqërohet edhe me një fluks të lartë të daljeve gjegjësisht të mbylljeve të tyre. Një treg i shoqëruar me një konkurrencë të plotë, i mundëson konsumatorëve të tij që të kenë zgjedhje më të madhe për nga aspekti i produktit ose i shërbimit, kështu që secila firmë duhet të planifikojë mirë dhe sa më sigurt të bëjë shpërndarjen e ofertave të tyre në treg.

Firmat e biznesit të cilat funksionojnë për një periudhë më të gjatë kohore të shoqëruara me një traditë të shëndoshë, e kanë shumë më të lehtë që ti ndërmarrin veprimet dhe vendimet e tyre sa i përket realizimit të procesit prodhues. Me fjalë të tjera këto firma e kanë një përparësi absolute, sidomos ndaj firmave të reja që pretendojnë të hyjnë në tregun e caktuar, p.sh. kanë numër të kënaqshëm të konsumatorëve, nivel të kënaqshëm të shitjeve, profitin e dëshiruar, strategjitë mirë të planifikuara të mbështetura në historikun e firmës, etj.

Firmat e biznesit të cilat lindin si të reja në treg është shumë e natyrshme që këto përparësi nuk i posedojnë dhe se për këtë kërkohet që pronarët ose drejtuesit e këtyre firmave të jenë shumë të kujdesshëm në ndërmarrjen e hapave fillestarë, p.sh. gjetjen e lokacionit të duhur, përcaktimin e veprimtarisë, mënyrën e shpërndarjes së produkteve ose të shërbimeve, kontraktimin me furnitorë dhe palët e tjera të përfshira që e përbëjnë mikro-mjedisin e biznesit të një vendi të caktuar.

Shumë biznese sot dështojnë duke përfutur në fund një rezultat të falimentimit të firmës së tyre. Falimentimi shoqërohet me pasoja të larta, që drejtpërsëdrejti ngarkohet themeluesi i vet firmës. Përshkimi i këtyre pasojave bëhet në mënyra të ndryshme, p.sh. mbetja e borxheve të papaguara ndaj palëve kredituese (furnitorët, bankat, agjencitë, qeveria, etj), humbja e pjesës së kapitalit vetanak të investuar në fillim të krijimit të firmës, pastaj edhe shoqërimi me pasoja të tjera të natyrës socio-psikologjike si p.sh. stresi dhe shfaqja e problemeve shëndetësore si rezultat i tij, humbja e kredibilitetit shoqëror, etj.

Në mënyrë që të evitohen problemet e natyrave të ndryshme, në veçanti atyre ekonomike, gjëja më e mirë të cilën duhej ta bënte secili ndërmarrës i ri është që përpara se të hartojë planin e biznesit dhe përmbajtjen e tij, paraprakisht ta bëjë analizën e fizibilitetit në biznes. Përmbajtja e punimit në vazhdim, do të ofrojë të dhëna të karakterit teorik si dhe atij praktik në lidhje me rëndësinë, realizimin dhe zbatimin e këtij fenomeni shkencor.

2. Kuptimi i analizës së fizibilitetit

Me **analizë të fizibilitetit** nënkuptojmë procesin e definimit, përcaktimit dhe zhvillimit të ndikimit të mundshëm, qoftë pozitiv ose

negativ mbi projektin ose idenë e propozuar¹⁵¹. Në rast se ideja e shfaqur e kalon me sukses analizën fizibilitetit, atëherë në këtë rast mund të vazhdohet me hapin tjetër, që nënkupton hartimi i një plani të biznesit në mënyrë që të kapitalizohet ideja e propozuar. Por, në rast se ideja e shfaqur nuk e kalon me sukses analizën e fizibilitetit, atëherë kërkohet që të hedhet poshtë ideja e propozuar dhe të vazhdohet të planifikohet për një ide ose projekt tjetër të radhës. Duke e bërë një gjë të tillë një individ kursen kohën, energjinë i shmanget shpenzimeve dhe investimeve të kota. Analiza e fizibilitetit nuk është koncept dhe praktikë e njëjtë sikurse edhe plani i biznesit, mirëpo në mënyrë të pavarur që të dyja e luajnë rolin e tyre në fazën nismëtare.

Analiza e fizibilitetit i përgjigjet pyetjes: “*A duhet të vazhdojmë më tutje me idenë e propozuar*”? Roli i saj është që të shërbejë si filtër i shqyrtimit të idesë nga mangësitë e mundshme, përpara se të shfrytëzohen mjetet e nevojshme për hartimin e planit të biznesit, pra, me fjalë të tjera është një vegël hulumtuese¹⁵².

Analiza e fizibilitetit i mundëson dhe i krijon një individ një pikturë të tregut, të shitjeve dhe profitin e mundshëm që mbështetet në idenë e parashikuar, p.sh. *a do të kemi mundësi të prodhojmë produktin ose shërbimin e dëshiruar dhe a do të jenë të gatshëm klientët të paguajnë për çmimin e ofertës sonë?*, ose *a do të ishte atraktive për klientët hapja e një salle të lojërave (bilardo, ping-pong, etj), a kemi ne si individ ose si grup aftësi që të implementojmë një ide të tillë, etj.*

Në anën tjetër plani i biznesit është një vegël nëpërmes të cilës një ide e biznesit transformohet në realitet. Ndërtohet mbi bazën e analizës së fizibilitetit, mirëpo përmban analizë shumë më të përbërë dhe më të detajizuar. Analiza e fizibilitetit është shumë e dobishme sidomos në rastet kur shfaqen shumë ide të biznesit dhe në bazë të zbatimit të analizës, mbeten alternativat më të duhura.

2.1 Komponentët e realizimit të analizës së fizibilitetit

Realizimi i analizës së fizibilitetit mbështetet në dy komponentë të ndërlydhur:

- a) *në analizimin e tregut*
- b) *në analizimin e produktit ose të shërbimit*

2.2 Analiza e fizibilitetit e tregut

¹⁵¹ Domniku Sokol: “Bazat e biznesit”, Ligjërata të autorizuara, Kolegji Iliria – Dega në Pejë, 2010

¹⁵² Zimmerer, T., Scarborough M.: “*Essentials of Entrepreneurship and Small Business Management*”, fq. 123

Fokusi kryesor i analizës së tregut është i dyfishtë¹⁵³:

- të përcaktohet se sa është atraktive industria dhe tregu si tërësi?
- të identifikohet mundësia e përfitimit nga biznesi?

Pyetjet të cilat duhet përgjigjur në mënyrë që të përmbushim qëllimin e analizës së tregut janë:

- sa është i gjerë tregu?
- a është industria e zgjedhur si tërësi profitabile?
- sa janë esenciale produktet dhe shërbimet e kësaj industrie për konsumatorët e tregut?
- cilat janë kërcënimet dhe mundësitë e tregut?
- në çfarë niveli është konkurrenca?

Duke i adresuar këto çështje përcaktohet potenciali i kërkesës për produktet ose shërbimet të cilat planifikohen të ofrohen. Një vegël shumë e dobishme e cila shfrytëzohet për analizimin e tregut është modeli i “Pesë forcave” i zhvilluar nga Michael Porter-i i Shkollës së Biznesit të Harvardit (shiko figurën 1).




Figura 1. Pesë forcat e Michael Porter-it

1. *Rivaliteti*; në mes firmave është një nga forcat më të fuqishme në krahasim me forcat e tjera. Në një treg të caktuar në të cilin operojnë biznese të ndryshme, shumë shpesh ndodh që disa nga këto biznese të krijojnë ndonjë novacion ose edhe të krijojnë strategji unike të veprimit, të cilat automatikisht ndikojnë në transformim të tregut që nënkupton transformim të mënyrës së veprimit dhe të prodhimit.

2. *Fuqia furnizuese*; nënkupton që sa më e gjerë të jetë oferta e furnitorëve aq më e lehtë do të jetë për një biznes të arrijë të furnizohet dhe

¹⁵³ Po aty, fq. 123

të operojë me kosto më të ulët të prodhimit si dhe të realizojë profit më të lartë. Sa më e ulët të jetë oferta e furnitorëve për produktet e gatshme ose lëndën e parë, aq më e vështirë do të jetë për një firmë që të ndikojë në çmimin furnizues të këtyre komponentëve.

3. *Fuqia blerëse*; nënkuptohet pothuajse njëjtë sikurse ndikimi i furnitorëve që e kanë në treg dhe të cilët i bëjnë presion tregut, njëjtë edhe blerësit paraqesin një burim kryesor që mund të ndikojnë që një treg ose një industri të duket më pak atraktive. Kur numri i blerësve është i ulët dhe mundësia për të ndërruar firmën e caktuar është e lehtë, atëherë influenca në firmë është shumë e madhe.

4. *Kërcënimet nga hyrjet e reja*; nënkuptohen se sa më e gjerë të jetë mundësia e hyrjes së bizneseve të reja në treg, aq më i lartë është kërcënimi ndaj firmave që vetëm janë të qasura në treg.

5. *Kërcënimet nga produktet/shërbimet zëvendësuese*; janë faktorë që mund të ndikojnë nga pengimi i procesit prodhues të firmës e deri të falimentimi, p.sh. shumë kompani që janë marrë me prodhimin e gotave, janë detyruar të zvogëlojnë kapacitetin prodhues të tyre ose edhe të falimentojnë pasi që klientët e tyre kanë filluar të shfrytëzojnë gota dhe produkte të tjera të ngjashme të plastikës, sepse sipas tyre këto lloje të produkteve janë më të lira, më praktike për tu përdorur dhe më vështirë të thyeshme.

2.3 Analiza e fizibilitetit të produktit ose shërbimit

Pasi që arrihet të identifikohet potenciali i tregut në lidhje me mundësinë e mirë të konkretizimit të idesë së biznesit, është e domosdoshme të merret parasysh se a ekziston edhe mundësia që të prodhohet produkti ose shërbimi i caktuar me një çmim të arsyeshëm mbi të cilin mund të llogaritej edhe realizimi i profitit. Zakonisht duhet përgjigjur dy pyetjeve në mënyrë që pozitivisht të kalohet analiza e fizibilitetit në lidhje me produktin ose shërbimin:

- *a janë të gatshëm klientët që të blejnë produktin ose shërbimin tonë?*
- *a ekzistojnë mundësitë që nga shitja e produktit ose shërbimit të realizojmë profit?*

Në mënyrë që ti fitojmë përgjigjet adekuate në këto pyetje, neve na kërkohet të e pranojmë një lidhje prapavajtëse të rezultateve (*anglisht. feedback*) nga klientët e potencial të tregut. Ekzistojnë dy mënyra nëpërmes të cilave arrijmë të fitojmë përgjigjet e duhura¹⁵⁴:

¹⁵⁴ Henderson & Naomi R.: *Managing Moderator Stress*, fq. 29

- *hulumtimi nëpërmes pyetësorëve*
- *hulumtimi nëpërmes fokus-grupeve*

Hulumtimi nëpërmes pyetësorëve bëhet për qëllim kuantitativ të përfitimit të të dhënave të dorës së parë. Pyetësorët zakonisht duhen të kenë strukturë të shkurtë dhe adekuate të pyetjeve të parashtuara, p.sh. një pyetësor mund të ketë përmbajta në lidhje me produktin e ri që mendohet të ofrohet dhe secila pyetje të ketë vlerësimin me pikë, p.sh. nga 1 deri në 5, ku 1-shi do të nënkuptonte “kurrë s’do më interesonte ndonjë produkt i tillë”, ndërsa 5-shi do të nënkuptonte “nuk do e ndërroja kurrë një produkt të tillë po qe se do të ofrohej në treg”

Hulumtimi nëpërmes formës së fokus grupit bëhet për qëllim kualitativ të përfitimit të të dhënave. Një fokus grup përfshinë numër të caktuar të klientëve, p.sh. nga 8 deri në 12 dhe pyetjet të cilat atyre ju parashtohen kanë të bëjnë me dhënien e mendimeve të tyre në lidhje me një specifikë të produktit, p.sh. mund të kërkohet nga ta se cili model nga 4-5 modelet e propozuara të ambalazhës atyre ju pëlqen më së shumti ose në çfarë mënyre do të dëshironin të bëhet shpërndarja e produkti ose shërbimit të caktuar, etj.


3. Prezantimi i rezultateve të hulumtimit

Për të ofruar një pasqyrë sa më reale të problematikës së trajtuar në këtë punim, është realizuar një hulumtim i cili ka nxjerrë rezultate empirike nga përgjigjet e dhëna nga ndërmarrësit dhe menaxherët e firmave të biznesit të regjioneve kryesore të Republikës së Kosovës.


Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ka të bëjë me nxjerrjen e rezultateve sa më reale në lidhje me definimin e njohurive të ndërmarrësve në lidhje me konceptin dhe praktikën e analizës së fizibilitetit të biznes mirëpo në anën tjetër edhe shkallën e aplikimit të saj. Në këtë hulumtim janë përfshirë saktësisht 483 ndërmarrje nga regionet kryesore të Kosovës (Pejë, Prishtinë, Gjakovë, Mitrovicë, Prizren)¹⁵⁵.

Në pyetjen e parë: “A keni realizuar ndonjëherë ndonjë hulumtim nëpërmes pyetësorëve që e keni aplikuar në procesin tuaj afarist” kemi fituar këto rezultate


¹⁵⁵ Hulumtim i realizuar nga studentët e vitit të parë të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në Biznes të Universitetit të Prishtinës, Departamenti “Administrim Biznesi” – Grupi B, Gjenerata 2010/11.




Në pyetjen e dytë: “Nëse e keni realizuar në çfarë segmenti ose fushe e keni bërë hulumtimin” kemi fituar këto rezultate




Në pyetjen e tretë: “Nëpërmes cilës metodë e keni bërë hulumtimin” kemi fituar këto përgjigje




Në pyetjen e katërt: “A keni dëgjuar ndonjëherë për analizën e fizibilitetit” kemi fituar këto rezultate




Në pyetjen e pestë: “Sa e vlerësoni biznesin tuaj të suksesshëm” kemi fituar këto rezultate




Në pyetjen e gjashtë: “Sa jeni të kënaqur me numrin e blerësve” kemi fituar këto rezultate




Në pyetjen e shtatë: “Si e vlerësojnë klientët tuaj produktin/shërbimin që ju e ofroni” kemi fituar këto rezultate




Në pyetjen e tetë: “Në çfarë segmenti jeni përcaktuar për të bërë përmirësimin e cilësisë së produktit/shërbimit tuaj” kemi fituar këto rezultate



Në pyetjen e nëntë: “Cilat janë vështirësitë kryesore me të cilat ju ballafaqoheni në procesin e realizimit të aktiviteteve tuaja afariste, numëroni së paku njërën nga më kryesoret” kemi fituar këto rezultate



Në pyetjen e dhjetë me ç'rast është edhe e fundit: “A i keni paraparë dhe a keni planifikuar përpara se të startoni biznesin tuaj se do të ballafaqoheni me vështirësi të natyrave të tilla” kemi fituar këto rezultate



4. Analizë dhe përfundime

Në bazë të gjetjeve që burojnë nga të dhënat empirike dhe nga parimet shkencore të teorisë së biznesit, me theks të veçantë të trajtimit dhe përshkrimit të rëndësisë së kryerjes së analizës së fizibilitetit, mund të vijmë deri te një analizë dhe disa konstatime kryesore:

- Edhe pse një numër i konsiderueshëm i bizneseve janë të vetëdijshëm se duhet ndërmarrë disa hapa objektiv sa i përket identifikimit të mundësive dhe vështirësive që mund të ballafaqohen në treg, mirëpo mund të vërejmë edhe një përqindje të konsiderueshme të bizneseve që fare pak i përfillin kërkesat fillestare sa i përket një planifikimi efektiv përpara se idetë dhe mendimet e tyre ti vënë në aksione konkrete.

- Gjithnjë duke e menduar shumicën e bizneseve të përfshira në hulumtim të cilat kryesisht kanë një strategji të caktuar të veprimit, vërehet një numër i caktuar i firmave të cilat strategjitë e tyre të veprimit i mbështesin në pikëpamje jo shumë rentabile siç ishte rasti më konkret në pyetjen e tetë ku rreth 7% të bizneseve potencojnë që përmirësimin e shërbimit do ta realizojnë nëpërmes punësimit të numrit të ri të punonjësve. Dihet mirë se punësimi në rrethana ku nuk shfaqet si pasojë e rritjes së produktivitetit paraqet vetëm shpenzime shtesë për një biznes.

- Ndikimi i faktorëve makroekonomik është një tjetër shqetësim që bizneset i brengos shumë dhe ju vështirëson që aktiviteti i tyre afarist të zhvillohet normalisht. Ndër më të përmendurat janë elementët e politikës fiskale dhe monetare të vendit të përcjella edhe me fenomenet e tjera të përgjithshme makroekonomike. Pikërisht në lidhje me këtë problematikë kemi një përqindje poashtu goxha shqetësuese, ku pronarët e biznese të vogla nuk i kanë paraparë mirë këto vështirësi, përpara se të fillojnë bizneset e tyre.

- Përgjithësisht mund të konstatojmë se përkundër rezultateve pozitive të identifikuar nga hulumtimi, është identifikuar edhe një pjesë e rezultatit, që lirshëm mund ta klasifikojmë si rezultat negativ në krahasim me parimet e kërkuara.

- Konstatimi kryesor me të cilin mund ta nxjerrim nga ky punim është se pikërisht mos zbatimi i analizës së fizibilitetit në biznes, është një

nga arsyet kryesore se përse shumë biznese sot dështojnë dhe falimentojnë në treg. Falimentimi vjen si rezultat i shumë arsyeve, p.sh. mos përfitimi i numrit të dëshiruar të klientëve, mos definimi i mënyrës më të duhur se si të shpërndahen produktet/shërbimet ose duke mos ofruar produktin/shërbimin e kërkuar dhe të duhur në treg, etj.

5. Propozimi i masave dhe i rekomandimeve

Duke u mbështetur në teorinë shkencore të biznesit si dhe në të dhënat që burojnë nga praktika afariste të identifikuar dhe të matura empirikisht, mund të propozohen disa masa dhe rekomandime kryesore:

1. Secili ndërmarrës duhet gjithsesi të bëjë një analizë të tregut në mënyrë që ideja e tij mos të dështojë të nesërmen, e nesërmja që mund të jetë shumë e afërt.

2. Duhet të planifikohet mirë se cila do të jetë strategjia kryesore e veprimit që biznesi i ri dëshiron ta mbështesë aktivitetin e vet afarist. Shembull, nëse mendohet që pjesë e strategjisë të jetë oferta (produkti/shërbimi) unik ose edhe oferta më e lirë në krahasim me konkurrencën, atëherë duhet analizuar mirë edhe raportin e kosto-benefit, në mënyrë që të arsyetohet strategjia e caktuar.

3. Në kuadër të planifikimit efektiv kërkohet që të bëhet përcaktimi sa më adekuat i resurseve, sidomos atyre fundamentale dhe jo të angazhohen resurse shtesë qoftë fizike apo kapitale, sepse kjo ndikon në maksimizim të shpenzimeve për çdo biznes. Synimi i secilit biznes sot është që me shpenzime minimale të realizojë të ardhura maksimale kështu që këtu duhet pasur shumë kujdes.

4. Mjedisi është një çështje tjetër që mund të ndikojë në zhvillimin normal të aktivitetit të biznesit. Një mjedis i cili politikat makroekonomike i ka jo edhe aq të favorshme mund të ndikojë që shumë biznese, e sidomos hyrjet e reja të kanë ngecje të mëdha.

Pasqyra e literaturës së shfrytëzuar:

1. Burrow, Kelindl, Everard (2008): *“Business Principles and Management”*, Prentice Hall, ShBA.
2. Domniku Sokol (2010): *“Bazat e biznesit”* Dispensë e lëndës *“Bazat e biznesit”*, Kolegji Iliria – Dega në Pejë.
3. McKeown & Max (2001): *“The Truth About Innovation”*, Prentice Hall, ShBA.
4. Junewik M. (2003): *“The Productivity Business Improvement Dictionary”*, Capella University Press, ShBA.
5. Zimmerer, T., Scarborough M. (2008): *“Essentials of Entrepreneurship and Small Business Management”*, ShBA.

Referenca të tjera shkencore relevante:

1. Anketë – Hulumtim: *“Shkalla e aplikimit të analizës së fizibilitetit në ndërmarrjet e vogla në regjionet kryesore të Republikës së Kosovës”*
Realizuar nga:
Studentët e vitit të parë të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara në
Biznes të Universitetit të Prishtinës, Drejtimi “Administrim Biznesi
– Grupi B”
(Periudha e kryerjes së anketës: 15 nëntor – 25 dhjetor 2010)

=====

KUD 305-055.2:338.48

PROBLEMATIKA E PUNËSIMIT TË FEMRAVE NË VEPRIMTARITË TURISTIKE NË KOSOVË

*MSc. Valdete Rexhepi
valdeterexhepi@hotmail.com*

Abstrakt

Në vitin 2005 nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 6% kanë qenë të punësuar në veprimtari të turistike në Kosovë, prej të cilëve 4% meshkuj dhe 2% femra. Ndërsa në vitin 2009 pjesëmarrja e të punësuarve në këtë veprimtari është rritur në 7,2% prej të cilëve 5,4% meshkuj dhe 1,8% femra. Do të thotë se, përkundër evoluimit të shoqërisë kosovare viteve të fundit, numri i femrave të punësuar në veprimtari të turistike ka pësuar rënie për 0,2% nga viti 2005. Në kontest të trendeve të tilla, metodologjia e hulumtimit përfshin përdorimin e të dhënave statistikore për të analizuar tregun e punës në veprimtari të turistike në baza gjinore, hulumtimin në terren përmes pyetësorëve si dhe adaptimin e GAP¹⁵⁶ analizës përmes së cilës janë identifikuar humnerat e krijuara në pjesëmarrjen e ulët të femrave në veprimtari të turistike në Kosovë.

Fjalët kyçe: veprimtaria turistike, punësimi i femrave, barazia gjinore

Hyrje

Zhvillimi i hovshëm i turizmit ka bërë që kjo industri të jetë në mesin e punëdhënësve më të mëdhenjë në botë duke numëruar afërsisht 250 milion të punësuar në vitin 2010, prej të cilëve afër 46% të fuqisë punëtore e përbëjnë femrat. Kjo përqindje dallon nëpër vende të ndryshme në botë dhe varet nga niveli i zhvillimit të vendit dhe vetë turizmi.

Përqindja e lartë e të punësuarave femra në botë, përvojat e vendeve të zhvilluara, niveli i lartë i papunësisë e në veçanti i gjinisë femërore në Kosovë, paraqesin një argument të fortë për zhvillimin e turizmit si një

¹⁵⁶ Gap analiza (analiza e humnerës) është teknikë përmes së cilës provohet të identifikohen ngecjet në mes situatës në të cilës gjendemi dhe asaj që do të dëshironim të ishim, dhe ka për qëllim gjetjen e një strategjie të mundshme për tejkalimin e ndonjë humnere të krijuar. Në parim bazohet në dy pyetje: “Ku jemi ne” dhe “Ku duam të jemi”

veprimtari e qëndrueshme. Ndryshimet ekonomike, kulturore dhe mjedisore të cilat do të krijoheshin nga zhvillimi i turizmit, padyshim se do të përcilleshin me ndryshime edhe në marrëdhëniet shoqërore, në veçanti do të jenë evidente në aspekt gjinor. Meqenëse nga 53% të të punësuarve në Kosovë, 40% janë të gjinisë mashkullore dhe vetëm 13% janë të gjinisë femërore, shtrohet pyetja: cilën prej gjinive do ta favorizonte zhvillimi i turizmit?

Duke marrë parasysh rolin dhe barrën tradicionale të femrës në familje, zhvillimi i turizmit do të favorizonte edhe më tej punësimin e gjinisë mashkullore, apo do të ndryshonte këtë traditë duke i mundësuar gjinisë femërore jo vetëm për të kontribuar në rritjen e të ardhurave familjare, por edhe për të ndikuar në krijimin e besimit të shoqërisë në femrën si menaxhere.

Meqenëse, turizmi nuk është konsideruar si ndonjë veprimtari e rëndësishme e cila mund të ndikonte në zhvillimin e vendit, e aq më pak është trajtuar ndonjëherë si fenomen gjinor, ky punim provon të identifikojë disa çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e ulët të femrave në veprimtaritë turistike në Kosovë.

Pjesëmarrja e femrave në veprimtaritë turistike në Kosovë

Mosha prej 15 deri në 64 vjet, në Kosovë paraqet kufinjët e potencialit të fuqisë punëtore në dispozicion¹⁵⁷. Në vitin 2009 numri i përgjithshëm i të punësuarve nga kjo grup moshë llogaritet të ketë qenë 53%, nga të cilët 40% meshkuj dhe 13% femra.




Fig. 1. Numri i përgjithshëm i të punësuarve sipas gjinisë në vitin 2009

¹⁵⁷ Enti i Statistikës së Kosovës, Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2009, fq.11

Sipas arsimimit, nga numri i përgjithshëm i të punësuarve meshkuj 20,9% janë me arsimim të lartë, ndërsa nga numri i përgjithshëm i të femrave të punësuar, vetëm 2,3% janë me arsimim të lartë.

Në vitin 2005, numri i të punësuarve në veprimtaritë turistike ka qenë 6%, prej tyre 2% femra dhe 4% meshkuj, ndërsa në vitin 2009 nga 7,2% të punësuar në veprimtaritë turistike 5,4% kanë qenë meshkuj dhe 1,8% femra.




Fig. 2. Të punësuarit në veprimtaritë turistike sipas gjinisë në vitin 2009




Fig.3. Të punësuarit në veprimtaritë turistike sipas gjinive

Në raport me vitin 2005, vërehet një ngritje e ndieshme e numrit të të punësuarve në veprimtaritë turistike prej 1,2%.

Mirëpo, analizuar në baza gjinore vërehet rritje prej 1,4% në punësimin e meshkujve dhe rënie prej 0,2% në punësimin e femrave.

Të dhënat e mësipërme statistikore, tregojnë për një pjesëmarrje shumë të ulët të femrës në veprimtaritë turistike në Kosovë, dhe me tendencë të rënies për dallim nga vitet paraprake.

Zhvillimi i turizmit dhe barazia gjinore

Edhe pse trajtimi i çështjeve gjinore është një nga temat aktuale të viteve të fundit në Kosovë, ku në masë të konsiderueshme është hulumtuar përfshirja e femrës në proceset zhvillimore gjatë fazës së tranzicionit,

pjesëmarrja e ulët e femrave në veprimtaritë turistike pothuajse nuk është hulumtuar fare.

Kur në mbarë botën turizmi është një ndër veprimtaritë më të rëndësishme për punësimin e femrave, pse kjo nuk ndodh edhe në Kosovë? Ndoshta natyra e punës të cilën e bëjnë femrat si pjesëmarrëse direkte apo indirekte në veprimtaritë turistike është e “tejdukshme” për shoqërinë, apo akoma mbizotëron mentaliteti i ndarjes së punëve për meshkuj dhe femra, apo ndoshta fillimisht është më me rëndësi që shoqëria kosovare të njihet me të gjitha vendet e punës të cilat i ofron turizmi ku femrat mund të marrin pjesë dhe të japin kontributin e tyre, duke ndikuar kështu drejtëpërdrejtë në rritjen e të ardhurave familjare, uljen e varfërisë si dhe në evoluimin e shoqërisë kosovare.

Për të kuptuar barazinë gjinore në turizëm, duhet marrë parasysh tre aspekte¹⁵⁸:

1. Proceset turistike krijohen nga shoqëria dhe reflektohen nga marrdhëniet gjinore
2. Marrdhëniet gjinore, përmes bashkëveprimit të dimensioneve ekonomike, politike, sociale, kulturore dhe mjedisore reflektohen në të gjitha angazhimet e shoqërisë për zhvillimin e turizmit, dhe
3. Pushteti, kontrolli, dhe çështjet e barazisë në praktikat e turizmit, janë artikuluar përmes racës, gjinisë, klasës dhe marrdhënieve gjinore .

Kompleksiteti proceseve turistike dhe heterogjeniteti i punësimit në këtë veprimtari, shumë shpesh krijon paqartësi në definimin e vendeve të punës, gjë që në të shumtën e rasteve kufizon pjesëmarrjen e femrës në të. Duke analizuar zhvillimet aktuale të veprimtarisë turistike në Kosovë, vërehet një dallim i madh në baza gjinore si në ndarjen horizontale po ashtu edhe atë vertikale të tregut të punës.

Nëse tregu i punës analizohet në aspekt të ndarjes horizontale në baza gjinore, në vitin 2009 nga 1,8% të femrave të punësuar në veprimtaritë turistike, 1,4% kanë qenë të punësuar si recepcioniste, kamariere, nikoqire, ndihmëse në kuzhinë, pastruese, rrobalarëse, shitëse tiketash në agjenci turistike, ndërsa nga 5,4% të meshkujve, 4,4% kanë qenë të punësuar si kuzhinierë, kamariere, barmenë, etj.

Ndërsa sipas ndarjes vertikale, në pozita menaxheriale prijnë meshkujt me afër 1%, ndërsa femrat me 0,4%.

Në bazë të këtyre të dhënave, në këtë sektor ekziston një humnerë e krijuar në baza gjinore, e cili ka tendencë të zvogëlohet me zhvillimin e turizmit.

¹⁵⁸ Linda P. and Irena A, (Women Empowerment Entrepreneurship Nexus in Tourism: Processes of Social Innovation) *Advances in Tourism Research*, fq.85

Zhvillimi i turizmit pothuajse në të gjitha vendet në tranzicion ballafaqohet në ndarjen e punës në baza gjinore, gjë që aktualisht përkon me kërkesën dhe ofertën për vende pune në këtë veprimtari edhe në Kosovë. Kinnaird dhe Hall¹⁵⁹ preferojnë që për çfarëdo analize gjinore për punësim në industrinë turistike, së pari duhet hulumtuar:

- a. Llojet e punës në dispozicion dhe kualitetin e kërkuar
- b. Qasjet e gjinisë femrore për punësim në këtë sektor
- c. Ndikimi sezonal në punësim, dhe
- d. Dallimet gjinore ekzistuese dhe ato të cilat mund të krijohen në punësim

Zhvillimi i turizmit dhe barazia gjinore është një problematikë shumë dimensionale në Kosovë. Në njërin anë mungesa e strategjisë për zhvillim të turizmit, punësimi i kuadrove jo profesionale në veprimtaritë ekzistuese, pagat e ulëta, varfëria e skajshme e popullsisë, niveli i lartë i papunësisë, dhe në anën tjetër identifikimi i veprimtarive turistike me prostitucionin, konsiderimi i femrave të punësuar në këtë sektor në të shumtën e rasteve si objekte seksualiteti, kodet e veshjes, orët e zgjatura të punës, e bëjnë më të ndërlikuar dallimin dhe natyrën e vendeve të punës në këtë sektor.

Rezultatet e hulumtimit

Për të krijuar një pasqyrë reale të kësaj problematike, hulumtimi është bazuar në parimet e lartë përmendura, ku të anketuarit kanë qenë studentët e departamentit të turizmit dhe hotelerisë në FSHAB në Pejë, të punësuarit në objekte hoteliere dhe agjenci turistike në Prishtinë, si dhe të anketuar jashtë kësaj veprimtarie.

Në hulumtim kanë marrë pjesë 298 të anketuar, nga të cilët 193 meshkuj dhe 105 femra nga mosha 21vjeçare deri në 40 vjeçare, të cilët kanë dhënë këto përgjigje:

Pyetja		PO %	JO %
1	A mendoni se zhvillimi i turizmit do ti ofronte mundësi më të mëdha gjinisë femërore për tu punësuar?	78	22
2	Nëse mendoni se turizmi favorizon gjininë femërore, a do ishit dakord që e dashura, bashkëshortja apo nëna	13	87

¹⁵⁹ Kinnaird and Hall, *Tourism: A gender analysis*, (2002), New York, fq.96

	juaj të jetë e punësuar në këtë veprimtari?		
3	Nëse do ju ofroheshin dy vende të njëjta pune por me menaxher të ndryshëm, ju do të preferonit menaxherin:		
	a. Femër	63	
	b. Mashkull	37	
4	Në përcaktimin tuaj për femrën menaxhere ndikon		
	a. besueshmëria për aftësi menaxheriale	42	
	b. bukuria	58	
5	Nëse ju jeni menaxher i një ndërmarrje hoteliere, a do të kërkonit së pari kuadro profesionale për të punësuar?	62	38
6	A jeni të informuar se në Kosovë ka institucion të lartë arsimor i cili merret me përgatitjen e kuadrove profesionale për turizëm dhe hoteleri?	27	73
7	Nëse në kërkesën tuaj për pozitë menaxheriale do të paraqitej një femër dhe një mashkull me aftësi të njëjta, ju do i jepnit përparësi		
	a. Femrës	25	
	b. Mashkullit	75	
8	Ofertat më të mëdha të ndërmarrjes tuaj për punësimin e gjinisë femërore janë për vende pune ?		
	a. Kamariere	39	
	b. Kuzhinieri apo ndihmës kuzhinieri	26	
	c. Pastruese	35	
9	Kërkesat më të mëdha të gjinisë femërore për punësim në veprimtaritë turistike janë në:		
	a. Objekt hotelier	36	
	b. Punonjëse agjencie turistike	54	
	c. Nuk ka rëndësi	10	
10	A mendoni se meshkujt marrin paga më të larta se sa femrat e punësuar në veprimtaritë turistike?		
	a. Po	83	
	b. Jo	17	

Në bazë të përgjigjeve të të anketuarve duket se vetë turizmi si koncept është vështirë të definohet nga ana e shoqërisë në përgjithësi, gjë që reflektohet edhe në identifikimin e vendeve të punës të cilat bëjnë pjesë në turizëm. Prandaj raporti i pa harmonizuar i shoqërisë me turizmin krijon humnerën e parë në zhvillimin e mëtejshëm të turizmit.

Në përgjithësi mundësitë aktuale për punësim në turizëm, të perceptuara nga të anketuarit janë akomodimi, shërbimet e ushqimeve dhe agjencionet turistike për të cilat vende edhe kërkesa për punësim nga gjinia femërore është më e lartë, derisa transporti apo aktivitetet e ndryshme kulturore pothuajse nuk njihen si veprimtari turistike.

Në anën tjetër, oferta për punësim për gjininë femërore, sidomos nga objektet hoteliere është më e madhe për vende pune ku femra mund të jetë në kontakt të drejtëpërdrejtë me klientin, dhe kjo në fakt krijon humnerën e dytë në mes të ofertës dhe kërkesës.




Fig. 4. Identifikimi i humnerave në punësimin e femrës në veprimtaritë turistike

Nga të gjithë të anketuarit 78% mendojnë se zhvillimi i turizmit do të favorizonte gjininë femërore në punësim dhe vetëm 22% mendojnë të kundërtën.

Derisa pjesa më e madhe e tyre mendojnë se me zhvillimin e turizmit do rritej numri i femrave të punësuar dhe njëkohësisht ata vetë do të preferonin që të ishin vartës të menaxheres femrës, mirëpo, shumicës prej tyre nuk do t'u pëlqente që familja e tyre të ishte në mesin e atyre femrave të punësuar, me justifikimin për orar pune të tej zgjatur, ngacmimet e mundshme nga gjinia e kundërt, dhe arsye të ndryshme që kanë të bëjnë edhe me mentalitetin e shoqërisë.

Në anën tjetër të anketuarit në cilësinë e të punësuarve dhe menaxherëve në këtë veprimtari, ofrojnë vende pune për femra në cilësinë e fuqisë punëtore e jo asaj menaxheriale. Por edhe vetë interesimi i femrave

për pozita menaxheriale mungon, me justifikimin për obligime të shumta familjare, orari i pasditës, si dhe frika nga paragjykimet.

Humnerat e këtilla është e natyrshme të mos jenë të pëlqyera nga shoqëria, por ngushëllimin duhet gjetur në faktin se të gjitha vendet në zhvillim janë përballur me probleme të tilla gjatë periudhës së tranzicionit dhe evoluimit të shoqërisë.

Në vend të përfundimit

Pavarësisht të gjitha dallimeve, aktiviteteve dhe proceseve nëpër të cilat mund të kalojë turizmi, ai mund të zhvillohet pavarësisht nga baza gjinore e shoqërisë.

Edhe pse inkuadrimi direkt i femrave në veprimtaritë turistike, duket të jetë një proces i vështirë, i ngadalshëm, por jo edhe i pamundur, turizmi në një të ardhme të afërt mund të jetë një profesion i ri për femra, i cili fillimisht kërkon mbështjetjen familjare e pastaj të shoqërisë në përgjithësi.

Pavarësisht se në zhvillimin e deritanishëm të turizmit në Kosovë femrat janë humbëse në raport me meshkujt, duke u bazuar në proceset globale në të cilat gradualisht ka filluar të integrohet edhe Kosova, është shumë e sigurtë se vetë shoqëria kosovare do të jetë nxitëse dhe përkrahëse e përcjelljes së trendeve ndërkombëtare në favor të barazisë gjinore.

Referencat

1. Kinnard V., Hall D.(2002) “Tourism: gender Perspectives”
2. Rayan C., Page S.(2000) “Tourism management” Towards the New Millennium, Elsevier
3. Anketë – Hulumtim “Edukimi turistik në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë”